



**CDU**



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

## **PARIMET E LIRISË DHE SIGURISË PËR GJERMANINË**

**MANIFESTI I PARTISË SË UNIONIT KRISTIAN  
DEMOKRAT TË GJERMANISË (CDU), PËR TË CILAT  
U RA DAKORD GJATË KONGRESIT 21 NË HANOVER,  
3-4 DHJETOR 2007.**

**MATERIALE PËR EDUKIM QYTETAR DHE  
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR TË FONDACIONIT  
KONRAD ADENAUER.**

©2008, Fondacioni Konrad Adenauer  
D-10907 Berlin.

Departamenti për Bashkëpunimin Ndërkombëtar

Personi i kontaktit:

Dr. Karsten Grabow, [karsten.grabow@kas.de](mailto:karsten.grabow@kas.de)

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>Preambul: Politikat Kristian Demokrate për Gjermaninë në Shekullin 21 .....</b>	<b>4</b>
<b>I. Ne Kristian Demokratët.....</b>	<b>6</b>
1. Cilët Jemi Ne – Koncepti Ynë i Njerëzimit dhe Vlerat Bazë të CDU-së.....	6
2. Koncepti Ynë për Shoqërinë.....	12
▪ Zhvillimi i Lirë Personal	
▪ Kohezioni në Shoqërinë Tonë	
<b>II. Sfidat e Kohës Sonë – Perspektiva e CDU-së për Formësimin e së Ardhmes.....</b>	<b>16</b>
1. Sfidat e Kohës Sonë.....	16
▪ Krijimi nën Kërcënim	
▪ Bota e Globalizuar	
▪ Kërkesat e Shoqërisë me Dije Intensive	
▪ Siguria e Rrezikuar	
▪ Ndryshimi Demografik	
2. Gjermania, Shoqëria e Shanseve – Jetesa në Liri dhe Siguri.....	20
<b>III. Familje të Forta – Shoqëri Humane .....</b>	<b>23</b>
1. Stile të Reja të Jetës – Marrëdhënie të Reja Mes Brezave .....	23
2. Forcimi i Themelit të Shoqërisë Sonë – Krijimi i Lirisë së Zgjedhjes Për Familjet.....	26
<b>IV. Gjermania Si Një Komb i Arsimit dhe Kulturës – Përgjigje Për Shoqërinë e Bazuar tek Dijet.....</b>	<b>32</b>
1. Më Shumë Arsim Për Të Gjithë – Nga Fillimi Gjatë Gjithë Jetës .....	32
2. Gjermania Kureshtare: Kërkimi Shkencor Siguron Begatinë dhe Zhvillimin .....	40
3. Kultura: Shprehja e Identitetit Kombëtar .....	43

<b>V. RINOVIMI I EKONOMISË SOCIALE TË TREGUT NË NJË BOTË TË GLOBALIZUAR.....</b>	<b>46</b>
1. Parimet e Rendit për Prosperitetin, Përfaqësimin dhe Sigurinë .....	47
2. Ekonomia e Tregut Social në një Botë të Globalizuar .....	50
3. Biznesi dhe Punësimi .....	53
4. Formësimi i Ndryshimit Demografik – Siguria Sociale për të gjithë Brezat .....	58
5. Buxheti i Qëndrueshëm për një Gjermani Solide.....	65
6. Duke u bazuar në arritjet historike - Të mbështesim zhvillimin e Shteteve të reja Federale ....	69
<b>VI. TË RUAJMË ATË QË KA KRIJUAR ZOTI DHE JETA – MJEDIS NË TË CILIN JA VLEN TË JETOHET .....</b>	<b>72</b>
1. Mbrojtja e Dinjitetit Njerëzor .....	72
– nga fillimi deri në fund të jetës	
2. Mbrojtja e Burimeve Natyrore .....	73
3. Një e Ardhme për Bujqësinë dhe Zonat Rurale.....	79
<b>VII. QYTETARË AKTIVË, NJË SHTET I FORTË, NJË VEND ME MENDJE TË HAPUR.....</b>	<b>81</b>
1. Forcimi i Shoqërisë Civile – Inkurajimi i Nismave Proaktive .....	81
2. Për një shtet të fortë: Liria dhe Siguria për Qytetarët .....	84
3. Gjermania, Vendi i Integritimit .....	91
<b>VIII. PRANIMI I PËRGJEGJËSIVE DHE INTERESAVE TË GJERMANISË .....</b>	<b>93</b>
1. Shansi i Gjermanisë është Europa .....	93
2. Përkrahja e Lirisë dhe Paqes – Roli i Gjermanisë në Botë .....	101



## PREAMBUL

### Politikat Kristian Demokrate për Gjermaninë në Shekullin 21

Ne, Kristian Demokratët, të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë tonë, deklarojmë me këtë deklaratë politike para Zotit dhe njeriut vlerat dhe qëllimet tona dhe paraqesim këtu përgjigjet tona ndaj sfidave të kohës sonë.

CDU është një parti popullore e qendrës që i përfshin të gjithë. Ajo ende ka të gjalla rrymat politike të mendimit që çuan në themelimin e saj. Ne i kemi rrënjët tek koncepti kristian i njerëzimit dhe dinjitetit të tij të pathyeshëm nga i cili varen vlerat bazë të lirisë, solidaritetit dhe drejtësisë. Ne përpiqemi për një korrelacion të drejtë midis vlerave bazë.

Në një botë që ndryshon, është përgjegjësia jonë që të vendosim një lidhje midis vlerave dhe realitetit dhe të veprojmë përkatësisht. Të qenit të ndërgjegjshëm për gabueshmërinë e natyrës njerëzore na mbron prej rrezikut të krijimit të ideologjive nga politika. Kjo na tregon edhe kufijtë e politikës.

Unioni i ka përjetuar të gjitha fillimet madhore në historinë e Republikës Federale të Gjermanisë. Sot, përballemi me sfidat gjigante të Shekullit 21 me të njëjtën vendosmëri.

Nëpërmjet politikave të saj themelore të orientimit, të tilla si ekonomia sociale e tregut, lidhjet me perëndimin dhe integrimin europian, CDU në 1949 hodhi themelet për një zhvillim të lirë, të drejtë dhe dinamik të vendit tonë.

CDU qëndroi e patundur kundër kundërshtimit ndaj ribashkimit të Gjermanisë. Kur u ofrua mundësia, bashkimi i atdheut tonë që i mundur, pas dekadash ndarjeje, që u krye në paqe dhe liri nën udhëheqjen e CDU-së. Gjermania mund të krenohet me këtë arritje. CDU ka luajtur një rol thelbësor në këtë histori suksesi.

Për herë të parë në historinë e saj, Gjermania rrethohet nga miq dhe partnerë. Miqtë tanë në Amerikë dhe Europë kanë dhënë një kontribut lëndësor për këtë. Baballarët themelues të Europës kurrë nuk e kanë pasur kaq të lehtë: një Europë që është e bashkuar në paqe dhe liri, e fortë ekonomikisht, e orientuar nga ana shoqërore dhe e përgatitur të marrë përsipër më tepër përgjegjësi në botë. Besimi dhe konfidenca janë parimet tona udhërrëfyese për ta çuar më tej bashkimin dhe zhvillimin e kontinentit tonë.

Ky rend ekonomik dhe shoqëror në liri është modeli ynë për një rend ndërkombëtar politike. Globalizimi kërkon një dimension të ri të ekonomisë sociale të tregut dhe e paraqet mundësinë për të vendosur standarde sociale dhe ekologjike globale.

Duke pasur parasysh sfidat e Shekullit 21, është e nevojshme të gjendet një përkufizim i ri për sigurinë. Ai përfshin sigurinë e brendshme dhe të jashtme në një botë me kërcënime të reja në rritje. Veç kësaj, ai përfshin sigurinë shoqërore në kushtet e ekonomisë së globalizuar dhe ndryshimeve demografike si dhe të atyre që i përkasin kohezionit në shoqërinë tonë dhe sigurisë për të jetuar në një mjedis që ja vlen të jetohet dhe që çdo brez e ruan për brezin tjetër.

Dëshirojmë të promovojmë Gjermaninë duke forcuar vlerat dhe virtytet e shoqërisë që e kanë bërë vendin tonë të suksesshëm.

Vizioni ynë për Gjermaninë është një shoqëri mundësish në të cilën qytetarët tanë të jetojnë në liri dhe siguri, një shoqëri që respekton arritjen dhe suksesin. Veç kësaj, ne duam që të ankorohen në mes të shoqërisë edhe ata që deri tani kanë qenë të përjashtuar. Çelësi për shanse më të mëdha në tregun e punës janë veçanërisht mundësitë e barabarta për edukim dhe arsimim gjatë gjithë jetës.

Bindjet tona etike dhe përvoja jonë e pasur na japin fuqi dhe urtësi politike për ta formësuar Republikën Federale të Gjermanisë si një vend i lirisë, drejtësisë, sigurisë dhe mundësisë për të gjithë njerëzit. Kjo është baza mbi të cilën ne bashkëpunojmë me qytetarët e vendit tonë për një të ardhme të mirë.



## I. NE KRISTIAN DEMOKRATËT

### 1. Cilët Jemi Ne – Koncepti Ynë i Njerëzimit dhe Vlerat Bazë të CDU-së

#### *Partia Popullore e Qendrës*

1. Unioni Gjerman Kristian Demokrat është parti politike e qendrës. Ajo lidhet me të gjithë njerëzit e të gjithë llojeve të niveleve dhe grupeve në vendin tonë. Politikat tona karakterizohen nga koncepti kristian i njerëzimit dhe përgjegjësitë ndaj Zotit.

2. Koncepti kristian i njerëzimit formon bazën tonë etike për politika të përgjegjshme. Megjithatë, ne e njohim faktin se asnjë program politik nuk mund të rrjedhë nga ndonjë besim kristian. CDU është e hapur për çdo person që njeh dinjitetin, lirinë dhe barazinë e të gjithë njerëzve dhe pranon parimet drejtuese të sjelljes sonë politike të cilat lindin nga vlerat e mësipërme. Sjellja jonë kolektive në CDU mbështetet tek ky themel.

3. CDU u themelua nga burra dhe gra që donin t'i jepnin formë të ardhmes së Gjermanisë me një parti popullore të bazuar tek krishtërimi pas rënies së Republikës së Vaimarit, krimeve të kryera gjatë periudhës së Nacional Socializmit dhe sundimit komunist pas vitit 1945. Anëtarësia e saj përfshinte të krishterë, katolikë, protestantë, evangjelistë dhe burra dhe gra që u përkisnin të gjitha feve dhe klasave shoqërore. CDU ka rrënjë konservatore, liberale dhe social kristiane. Mbi bazën e idealeve të përbashkëta, anëtarët e CDU-së kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në hartimin e Kushtetutës gjermane. Ajo përcaktoi gjithashtu për shumë dekada vendimet politike thelbësore në pjesën e lirë të Gjermanisë, për shembull në lidhje me ekonominë sociale të tregut, të gjitha ligjet kryesore sociale, duke e bërë Gjermaninë aleate të komunitetit etik dhe të mbrojtjes së Perëndimit dhe të ribashkimit të Gjermanisë dhe të Europës. CDU-së ju mohua e gjitha kjo në zonën gjermane të pushtuar nga sovjetikët.

4. Parimet shpirtërore dhe politike të CDU-së janë të rrënjosura në etikën sociale të kishave të krishtera, në traditat liberale të Iluminizmit, ruajtja e vlerave konservatore e marrëdhënieve dhe njohja e faktit se shteti nuk duhet të konsiderohet si i gjithëfuqishëm. Ato janë gjithashtu rezultat i rezistencës së krishterë dhe të motivuar nga ana patriotike kundër nacional socializmit. Aspekte të tjera të identitetit të CDU-së janë revolucioni paqësor i vitit 1989 i cili përmbysi diktaturën komuniste të RDGJ-së dhe ribashkimin e atdheut tonë. Arritjet dhe përvojat e qytetarëve të shteteve të reja federale janë një pasurim për komunitetin tonë dhe për CDU-në. Bashkimi Kristian Demokrat Gjerman është partia që promovon bashkimin e Gjermanisë.

### ***Koncepti Kristian i Njerëzimit***

5. Sipas pikëpamjes sonë, Zoti e krijoi njeriun sipas imazhit të tij dhe ngjashmërisë me të. Si pasojë e këtij koncepti kristian të njerëzimit, ne besojmë në dinjitetin e cenueshëm të qenies njerëzore. Dinjiteti i të gjithë njerëzve është i njëjtë, pavarësisht nga seksi, ngjyra, kombësia, moshë bindjet fetare dhe politike, aftësia e kufizuar, shëndeti dhe performanca, sukcesi ose dështimi i tyre dhe gjykimi i të tjerëve. Ne e konsiderojmë çdo person si unik dhe të domosdoshëm në të gjitha fazat e zhvillimit. Dinjiteti i njeriut – duke përfshirë dhe atë të personave të pa lindur dhe atyre që vdesin – është i pacenueshëm.

6. E drejta për zhvillim të lirë të personalitetit të dikujt dhe të dëshirës së dikujt për të marrë përgjegjësi ndaj fqinjëve buron nga ky dinjitet njerëzor. Qenia njerëzore ka vullnetin e lirë për të marrë vendimet e tij morale. Në përputhje me bindjet tona kristiane, ajo ka përgjegjësinë ndaj Zotit dhe ndaj ndërgjegjes së tij dhe duhet të veprojë në solidaritet me qeniet e tjera njerëzore në komunitet.

7. Çdo qenie njerëzore është e gabueshme. Kjo është arsyeja përse vendosen kufij për planifikimin politik, risi dhe krijimtari. Ky kuptim na mbron nga çdo doktrinë ideologjike e totalitarizmit shpëtimtar dhe politik. Ai na jep mundësinë të përqafojmë pajtimin.

8. Ne e konsiderojmë qenien njerëzore si pjesë e krijimit. Ajo nuk ka të drejtë ta përdorë natyrën në mënyrë arbitrare. Natyra na është besuar

për ta mirëmbajtur dhe për ta ruajtur. Ne jemi përgjegjës për gjendjen në të cilën ua lëmë atë brezave të ardhshëm.

9. Pikërisht mbi këtë koncept të njerëzimit mbështeten parimet themelore të qeverisjes demokratike në shtetet konstitucionale. Kjo vlen për të gjithë personat jo të krishterë të cilët nuk e nxjerrin dinjitetin, barazinë dhe lirinë njerëzore nga bindjet e krishtera.

10. Komuniteti ynë jeton mbi parimet intelektuale të cilat nuk duhet të merren as si të sigurta as si të përhershme. CDU merr përsipër përgjegjësinë për të ruajtur dhe forcuar vlerat me bazë kristiane të sistemit tonë të lirë demokratik. Ato janë standardet dhe pikat e orientimit të sjelljes sonë politike. Vlerat tona bazë të lirisë, solidaritetit dhe drejtësisë e kanë zanafillën këtu. Ato paraqesin kërkesa, vendosin kufij, plotësojnë njëra-tjetrën dhe janë njëlloj të rëndësishme. Është detyra jonë dhe thelbi i qëndrimit tonë politik që t'i klasifikojmë ato me maturi. Si të drejta njerëzore të patjetërsueshme, vlerat bazë janë universale dhe shkojnë përtej hapësirës së kufijve tanë kombëtarë.

### ***Liria***

11. Qenia njerëzore është krijuar e lirë. Si qenie etike ajo duhet të marrë vendime dhe të sillet në mënyrë të arsyeshme dhe të përgjegjshme. Asnjë sistem totalitar nuk mund t'ia heqë asaj lirinë e brendshme. Liria e vetes përcaktohet dhe kufizohet nga liria e personit tjetër. Ai që kërkon lirinë e tij duhet të respektojë lirinë e qenieve të tjera njerëzore. Liria përbëhet nga të drejta dhe përgjegjësi. Liria shkon bashkë me përgjegjësinë. Politika duhet t'i sigurojë individit lirinë që kërkon. Është gjithashtu përgjegjësi e politikës që ta ruajë këtë liri për të gjithë komunitetin.

12. Qenia njerëzore mund ta zhvillojë personalitetin e saj brenda komunitetit. Ai që u shmanget përgjegjësisë të përbashkëta nuk e çliron veten, por përkundrazi bëhet i varfër dhe i vetmuar. Ashtu sikurse ka varësi që e degradojnë personin, ka edhe marrëdhënie në të cilat rritet liria e personit.

13. Ligji garanton lirinë duke mbrojtur dinjitetin personal të individit. Ai rregullon bashkëjetesën e rregullt dhe paqësore të njerëzve. Kufizimet



e lirisë lejohen vetëm në rastet kur ato kërkohen për mbrojtjen e lirisë. Që të jetë efektive liria, nevojitet drejtësia sociale. Kushtet në të cilat jeton një person nuk duhet ta pengojnë lirinë. Çdo personi duhet t'i jepet mundësia që të zhvillohet sipas dëshirave, aftësive dhe talenteve të tij. Duhet të respektohen dhe të mbrohen arritja dhe prona. Duhet të sigurohen parimet materiale të lirisë.

14. Liria mundëson dhe kërkon përgjegjësi për zhvillimin personal. Kjo është arsyeja përse jeta sociale duhet të parashikohet sipas parimit të ndihmës sociale [subsidiariteti]: atë që qytetari i veçantë mund ta arrijë vetë, brenda familjes dhe në shoqëri të lirë me personat e tjerë më mirë ose po aq mirë duhet të mbetet detyra e tij. Shteti dhe komunat duhet të kryejnë vetëm ato detyra që qytetarët e veçantë apo përkatësisht komunitetet më të vogla nuk mundën t'i plotësojnë. Parimi i ndihmës sociale vlen edhe për marrëdhëniet midis komuniteteve më të vogla dhe më të mëdha si dhe për veprimtaritë midis shoqatave private dhe organizatave publike. Parimi i ndihmës sociale kërkon që komunitetet më të mëdha, duke përfshirë ato që zotërohen nga shteti, të ndërhyjnë kur kërkesat social-politike janë tepër të rënda për komunitetet më të vogla.

15. Liria realizohet në jetën praktike nëpërmjet përgjegjësisë personale dhe përgjegjësisë kolektive. Qytetari duhet ta përjetojë dhe të jetojë në liri në familje, në lagje, në vendin e punës dhe në kohën e lirë si dhe në komunitet dhe në shtet. Ai duhet të marrë pjesë në aktivitetet e komunës, të marrë pjesë në ekip, të votojë dhe të marrë pjesë në vendimmarrje. Ai nuk duhet të jetë i marginalizuar dhe nuk duhet të bëhet që të luajë rolin e "askushit" të nënshtruar dhe thjesht të marrësit të arritjeve të shtetit. Gjykimi i pavarur dhe bashkëpunimi i përgjegjshëm e mbrojnë atë nga mashtrimi prej formave të ndryshme të ideologjisë. Ne duam ta forcojmë sensin e përgjegjësisë dhe mirëqenies së përgjithshme, ndërgjegjen për detyrën dhe përgjegjësinë qytetare.

16. Arritja personale është pjesë e zhvillimit të personalitetit të njeriut. Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat e tij janë të pavarura nga çdo arritje e tij, por përvoja, aftësia e tij për të arritur janë një burim i rëndësishëm i jetës së tij. Arritja është një shtysë e pashmangshme. Për këtë arsye, është i domosdoshëm që të promovohet gatishmëria e personit për të punuar dhe për të arritur dhe iniciativa e njeriut, qoftë kur ka dëshirë

për të fituar ose jo në analizë të fundit. Pa arritje personale asnjë shoqëri e mirëqenies nuk mund ta bëjë të mbijetojë, ta fitojë dhe ta ruajë pasurinë.

17. Përgatitja për të përfshirë veten në arritjen e lirisë dhe për ta mbrojtur atë nga jashtë edhe nga brenda është një pjesë integrale e lirisë. Ne jemi të angazhuar për të konsoliduar demokracinë dhe sundimin e ligjit. Ai që është i lirë ka detyrë të përfshihet për lirinë e atyre të cilëve u mungon liria. Liria nuk duhet të jetë e kufizuar vetëm për pak kombe ose grupe shoqërore. Ne duam ta shtrijmë tek të gjitha qeniet njerëzore dhe po japim kontributin tonë për këtë.

### ***Solidariteti***

18. Solidariteti rrjedh nga urdhëresa e dashurisë për fqinjin dhe është në bashkëtingëllim me natyrën sociale të qenieve njerëzore. Qëllimi i arritjes së jetës humane për të gjithë na detyron që të veprojmë në solidaritet me të gjithë. Solidariteti u përket veçanërisht atyre të cilët nuk kanë arritur ende, nuk arrijnë dot më apo qëndrueshëm parimet bazë të jetës në liri.

19. Solidariteti është e drejta dhe detyra e çdo qenieje njerëzore. Çdo njeri kontribuon nëpërmjet punës së vet dhe arritjeve në mënyrë që t'i mundësojë komunitetit të mbrojë individin. Ne angazhohemi në këtë përgjegjësi reciproke. Format elementare të solidaritetit përbëjnë ndihmën dhe mbështetjen për marrëdhëniet imediate personale - në familje, mes miqsh dhe bashkëqytetarësh dhe në komunitetet private. Megjithatë, aty ku individ është i mbingarkuar, komuniteti dhe shteti duhet të ndërhyjë për të ndihmuar.

20. Angazhimi për sigurinë sociale bazohet në parimin e solidaritetit. Së bashku, ne jemi në gjendje që të shmangim risqet që individ i vetëm nuk mund t'i përballojë. Nuk kërkohet as lëmoshë as kujdes falas. Në vend të kësaj bëhet e mundur një jetë në siguri sociale për individin. Çdo njeri që praktikon solidaritetin, përgatitet të sakrifikojë. Ai që mbështetet tek solidariteti nga shteti ka edhe detyra ndaj shtetit. Siguria sociale ka një efekt paqëtues dhe çlirues. Solidariteti e urren abuzimin me sistemin e sigurisë sociale.

21. Solidariteti kërkon subsidiaritetin. Mbështetja subsidiare kërkon vetëm sjellje të përgjegjshme. Shteti duhet t'i bëjë këto vlera të arritshme dhe të lehta për çdo qytetar.

22. Solidariteti përbën një detyrim për brezat e ardhshëm. Pa solidaritet mes brezave, nuk mund të arrijmë drejtësi tek të gjithë brezat. Të gjithë vendimet politike duhet të jenë në përputhje me këtë përgjegjësi. Ne nuk duhet të jetojmë në kurriz të fëmijëve tanë dhe të fëmijëve të fëmijëve tanë. Ne nuk duhet të jetojmë edhe duke dëmtuar qeniet e tjera njerëzore në pjesë të tjera të botës. Ne angazhohemi për një solidaritet mbarë-botëror në komunitetin ndërkombëtar. Pa solidaritet, hendeku mes të varfërve dhe të pasurve nuk mund të mbushet dhe ruajtja e krijimit nuk do të jetë e mundur.

### ***Drejtësia***

23. Parimi themelor i drejtësisë është barazi për të gjithë njerëzit në dinjitetin dhe lirinë e dhënë nga zoti. Drejtësia e mban lart këtë vlerë dhe liri. Drejtësia kërkon që gjërat e barabarta dhe gjërat e pabarabarta të trajtohen në mënyrë të pabarabartë. Në një shtet të sundimit të ligjit, drejtësi do të thotë të drejta të barabarta për të gjithë. Ligji parandalon arbitrarizmin dhe abuzimin me pushtetin. Ai siguron lirinë edhe për të pambrojturit.

24. Krijimi i mundësive të barabarta është një komponent i domosdoshëm i barazisë përpara ligjit. Secili duhet të ketë mundësi të barabarta për zhvillimin e vetes në liri sipas aftësive dhe shprehive personale. Insistojmë që çdo qenieje njerëzore t'i lejohet që t'i përdorë mundësitë e veta në mënyrë të lirë dhe të përgjegjshme. Shoqëria e shanseve garanton parakushtet dhe mundësitë për to. Kjo krijon në shoqëri shans të barabartë për të mbijetuar. Kjo kërkon mundësi fillestare të njëjta për arsim dhe punë. Megjithatë ajo nuk përjashton ekzistencën e dallimeve në aftësitë personale të individëve. Ne, vërtet, dëshirojmë të krijojmë mundësi dhe shanse të barabarta pa pritur rezultate të njëjta.

25. Drejtësia kërkon që ngarkesat të shpërndahen në mënyrë të barabartë. Prandaj, njerëzit më të fortë në shoqëri duhet të kontribuojnë më tepër se sa ata që janë më të dobët. Jemi të ndërgjegjshëm se edhe



me përpjekjet më të mëdha që mund të bëjmë drejtësia absolute është e pamundur të arrihet. Jemi të detyruar të kemi një përgjegjësi të veçantë për të dobëtit dhe ata që nuk kanë avantazhe sociale. Askush nuk duhet të lihet jashtë apo të harrohet.

26. Aty ku e drejta e një personi për një jetë me dinjitet shtypet, aty ku liria e një individ, një grupi ose një popull shtypet, mbisundon dhuna dhe mosmarrëveshja. Jemi të angazhuar të respektojmë të drejtat njerëzore dhe civile dhe të çrrënjosisim mjerimin social dhe ekonomik. Në këtë drejtim, ne japim kontributin tonë drejt ruajtjes së paqes mes kombeve dhe një bote më të drejtë.

## 2. Koncepti Ynë për Shoqërinë

27. Themelet shpirtërore të Unionit Kristian Demokrat na mundësojnë që të përballemi me sfidat aktuale dhe të ardhshme. Në kohët e ndryshimit, në veçanti, politika mund të përcaktojë kuadrin e drejtë që çliron fuqi për zgjidhjen e problemeve urgjente në komunitet dhe në shtet. Politikat tona synojnë një shoqëri e cila siguron lirinë për të gjithë dhe i bashkon të gjithë njerëzit në një kuadër bashkësie ku të gjithë kanë pjesë.

### ***Zhvillimi i Lirë Personal***

28. Në kërkimin e tij për kuptimin e jetës dhe lumturisë, çdo njeri do të ketë mundësinë që ta zhvillojë veten sipas talentit dhe aftësive të tij. Në besimin kristian, zhvillimi i lirë i personalitetit të njeriut është i mundshëm vetëm brenda komunitetit. Marrëdhënia midis individit dhe komunitetit është ajo e pasurimit reciprok. Individit mund të arrijë zhvillimin e plotë të identitetit të tij në marrëdhënie me persona të tjerë. Komuniteti varet nga personalitetet e lira, individuale me besim për zhvillimin dhe potencialin e tij. Kjo është karakteristika e shoqërisë me shanse të barabarta për të gjithë. Në të, çdo person ka mundësinë që të shprehë plotësisht krijimtarinë dhe novacionin e tij. Ky zhvillim i lirë personal në shoqërinë e mundësive siguron edhe kohezionin në shoqëri.

29. CDU beson në aftësinë dhe gatishmërinë e të gjithë qytetarëve për të trajtuar çështjet e tyre. Politikat synojnë që të promovojnë

përgjegjshmërinë personale dhe në qoftë se është nevoja të ofrojnë asistencë për iniciativat e pavarura. Për të marrë përsipër përgjegjësi, një person duhet së pari të zhvillojë lirshëm aftësitë dhe talentet e tij.

Gjëja e parë që një qenie njerëzore përjeton në familje është ndërveprimi midis lirisë dhe përgjegjësisë. Në familje njeriu vëren edhe shumësinë e personaliteteve dhe aftësive të tyre tek të cilat varet komuniteti ynë. CDU dëshiron të forcojë martesën dhe familjen si themel i shoqërisë dhe i vë theks të madh shoqërisë që është miqësore ndaj fëmijës dhe miqësore ndaj familjes dhe ka marrëdhënie të shëndetshme midis brezave.

Rritja dhe edukimi përbëjnë parakushtet kyçe për zhvillimin e lirë të qenies njerëzore dhe aftësisë për të çmuar të drejtat e lirisë dhe përgjegjësitë qytetare. CDU dëshiron të përmirësojë sistemin e diferencuar shkollor në mënyrë të tillë që secilit t'i ofrohet mundësia më e mirë për zhvillimin e talenteve të tij.

Qenia njerëzore zhvillohet edhe në vendin e punës. Kjo është arsyeja përse CDU e ka bërë qëllimin e saj që të sigurojë punësim për këdo. Ekonomia sociale e tregut i mundëson qytetarit që të marrë pjesë në konkurrencë dhe të vlerësojë kapacitetin e performancës së tij. Për CDU-në konkurrenca nuk luan vetëm një rol të rëndësishëm. Jemi të bindur që konkurrenca e ndershme i inkurajon njerëzit që të përdorim sa më mirë aftësitë e tyre. Një shtet kushtetues demokratik u garanton qytetarëve të tij një shans për zhvillimin e lirë personal dhe i mbron ata nga diskriminimi. CDU e deklaron këtë drejtpeshim midis lirisë dhe rendit.

30. Barazia gjinore është një e drejtë bazë njerëzore. Politikat tona kërkojnë të krijojnë mundësi të barabarta për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë dhe të largojnë dizavantazhet në të gjitha fushat. Ne përkrahim një politikë që u jep burrave dhe grave të drejta të barabarta. Sipas pikëpamjes sonë, një sistem i tillë përfshin shanse të barabarta pune, shanse për përparim në karrierë dhe paga të barabarta në tregun e punës, duke rritur punën e familjes dhe përputhshmërinë midis familjes dhe karrierës. Opinionet dhe përvojat e ndryshme me të cilat gratë kontribuojnë kanë një rëndësi të madhe për shoqërinë tonë. Ne promovojmë pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet.



## *Kohezioni në Shoqërinë Tonë*

31. Aty ku qeniet njerëzore janë në gjendje të zhvillojnë veten lirshëm kultivohet ndjesia i përkatësisë. Parimi i subsidiaritetit krijon ndjesinë e bashkësisë dhe përfshirje të të gjithë qytetarëve. CDU përpiket për një shoqëri në të cilën qytetarët e lirë dhe të pjekur të jetojnë së bashku dhe të ndihmojnë njëri tjetrin: të rinjtë të ndihmojnë të vjetrit, të vjetrit të ndihmojnë të rinjtë, të fortit të ndihmojnë të dobët dhe të dobët të ndihmojnë të fortit. Shoqëria duhet të mbajë përgjegjësi në mënyrë kolektive që çdo njeri të mund të gjejë vendin e vet.

32. Kohezioni në një shoqëri i ka themelet e tij tek solidariteti si komb. Gjuha jonë e përbashkët, historia jonë si dhe jeta dhe veprimet tona në një shtet komb të ribashkuar formojnë bazën e sensit patriotik të përkatësisë së përbashkët. Ne e konsiderojmë flamurin tonë të zi - të kuq - të artë dhe himnin tonë kombëtar si simbolet e demokracisë sonë. Kombi ynë është një komunitet në të cilin qytetarët dëshirojnë që të marrin përgjegjësi për të kaluarën, të tashmen dhe të formësojnë të ardhmen. Çdo person që vjen tek ne dhe dëshiron të jetojë përgjithmonë me ne është i detyruar që të familjarizohet me vendin tonë dhe historinë e tij, duke u integruar kështu në shoqërinë tonë.

33. Si çdo komb tjetër, kombi ynë nuk mund të mbijetojë pa vlerësimin e lartë të përbashkët për shoqërinë tonë liberale, pa patriotizmin, pa përgatitjen e qytetarëve tanë për të përmbushur detyrat e tyre apo për të marrë përsipër përgjegjësi në vend apo në komb dhe pa treguar solidaritet. Historia jonë është mbarsur me përvoja dhe arritje të mëdha në shkencë dhe art, ekonomi dhe politikë. Ne kemi një traditë të shquar të sundimit të ligjit, qeverisë konstitucionale dhe të një sistemi të mirë administrativ. Ne kemi krijuar një shtet të mirëqenies sociale dhe kemi zhvilluar një ekonomi tregu. Për shumë dekada tashmë kemi jetuar në paqe dhe demokraci të qëndrueshme si pjesë e qenësishme e familjes europiane të kombeve dhe kemi arritur ribashkimin tonë paqësisht. Si pjesë e identitetit tonë duhet të rikujtojmë në mënyrë konstante vitet e turpshme të abuzimit me të drejtat e njeriut nën regjimin nacional socialist dhe të mos e hedhim atë në harresë dhe të mos u hyjmë në llogari të tjerëve. Sipas mendimit tonë, patriotizëm do të thotë të jemi plotësisht të ndërgjegjshëm për historinë e vendit tonë dhe të formësojmë të ardhmen e tij në mënyrë të përgjegjshme.

34. Vetëm kur ia pranojmë vetes qartë si komunitet i qytetarëve të lirë, të karakterizuar nga një histori dhe kulturë e dallueshme, mund të kërkojmë me bindje integrimin dhe pjesëmarrjen. Për të qenë pjesë e kësaj shoqërie do të thotë të jesh pjesë e historisë së saj, e traditave dhe përvojave të saj, formave dhe normave të saj të bashkekzistencës dhe të aspekteve të tjera të kulturës së saj. Kjo është e vërtetë për çdo gjerman dhe për imigrantët ose imigrantët e mundshëm dhe fëmijët e tyre. Faktorët detyrues të bashkekzistencës tonë përbëjnë para së gjithash përvetësimin e gjuhës gjermane, respektimin e qytetarëve të tjerë, dhe gatishmërinë për të punuar dhe për të marrë përgjegjësi. Veç kësaj, çdo qytetar duhet të pranojë të gjitha vlerat kulturore detyruese që e kanë origjinën e tyre në administrimin tonë shoqëror dhe politik. Ato janë vlera që e kanë zanafillën prej historisë sonë dhe janë të rrënjosura në kushtetutën tonë: dinjiteti i pacenueshëm i çdo qytetari, njohja e të drejtës të çdo personi për të bërë një jetë me dinjitet dhe për të kultivuar sensin e tij të drejtimit dhe, në këtë mënyrë, lirisë së fesë.

35. CDU e konsideron integrimin social si tërësor. Çdo person duhet të jetë në gjendje ta zhvillojë veten lirshëm dhe të marrë pjesë në jetën sociale, politike, ekonomike dhe kulturore të komunitetit. Në këtë drejtim, CDU e konsideron integrimin e imigrantëve në shoqërinë tonë si misionin e saj politik kyç. Integrimi çon menjëherë në pjesëmarrjen e barabartë, mirëkuptimin dhe identifikimin reciprok me vendin tonë.

36. Kultura jonë politike është e themeluar mbi vlerat e përbashkëta europiane dhe veçantitë e historisë gjermane, veçanërisht në lidhje me traditat federale dhe fetare, marrëdhënia e veçantë midis shtetit dhe kishës dhe përgjegjësisë që gjermanët kanë deri tani të nxjerrë nga përvojat e dy regjimeve totalitare.

37. Këto vlera kulturore dhe përvojat historike formojnë bazën e kohezionit në shoqërinë tonë dhe përbëjnë orientimin madhor kulturor në Gjermani. Ne duam ta mbushim atë me jetë.

Kultura jonë karakterizohet dhe orientohet në historinë e saj, të tashme dhe të ardhshme nga standardet europiane. Ky dimension evropian do të vazhdojë të jetë me rëndësi të madhe në procesin e unifikimit të Europës.



## II. SFIDAT E KOHËS SONË – PERSPEKTIVA E CDU-SË PËR FORMËSIMIN E SË ARDHMES

### 1. Sfidat e Kohës Sonë

38. Jetojmë në kohërat e ndryshimeve epokale. Kërcënimet ndaj mjedisit tonë, pasojat e globalizimit, kërkesat e një shoqërie të bazuar tek dija, kërcënimet e reja ndaj lirisë sonë dhe ndryshimi demografik janë shembujt më të spikatur të këtyre ndryshimeve. Ne duhet t'i pranojmë ato, të përballemi me to sy më sy dhe t'i konsiderojmë si mundësi eventuale të promovimit të politikave të përgjegjshme të cilat ofrojnë perspektiva për të ardhmen. Prandaj, është e domosdoshme për ne që të jemi të përgatitur për të pranuar ndryshimin. Kështu, vendi ynë është i detyruar të qortojë prirjet e gabuara dhe dobësitë strukturale të shtetit të ndihmës sociale. Si partia e madhe popullore në qendër të shoqërisë sonë, CDU kërkon të ruajë atë çka e shtyn vendin përpara dhe të ndryshojë atë që e pengon përparimin e vendit tonë.

#### ***Krijimi nën Kërcënim***

39. Sipas bindjeve tona kristiane natyra na është besuar që ta kultivojmë dhe ta ruajmë. Sot, ajo që vëzhgojmë është se: natyra është nën kërcënim.

40. Shpikjet e reja teknologjike po e shtyjnë qenien njerëzore drejt kufijve të saj etikë. Siç jemi në dijeni, kërkimi në shkencat bio-mjekësore dhe në inxhinierinë gjenetike kanë kontribuar mjaft për kurimin e sëmundjeve dhe lehtësimin e dhimbjes. Megjithatë, ato përmbajnë në të njëjtën kohë shumë risqe në vetvete. Kur, për shembull, kombinohet dëshira për njohuri me marketingun e paskrupullt të produkteve, kërcënohen krijimi dhe dinjiteti njerëzor.

Edhe liria për kërkime duhet të respektojë dinjitetin e pacenueshëm të njerëzimit.

41. Ndryshimi klimatik global kërcënon vetë themelet e ekzistencës sonë dhe shanset e zhvillimit të brezave të ardhshëm. Kërkesa për



energji dhe konsum të energjisë së fosileve po rritet në të gjithë botën. Emetimet e rritura të gazeve të serave dhe ngrohja klimatike që ajo sjell kanë reperkusione të konsiderueshme për njerëzimin dhe natyrën, d.m.th., shkrirjen e akujve, rritjen e nivelit të detit, ndotjen e detit, përmbytjet, mungesën e ujit, shkatërrimin e specieve, shkretëtimin dhe katastrofat e shkaktuara nga thatësitat – katastrofat që varfërojnë qeniet njerëzore dhe i largojnë ato nga shtëpitë drejt migracionit.

### ***Bota e Globalizuar***

42. Globalizim do të thotë hapje e kufijve politikë, ekonomikë dhe të komunikimit në mbarë botën. Ai karakterizohet nga lëvizja e qenieve njerëzore dhe shkëmbimi i ideve dhe informacionit, i mallrave, shërbimeve dhe kapitalit si dhe krijimi i rrjeteve të tregjeve. Ai është një shprehje e lirisë dhe ushqen konkurrencën.

43. Globalizimi është një proces i pakthyesëm politikisht dhe një zhvillim i frytshëm ekonomikisht i cili mund të ofrojë mundësi sociale, politike dhe ekonomike në mbarë botën për gjithnjë e më tepër njerëz. Ne duam ta formësojmë globalizimin në mënyrë të tillë që të forcojë demokracinë dhe të drejtat e njeriut dhe të promovojë qëllimet ekologjike në botë.

Të qenit të ndërgjegjshëm për jetesën në një botë të përbashkët është gjithnjë në rritje. Megjithatë, globalizimi çon gjithashtu në një lloj tjetër shpërndarjeje, përkatësisht, të varfërisë dhe pasurive në botë – mes vendeve dhe brenda vendeve.

Migracioni është gjithashtu pasojë e globalizimit.

44. Krijimi i rrjeteve ndërkombëtare të tregjeve për mallrat dhe shërbimet forcon konkurrencën ndërkombëtare të qendrave ekonomike e cila po bëhet gjithnjë e më tepër një konkurrencë për standardet botërore mes rajoneve. Tregjet globale ndërkombëtare bëjnë të mundur që të thithet kapitali dhe të investohet ai. Rajonet me potenciale dhe perspektiva për interesa efektive marrin kapital që mungon ose humbet në rajone më pak tërheqës. E njëjta gjë vlen për tregjet e talentit dhe të dijes. Kjo përbën një dimension të ri për konkurrencën mbarë-botërore të qendrave ekonomike dhe sistemeve ekonomike. Ky zhvillim i ri redukton në të njëjtën kohë mundësitë kombëtare tatimore dhe e bën kuadrin ndërkombëtar më thelbësor se kurrë.



45. Shumë njerëz e konsiderojnë globalizimin dhe kërkesat që vijnë prej tij si një kërcënim për punët e tyre, progresin e karrierës së tyre personale dhe sigurinë e tyre sociale që deri tani ata i kanë marrë si të padiskutueshme. Kjo frikë duhet të merret seriozisht. Megjithatë, Gjermania prej shumë kohësh ka përfituar nga hapja e kufijve të saj ndaj të huajve dhe nga integrimi në rritje i tregjeve ndërkombëtare – shoqërive nëpërmjet mundësive më të mëdha të tregut si dhe nga punonjësit nëpërmjet punëve të cilësisë së lartë, nga konsumatorët nëpërmjet produkteve gjithnjë e më të shumtë e më të mira dhe nga investuesit nëpërmjet perspektivave të investimeve të shumanshme. Në qoftë se Gjermania është në gjendje ta pohojë veten e saj në konkurrencën globale ne do të jemi në gjendje të sigurojmë për veten tonë themelet e ardhshme ekonomike të sigurisë sociale dhe stabilitetit. Kjo do të hapë për ne çdo ditë mundësi të reja për zhvillimin e mëtejshëm. Sa më shumë njerëz që të jetë e mundur duhet të marrin pjesë në këto mundësi rritjeje, në këtë bazë dijesh dhe në këtë kapital. Ai që i parashikon ato vepron në mënyrë sociale.

### ***Kërkesat e Shoqërisë me Dije Intensive***

46. Teknologjia moderne e informacionit dhe komunikimeve (TIC) po e transformon shoqërinë gjithnjë e më tepër në një shoqëri të bazuar tek dija. Roli që luan dija në krijimin dhe shtimin e vlerës së jetës po bëhet gjithnjë e më thelbësore. Çdo ditë po zbulohen fusha tërësisht të reja të dijeve dhe potenciali për krijimin e vendeve të punës.

47. Dijet e së ardhmes janë në rrjet dhe ndërdisiplinore. Kështu, ka një ndryshim në qasjen ndaj dijeve. Sot, përvetësimi, organizimi dhe përdorimi i dijeve janë bërë një çështje thelbësore për arritjen e begatisë dhe krijimin e shanseve në jetën e çdo individi dhe shoqërisë në tërësi. Dijet po bëhen burimi më i rëndësishëm. Kjo përbën, në të vërtetë, një shans të madh për Gjermaninë si një vend që gjithmonë i kanë munguar lëndët e para dhe është mbështetur në traditën e saj të madhe të arsimit, trajnimit dhe kërkimit. Megjithatë, kjo paraqet edhe një sfidë të madhe për shkak të konkurruesve të rinj dinamik në tregun botëror.

48. Ritmi me të cilin po rriten dijet për njerëzimin dhe në të cilën avancimi shkencor dhe teknologjik ka zbuluar të panjohurat e deritanishme

ngrenë rëndësinë e rritjes dhe edukimit të mirë. Kjo vjen ngaqë zor se është e mundur më për individin që të përpunojë volumin në rritje të informacionit të disponueshëm. Dijet janë të shpërndara dhe të vjetruara në mënyrë të pabarabartë. Si të tilla, është më e vështirë për aq shumë njerëz që t'i përvetësojnë ato. Sidoqoftë, pjesëmarrja në këto dije është një kërkesë e domosdoshme për ta bërë shoqërinë e shanseve një realitet në Gjermani.

### ***Siguria e Rrezikuar***

49. Për herë të parë vendi ynë rrethohet nga miq dhe partnerë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, Gjermania dhe Europa kërcënohen sot nga të gjitha qoshet e botës. Katastrofat, rrëzimi i shteteve, luftërat civile, varfëria, uria, murtajat, shkatërrimi i mjedisit dhe krimi që sfidon kufijtë marrin jetë njerëzish dhe nga ne. Terroristët që veprojnë pa kufij dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë paraqesin një kërcënim të madh për sigurinë tonë. Mosmarrëveshjet në lidhje me pretendimet ndaj burimeve natyrore dhe burimeve të energjisë mbi të cilat varet begatia dhe liria e Gjermanisë përmbajnë në vetvete risqet ndaj paqes në botë.

50. Vetëm kur përjetuam sulmet terroriste më 11 Shtator 2001 e morëm vesh se sa të cenueshme ishin shoqëritë e lira dhe të hapura dhe me çfarë sfidash përballëshin vendi ynë dhe komuniteti ndërkombëtar i shteteve. Në botën e globalizuar ne ndeshemi drejtpërdrejtë me rezultatet e kërcënimeve asimetrike. Këto zhvillime të reja paraqesin një sfidë jo vetëm për ne si shtet por edhe për shoqërinë tonë dhe kulturën tonë.

Kërcënimet e reja ndaj shoqërisë sonë lindin edhe nga brenda: shteti ynë i lirë demokratik kushtetues, vlerat dhe normat e tij që kërcënohen, për shembull, nga ekstremistët e krahut të majtë dhe të djathtë, fundamentalistët që priren ndaj dhunës, terrorizmi dhe krimi i organizuar.

### ***Ndryshimi Demografik***

51. Ndërsa pjesa tjetër e popullsisë së botës është në rritje, popullsia jonë është duke u tkurrur. Rritmi i lindjeve tek ne është nga më të ulëtit



në botë. Për një kohë të gjatë nuk ka qenë e mundur që të ruhet statusi i dëshiruar i popullsisë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, jetëgjatësia në Gjermani është rritur. Piramida e popullsisë po kthehet me kokë poshtë.

52. Një popullsi totale në tkurrje me një numër të lartë gjithnjë e në rritje të njerëzve të moshuar do ta ndryshojë shoqërinë tonë. Në të ardhmen shumë njerëz të moshuar nuk do të kenë fëmijë dhe nipër e mbesa; lidhjet familjare po bëhen më të dobëta. Në një botë që po kalon një transformim të shpejtë, një shoqëri që ka një numër të ulët fëmijësh dhe një numër të lartë të njerëzve të moshuar kalon një provë të vështirë.

53. Gjithnjë e më pak njerëz të punësuar ushqejnë një numër më të madh njerëzish të papunësuar. Shpenzimet e kryera për dhënien e pensionit për të moshuarit do të vazhdojnë të rriten. Sistemet tona të sigurisë sociale që kanë qëndruar për një kohë të gjatë nuk mund t'ju qëndrojnë këtyre zhvillimeve të reja.

Ato duhet të konfirmohen me kushtet ndryshuese. Duhet të ketë barazi në të gjithë brezat e ndryshëm. Në të njëjtën kohë, evolucioni demografik në rajone në Gjermani do të përjetojë rezultate të ndryshme. Ne përpiqemi për barazi në kushtet e jetesës në të gjitha pjesët e Gjermanisë.

Në analizë të fundit, është përgjegjësia e përgjithshme e shtetit për tu bërë ballë sfidave të ndryshimit demografik, nga që kjo ka pasoja në pothuajse të gjitha fushat e jetës.

54. Sfidat me të cilat përballemi tani janë shqetësuese dhe dëshpëruese për shumë njerëz. Me këtë program CDU jep përgjigje të cilat udhëhiqen nga bindja se duhet të mbështeten parimet e shëndosha dhe se ne, megjithatë, duhet të kapim shanset e krijuara nga ndryshimet e qenësishme që ndodhin për të formësuar të ardhmen tonë.

## 2. Gjermania, Shoqëria e Shanseve – Jetesa në Liri dhe Siguri

55. Koncepti kristian i njerëzimit është parimi ynë udhëheqës për të ardhmen. Çdo qenie njerëzore ka të drejtën të zhvillohet në liri.

Megjithatë, çdo person është përgjegjës për njeriun tjetër. Modeli ynë për shoqërinë e shanseve merr parasysh këtë drejtpeshim të zhvillimit dhe të përgjegjësisë dhe të lirisë dhe të sigurisë.

Ky model lind nga kuptimi bazë i konceptit kristian të njerëzimit.

Shoqëria e shanseve është vlerë thelbësore e një shoqërie humane. Ajo i jep fuqi qenies njerëzore dhe i hap asaj të gjitha llojet e shanseve. Ne mbrojmë respektin, performancën dhe suksesin, të drejtën për një shans të dytë pas dështimit dhe për solidaritetin me të dobëtin.

Ne dëshirojmë integrimin social në mes të shoqërisë edhe për ata që deri tani kanë qenë të përjashtuar prej saj. Sfondi social i një personi nuk duhet të përbëjë një faktor vendimtar për jetën e tij të ardhshme. Vizioni i CDU-së është barazia para shanseve, dhe për pasojë aftësia për të formësuar jetën në mënyrë të përgjegjshme, dhe jo rezultatet e barabarta. Çdo qenie njerëzore është një individ unik që duhet mbrojtur dhe për të cilin duhet kujdesur. Për sa na përket ne, kjo qenie e lirë dhe e përgjegjshme njerëzore është qendra e të gjithë konsideratave tona politike dhe jo shteti.

Ekonomia sociale e tregut e Shekullit të 20-të bëri të mundur për ne që të arrihej “Begatia për të gjithë”. Ne i qëndrojmë fort kësaj përsëri. Megjithatë, edhe në Shekullin 21, edhe rezultatet pozitive të ekonomisë sociale të tregut do të jenë në gjendje të tregojnë veten. Në këtë frymë, ne japim strategjitë që do të forcojnë dëshirën për arritje dhe për punën e fortë, vetëbesimin, përgjegjësinë sociale dhe sensin e solidaritetit.

### ***Jetesa në liri***

56. Në situatat kur po ndodhin shumë gjëra, ne duhet të gjejmë në të njëjtën kohë kurajë dhe të jetojmë në liri. Pa liri, shanset nuk mund të përdoren. Ne duhet të vëmë besimin tonë në fuqinë e lirisë dhe kështu, të besojmë tek vetvetja, në mënyrë që të zotërojmë të ardhmen.

Për të qenë në gjendje që të përballemi me sfidat dhe t’i zgjidhim ato në këtë botë që ndryshon me shpejtësi, nuk kërkohet vetëm gatishmëria për të punuar, këmbëngulja dhe disiplina por edhe kureshtja dhe krijimtaria. Vetëm duke implementuar ide të reja dhe të guximshme,



d.m.th., ide shkencore, kulturore, sociale, ekonomike dhe politike, ne mund të ruajmë vendin në të cilin duam të jetojmë.

Shteti duhet të gjenerojë sigurinë për qytetarët e tij. Në këtë rast, ai duhet të tregojë gjithnjë e më tepër rezerva por ndonjëherë duhet të ndërhyjë aty ku është e domosdoshme për të krijuar shanse për rininë.

### ***Jetesa në Siguri***

57. Në situatat kur ndodhin shumë ngjarje, qeniet njerëzore duhet të kultivojnë besimin për të jetuar në siguri. Është përgjegjësia e shtetit që të krijojë atmosferën e duhur për qytetarët e tij për të qenë në gjendje që të jetojnë në siguri.

Siguria ka shumë dimensione. Forcimi i familjes dhe kohezioni midis brezave, përmirësimi i rritjes dhe edukimit si dhe rivitalizimi i ekonomisë sociale të tregut krijojnë kushtet e drejta për sigurinë sociale. Jetesa në siguri sociale do të thotë të jemi në gjendje të mbështetemi tek solidariteti, një situatë në të cilën shanset janë gjithmonë të hapura për këdo, madje edhe shansi i ri për të përfituar nga shoqëria globale e bazuar tek dijet.

Identiteti kulturor u krijon njerëzve siguri në vendin tonë, kështu edhe fuqi për të formësuar të ardhmen e tyre. Kur jemi të sigurve nga parimet tona udhërrëfyese, përfitojmë siguri të brendshme, e cila na e bën të mundur të jetojmë në liri në mënyrë të përgjegjshme. Integrimi i të huajve në shoqërinë tonë në bazë të përvetësimit të kulturës udhëheqëse në Gjermani është një kontribut i qenësishëm në sigurinë kulturore.

Politikat tona të sigurisë së brendshme synojnë rritjen e mundësive të shtetit për të frenuar kërcënimet dhe për të luftuar krimin. Në lidhje me kërcënimet globale ndaj mënyrës sonë të jetesës, zor se është më e mundshme ndonjë siguri e brendshme e veçuar nga siguria e jashtme. Siguria e brendshme dhe siguria e jashtme duhet të konsiderohen si të ndërvarura. Përdorimi i matur i burimeve tona natyrore të cilat përfshijnë mbrojtjen e mjedisit tonë dhe klimës sonë hap një perspektivë për brezat e ardhshëm për të jetuar në liri.

58. CDU është e angazhuar për një shoqëri në të cilën liria, solidariteti dhe drejtësia janë pjesë e jetës së përditshme. Kur parimet themelore vendosen në perspektivën e duhur plotësohet edhe kërkesa njerëzore për siguri. Jeta e lirë dhe e sigurt arrihet në shoqërinë e shanseve.

### III. FAMILJE TË FORTA – SHOQËRI HUMANE

#### 1. Stile të Reja të Jetës – Marrëdhënie të Reja mes Brezave

59. Nuk janë vetëm kushtet e jashtme që kanë ndryshuar. Kanë ndryshuar edhe stilet e jetës dhe rolet e brezave të ndryshëm. Politikat që konsiderohen të ndjeshme dhe të orientuara drejt së ardhmes duhet të kërkojnë përgjigje për stilet e reja të jetës së njerëzve dhe përsëri të njohin faktin se njerëzit mblakën dhe duhet të mbeten më të shëndetshëm.

60. Në kohën tonë të rinjtë kanë më pak shanse se më parë për të gëzuar jetën sociale së bashku në familjet e tyre. Mënyra të ndryshme të jetës, të cilat në kohët e mëparshme realizoheshin natyrshëm nëpërmjet disa stileve të jetës dhe profesioneve në një familje të zgjeruar, rrallë shërbejnë tani si modele të familjes për tu imituar nga fëmijët dhe të rinjtë. Për të pasur jetë të suksesshme, brezave më të rinj ju duhet jo vetëm dija por edhe kompetenca sociale. Është e qenësishme që në rini të ketë sa më shumë përpjekje që të jetë e mundur. Një politikë që motivon njerëzit për ta rritur përgjegjësinë personale dhe solidaritetin vepron me mendësi sociale.

61. Nëpërmjet kohëzgjatjes së madhe të arsimit të mesëm dhe universitar dhe trajnimit, koha për të filluar jetën dhe për të filluar një familje po bëhen gjithnjë e më të lidhura ngushtë. Në të njëjtën kohë, brezi i të rriturve gradualisht po merr përsipër përgjegjësi të veçanta për të ndikuar në bashkekzistencën e të gjithë brezave: ai edukon fëmijët, kujdeset për pjesëtarët e moshuar të familjes, kontribuon me kuotat e tij në kontratën e brezit dhe është i detyruar më tepër se kurrë



të sigurojë jetën e vet. Elementi plotësues midis familjes dhe karrierës është një komponent bazë i sistemit tonë demokratik kristian. Ne dëshirojmë që ata njerëz, që në familjet tona marrin përsipër punë apo përgjegjësi, të marrin mbështetje nga e gjithë shoqëria dhe të mos kenë dizavantazhe në sistemet e sigurisë sociale apo në pagimin e taksave.

62. Në të ardhmen e afërt rreth një e treta e shoqërisë do ta jetojë një të tretën e jetës pas jetës punuese. Është e gabuar të flitet për pensionin. Përkundrazi, njerëzit e moshuar ofrojnë një shans të madh dhe një kapital të madh për shoqërinë në sajë të përvojës së tyre në jetë. Ata janë të përgatitur të kontribuojnë në zhvillimin e vendit. Ne duam të kemi më tepër oferta që do të na mundësojë që t'i ftojme qytetarët tanë të moshuar së bashkë me fëmijët e tyre dhe të rinjtë, me prindërit e tyre dhe ata që janë të punësuar dhe fitojnë për të formuar një bashkekzistencë të gjallë. Çdo njeri ka përgjegjësi. Çdo njeri nevojitet.

63. Ne duam të injektojmë në sistemin tonë të dhënies së kujdesit shëndetësor një kuptim të ri për një shoqëri me jetëgjatësi. Politikat e dhënies së kujdesit shëndetësor në një shoqëri që mplaket jo vetëm që nënkuptojnë zgjatjen e jetës njerëzore me ndihmën mjekësore të teknologjisë së lartë, por edhe përmirësimin e kushteve të jetesës së personit. Kjo është arsyeja përse ne duam të forcojmë përgjegjësinë personale dhe të shtrijmë parandalimin e një shtylle të vetme në sistemin e dhënies së kujdesit shëndetësor. Jeta cilësore në moshën e vjetër nënkupton gjithashtu që njerëzit të jenë në gjendje të jetojnë një jetë sipas zgjedhjes së tyre sa më të pavarur që të jetë e mundur dhe në vendndodhjen me të cilën janë të familjarizuar. Duhet të bëhen ofertat përkatëse respektivisht.

Cilësia sociale e bashkekzistencës tonë do të përcaktojë se si do të mundemi t'i trajtojmë çështjet në lidhje me ata që kanë nevojë për kujdes intensiv apo që janë të sfiduar fizikisht. Gjithashtu, kush konsiderohet se ka nevojë për kujdes përcaktohet nga shkalla e plakjes në mjedisin me të cilin njeriu është i mësuar dhe jo i përjashtuar. Edhe kur familjet nuk janë në gjendje të japin kujdesin e domosdoshëm, ato duhet ta dinë dhe të sigurohen që prindërit e tyre dhe gjyshërit e tyre të marrin kujdesin e mirë. Njerëzit që kanë nevojë për kujdes



dhe infermieret e tyre ju duhet asistencë më të mirë nëpërmjet shërbimeve vullnetare. Ne duam të krijojmë një bashkëpunim më të mirë midis familjeve, institucioneve, stafit infermier me kohë të plotë dhe ndihmësive të nderit në lagje.

64. Politikat tona ripërkufizojnë moshën dhe fundin e punësimit me fitim si fundin e shërbimit aktiv të njeriut. Shumë njerëz mundën dhe dëshirojnë të punojnë më gjatë. Jo vetëm komuniteti dhe njerëzit që janë të angazhuar mbi bazë vullnetare por edhe ekonomia dhe ndërmarrjet e biznesit kanë nevojë të madhe për përfshirje dhe pjesëmarrje aktive të njerëzve të moshuar. Shumë prej tyre e konsiderojnë si diskriminim kundër të moshuarve që të lihen anash jetës së punës apo aktivitetit vullnetar kundër vullnetit të tyre. Ne duam fleksibilitet më të madh në këtë drejtim.

65. Një numër në rritje i njerëzve vuajnë nga mungesa e vëmendjes dhe vetmisë. Ka boshllëk shpirtëror në shoqëritë e pasura. Njerëzit kanë nevojë për njerëz në mënyrë që të ndjehen mirë.

66. Çështjet shoqërore të sotme kanë një cilësi të ndryshme nga ato të së kaluarës. Për këtë arsye, ato kërkojnë zgjidhje të ndryshme politike. Metodatat tradicionale, si ato të dhënies të më shumë parave dhe më shumë personelit dhe nxjerrjes të më shumë rregullave, janë mjete të papërshtatshme për të trajtuar sfidat e reja sociale: qoftë kur është çështja e moslejimit të lagjes dhe lagjeve të tëra të qytetit që të braktisen, ostracizmi i njerëzve me aftësi të kufizuara dhe integrimi i plotë i të huajve. Megjithatë, e gjitha kjo kërkon më tepër se thjesht masa shtetërore. Për tu përballur me çështjet e kohës sonë me sukses, na nevojitet që të kryejmë një lloj të ri solidariteti dhe iniciative personale brenda vetë thelbit të komunitetit.

67. CDU nuk është një parti që me veprim refleksi do të priste që shteti tu jepte zgjidhje të gjitha problemeve shoqërore. Prandaj partia e gjen veten në një pozicion më të mirë se sa partitë e tjera për të gjetur përgjigje ndaj sfidave sociale. Parimi i solidaritetit është më relevant sot se sa kurrë. CDU do të dëshironte të forconte këto njësi të vogla prej të cilave lind: zhvillimi dhe kohezioni. Përgjegjësia personale dhe personaliteti. Njësia e parë dhe më e rëndësishme është familja.



## 2. Forcimi i Themelit të Shoqërisë Sonë – Krijimi i Lirisë së Zgjedhjes për Familjet

68. Familjet po bëhen gjithnjë e më tepër të rëndësishme dhe përbëjnë bazën e shoqërisë. Sipas pikëpamjes sonë, familja është aty ku prindërit marrin përsipër përgjegjësi të përhershme për fëmijët e tyre dhe fëmijët gjithashtu janë të përgjegjshëm për prindërit e tyre. Është vendi ku partneriteti dhe solidariteti praktikohen dhe ngulitet ndjesia e përgjegjësisë tek qeniet njerëzore. Në të, qenia njerëzore pëqet drejt një personaliteti dhe zhvillohet drejt një qenieje të lirë dhe të përgjegjshme. Pikërisht këtu përjetohen vlerat që bazohen tek koncepti kristian i njerëzimit – dinjiteti i pacenueshëm i njeriut dhe marrëdhënia e tij e përzemërt me qeniet e tjera njerëzore.

69. Familja nuk përbëhet vetëm nga familje të reja me fëmijë ose me të rinj. Ajo përbëhet nga të gjitha brezat. Sot, marrëdhëniet midis brezave të ndryshëm, të tilla si fëmijët, prindërit, gjyshërit dhe nipërit dhe mbesat janë bërë më të rëndësishme se kurrë më parë. Ne i çmojmë shërbimet që jepen në solidaritet me familjet në periudha të gjata kohore dhe i mbështetim familjet gjithashtu në vite më të avancuara.

70. Martesa përmbledh shoqërizimin midis burrit dhe gruas. Ajo është baza më e mirë dhe më e sigurt për suksesin në familje. Shprehja e përgjegjësisë së baballarëve dhe nënave ndaj fëmijëve të tyre demonstron në martesë. Edhe në martesë pa fëmijë burrat dhe gratë marrin përsipër përgjegjësinë e përhershme për njëri tjetrin. Kjo është arsyeja përse martesës i kushtohet mbrojtje e veçantë në Ligjin tonë Bazë.

71. Martesa dhe familja përbëjnë rrjetin social më të sigurt kur njerëzit kanë nevojë për njerëz. Lidhjet familjare mbeten për gjithë jetën. Kurrë më parë prindërit dhe fëmijët nuk kanë pasur një kohë kaq të gjatë në jetën e tyre së bashku si tani. Megjithatë, numri i familjeve është mpakur. Aktualisht, çdo brez që vjen është një e treta më e vogël se sa brezi i mëparshëm. Kjo është kontradikta e kohës sonë: një shoqëri e pasur është e varfër në fëmijë. Vendimet e shumta të marra nga

individët percipitojnë në një zhvillim që ka pasoja të konsiderueshme jo vetëm për cilësinë e jetës për qeniet njerëzore por edhe për begatinë dhe mirëqenien e shoqërisë sonë.

72. Për një shumicë të madhe grash dhe burrash një jetë familjare e përmbushur dhe e lumtur përfshin një familje dhe fëmijë. Fëmijët na lidhin me jetën dhe na japin gëzim. Ai që e vendos të ketë fëmijë beson në të ardhmen dhe demonstroi besim dhe optimizëm. Fëmijët pasurojnë jetët tona. Kështu, dikush mund të flasë për humbjen e rëndësisë së familjes; përkundrazi, familja po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme.

73. Vendimi për tu martuar, për të pasur fëmijë dhe për të ngritur një familje është një vendim personal që ne e mbështetim: shteti dhe shoqëria megjithatë nuk duhet të diktojnë njerëzve se si duhet të jetojnë ata.

74. Ne synojmë të krijojmë parakushtet që do tu mundësojnë njerëzve të arrijnë dëshirat e tyre për të nisur një familje dhe për të pasur fëmijë. Disa vendime të shtyra apo të pa implementuara për të pasur fëmijë apo për të nisur një familje kanë pasur reperkusione sociale që ne mund t'i ndryshojmë dhe duhet t'i ndryshojmë veçanërisht nga që jemi të angazhuar për të mbrojtur vlerat e familjes. Ne duam t'i forcojmë familjet dhe të krijojmë struktura miqësore ndaj familjes. Pjesë e këtij ushtrimi është edhe mbështetja e familjeve dëshira e të cilave për pasur fëmijë mund të realizohet vetëm nëpërmjet ndërhyrjes mjekësore.

Qëllimi i politikës sonë familjare është që të arrihet më tepër drejtësi për familjet, d.m.th. të lehtësohet jeta me fëmijët dhe të realizohet dëshira për të pasur fëmijë dhe për të nisur një familje. Ne duam familje të forta në të cilat fëmijët të rriten me personalitet të fortë, të aftë për të marrë përgjegjësitë e tyre dhe për të vepruar në solidaritet me qeniet e tjera njerëzore.

75. Politika jonë për familjen bazohet në vlera tradicionale dhe realitete të reja. Familjet nuk ekzistojnë vetëm për vetvete; ato janë pjesë integrale e strukturës së jetës sonë kulturore dhe sociale, e rrethuar nga struktura të cilat i ndihmojnë ato ose ua bëjnë atyre të vështirë që të përjetojnë jetën familjare dhe që ne duhet t'i japim trajtën.



## ***Në Favor të një Shoqërie Miqësore ndaj Familjes***

76. Brenda familjes, njerëzit përvetësojnë virtytet sociale, detyrat reciproke, besimin dhe përgjegjësinë. Ata përjetojnë aty të jetuarit së bashku të të gjithë brezave. Këtu, njerëzit pranohen pavarësisht nga performanca ose dështimi i tyre. Familjet kanë nevojë për një klimë të sigurt në të cilën të zhvillohen. Vlerat familjare, siç e dimë, janë elementet bazë jo vetëm për zhvillimin e individit por edhe për bashkekzistencën sociale. Pikërisht për këtë dhe për këto arsye e konsiderojmë ruajtjen e vlerave të familjes detyrën tonë.

77. Kjo klimë përfshin njohjen e të drejtave të barabarta të gjinive për zhvillimin e vetes dhe dëshirën e të rinjve dhe të rejave për tu zhvilluar në familje dhe karrierën e tyre. Vlerat e familjes i lidhin si burrat edhe gratë në mënyrë të barabartë.

78. Politika jonë për familjen synon të krijojë parakushtet për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur që të vendosin për një jetë me fëmijë. Prandaj, është e domosdoshme që të krijohet liria e vërtetë e zgjedhjes në mënyrë që të bëhet e mundur për prindërit që të vendosin se si mund ta kombinojnë ata familjen me karrierën. Në familjen kapitaliste të Shekullit 21 të dy prindërit shpesh do të jenë të shqetësuar jo vetëm për bazën ekonomike por edhe për cilësinë emocionale të familjes. Pikërisht meqenëse dashuria dhe devocioni në të ardhmen do të jenë përgjegjësi dhe detyrë reciproke në familje, ne duhet ta ripërkufizojmë dhe ta formësojmë familjen. Aspekte të tjera të vlerave të familjes janë dedikimi, besueshmëria, besimi dhe respekti për individualitetin dhe realizimin e dëshirave të partnerit dhe të fëmijëve.

79. Të gjithë që u japin jetë fëmijëve dhe udhëheqin një jetë familjare në mënyrën e tyre të veçantë meritojnë të respektohen dhe tu njihet përgjegjësia që ata marrin përsipër. Shumë shpesh, prindër të vetëm i ofrojnë këto shërbime në kushte tejet stresuese për të cilat ata kanë nevojë për ndihmë.

80. Ne e respektojmë vendimin e personave të tjerë të cilët e gjejnë plotësimin në forma të tjera të partneritetit. Ne e pranojmë faktin se këto marrëdhënie bazohen gjithashtu në vlera që janë themelore për shoqërinë tonë. Kjo vlen jo vetëm për çiftet e burrave dhe grave të cilët

bashkëjetojnë pa qenë të martuar edhe për partnerët e të njëjtit seks. Ne jemi për tolerancën dhe kundër çdo forme diskriminimi. Si do që të jetë, ne nuk pranojmë asnjë krahasim të këtyre situatave me martesën midis një burri dhe një gruaje si themeli i familjes në shoqëri, ashtu sikurse e refuzojmë të drejtën e birësimit të çifteve të të njëjtit seks.

### ***Tu Kushtohet Kohë Familjeve***

81. Familjet kanë nevojë për kohë: prindërit për fëmijët e tyre dhe fëmijët për prindërit e tyre – kohë për përkushtim dhe mirëqenien e familjes, kohë për aktivitete të përbashkëta dhe për interesa individuale. Ne nuk duam një shoqëri në të cilën interesat ekonomike të jenë e vetmja gjë që ka rëndësi. Kjo është arsyeja përse kemi futur mbështetjen financiare për prindërit. Kjo u mundëson më shumë prindërve që të marrin më tepër kujdes intensiv dhe së bashku me të, për fëmijën e tyre në vitin e parë pa shtrëngime financiare dhe gjithashtu pa u ikur nga pamja karriera e tyre profesionale. Si fazë tjetër, është me vend që të merren masa për të trajtuar çështjet e përputhshmërisë të familjes me karrierën dhe të kujdesit për prindërit dhe gjyshërit. Shërbimet që jepen nëpërmjet infermierisë dhe rritjes duhet të konsiderohen për të njëjta arsye si punë e familjes.

82. Kushtet moderne të punës dhe miqësore ndaj familjes në botën e ekonomisë dhe të biznesit dhe në administratë dhe shërbimin publik janë më të rëndësishme se disa masa të marra nga shteti për jetën e përditshme të familjes. Për shumë kohë mjaft shoqëri kanë provuar se përfilla e duhur e fëmijëve dhe familjeve është i mundur dhe kjo është me përfitim për të dy palët. Një botë e punës, miqësore ndaj familjes, i bën industrinë, shoqëritë dhe institucionet publike më tërheqëse për trurin më të mirë dhe rrit angazhimin dhe besnikërinë. Ne e pranojmë performancën e partnerëve industrialë në këtë fushë dhe u kërkujmë atyre t'i inkorporojnë parimet dhe strategjitë për një drejtpeshim më të mirë midis punës dhe jetës në marrëveshjet e tyre me sindikatat. Na nevojiten vende pune që janë të përshtatshme për familjet dhe jo familje që janë të përshtatshme për vendet e punës.

83. Pajtimi i familjes me karrierën është një punë e nënave dhe baballarëve. Ndarja e përgjegjësisë në rritjen e fëmijëve në mënyrë partnere – miqësore plotëson kërkesën e fëmijës për nënën dhe babain



e tij dhe mund të jetë kyçi për arritjen e përputhshmërisë mes familjes dhe karrierës. Baballarëve që marrin përsipër rritjen e fëmijëve të tyre duhet tu jepet e njëjta njohje sociale si dhe nënave.

### ***Më Tepër Drejtësi për Familjen***

84. Familjet padyshim kanë nevojë për ndihmë financiare. Deri tani ne jemi të shqetësuar, promovimi i familjeve nuk është i barazvlefshme me një akt bamirësie. Përkundrazi është një kompensim i drejtë për arritjet e mëdha që familjet shënojnë dhe një investim në të ardhmen e shoqërisë. Ajo hap mundësi për të bërë një zgjedhje në situatat ku ekzistojnë shtrëngesat materiale. Megjithatë, del se ajo është pozitive për fëmijët dhe kontribuon për forcimin e përgjegjësive materiale. Kjo ndodh me kushtin që asistenca financiare për familjet të bëhet më efikas dhe më transparente për familjet. Duam t'i përqendrojmë masat tona tek arka e familjes.

85. Roli i veçantë i martesës si një komunitet përgjegjësie me partneritet dhe qendër e familjes duhet të vazhdojë ta tregojë veten fort në pagesën e tatimeve. Për këtë arsye, kërkojmë vazhdimin e ndarjes së të ardhurave të çiftit të martuar dhe për shpërndarjen e ndarjes së të ardhurave të familjes në mënyrë të tillë që të kompensohen më mirë shtrëngesat e veçanta që përjetojnë familjet me fëmijë. Familjeve me fëmijë u duhet dhënë më tepër lehtësim nga tatimet se sa familjeve pa fëmijë. Veç kësaj, të gjitha familjeve me fëmijë u duhet dhënë një avantazh në ndarjen e tyre. Gjithashtu, duhet të merren masat për motivimin në mënyrë që prindërit të mund të vendosin për më tepër fëmijë. Ne jo vetëm që kemi nevojë për fëmijë në shoqëri, por kemi nevojë edhe për fëmijë në familje. Në veçanti prindërit të cilët vendosin të kenë tre ose më shumë fëmijë, kanë nevojë për mbështetje të veçantë.

86. Prindërit sakrifikojnë për fëmijët e tyre. Eventualisht i gjithë komuniteti përfiton nga kjo. Kjo është arsyeja përse prindërit që janë në skemën e detyrueshme të pensionit të vjetërsisë duhet të trajtohen në parim më mirë se sa njerëzit e siguar pa fëmijë. Në këtë drejtim, ne do të ofrojmë përmirësimin për periudhat kohore të shpenzuara për rritjen e fëmijës.

## ***E Ardhmja Jonë: Fëmijët***

87. Fëmijët kanë nevojë për fëmijë të tjerë në mënyrë që të zhvillohen dhe të mësojnë virtytet sociale. Prandaj, ne duhet të garantojmë edhe zgjerimin e infrastrukturave që nevojiten aq shumë, si fasilitetet për fëmijët e të gjitha moshave në të cilat ata mund të marrin kujdesin në mënyrë fleksible dhe të besueshme në përputhje me dëshirën e shprehur nga prindërit e tyre. Në të njëjtën kohë jepet edhe një kontribut për rritjen edhe edukimin e fëmijëve. Ne mirëpresim edhe oferta të tjera për fasilitetet e kujdesit për fëmijët që sigurohen nga individë privatë dhe kopshtet e fëmijëve. Ne do të dëshironim që ta bënim frekuentimin e kopshtit falas në një afat të mesëm dhe të detyrueshëm në vitin e fundit. Kjo me kushtin që të jetë i garantuar financimi solid dhe i qëndrueshëm. Fëmija duhet të ketë edhe të drejtën e një vendi në një çerdhe ditore në një afat të mesëm. Familjeve u duhet lehtësim dhe infrastrukturë sociale mbështetëse. Për tu mundësuar familjeve dhe fëmijëve që të zhvillohen mirë, prindërit, institucionet shkollore të kujdesit të përditshëm, institucionet e ndihmës për fëmijët dhe të rinjtë duhet të bashkëpunojnë më tepër se sa aktualisht. Në një afat të mesëm ne do të dëshironim të siguronim para për prindërit që të kujdesen për fëmijët midis moshave një deri në tre vjeç në shtëpi dhe që të mos tu duhet që të shkojnë në shtëpitë e kujdesit ditor.

88. E drejta dhe detyra e rritjes së një fëmije janë para së gjithash prerogativë e prindërve. Shteti nuk mundet dhe nuk duhet t'i zëvendësojë prindërit nën ndihmën për rritjen e fëmijës. Në qoftë se nevojitet, ai duhet më tepër të ndihmojë të rinjtë dhe prindërit e tyre që të gjejnë vende pune. Ai duhet gjithashtu të përmbushë detyrimet e tij për mbrojtjen e fëmijëve. Neglizhimi i fëmijëve dhe dhuna kundër tyre duhet të kundërshtohet me forcë. Mirëqenia e fëmijëve është një shqetësim real për ne.

89. Fëmijët janë e ardhmja jonë. Gjermania edhe një herë duhet të bëhet vendi në të cilin jetesa me fëmijët është e lehtë dhe një çështje e natyrshme. Kjo është detyrë për të gjithë ne.



## VI. GJERMANIA SI NJË KOMB I ARSIMIT DHE KULTURËS – PËRGGJIGJE PËR SHOQËRINË E BAZUAR TEK DIJET

### 1. “Më Tepër Arsim për Të Gjithë” – nga Fillimi Gjatë Gjithë Jetës

90. Arsimi është kyçi i shanseve në jetë për secilin person dhe është me rëndësi të madhe për vlerat që ruajmë – si dhe për vlerat që dëshirojmë të kultivojmë. Qëndrueshmëria e begatisë mund të sigurohet vetëm me sa më shumë arsim për sa më shumë njerëz. Ajo do të na bëjë të mundur që të kapërcejmë sfidat e së ardhmes dhe të kapim mundësitë që ofron ndryshimi.

91. Liria dhe dinjteti i njerëzimit, pasuritë dhe e gjithë gama e mundësive njerëzore mund të realizohen në qoftë se talentet dhe mjeshtëritë e të rinjve promovohen, kërkohen dhe zhvillohen që prej fillimit. Dëshira dhe aftësia për të performuar mund të ushqehen në një klimë kureshtjeje dhe fryme zbulimi madje edhe jashtë ndërtesave të shkollave.

92. Sfondi social i një personi nuk do të jetë faktori vendimtar për të ardhmen e tij. “Avancimi i karrierës nëpërmjet arsimit” është qëllimi ynë social – politik. Çdo njeri duhet të përfshihet. Askush nuk duhet të lihet mbrapa. Varfëria fillon shpesh si mungesë arsimit. Pjesëmarrja në arsim dhe trajnim është një domosdoshmëri e mundësive të barabarta.

93. Siguria sociale dhe kohezioni social kërkojnë që ne t’i trajnojmë fëmijët që të bëhen personalitete të forta, të cilët besojnë tek aftësitë e tyre, mësojnë që të tregojnë konsideratë për të tjerët dhe janë në gjendje që të pranojnë përgjegjësinë dhe të demonstrojnë solidaritetin.

94. Në sajë të një sistemi arsimor të drejtë dhe efektiv do të jemi në gjendje të transmetojmë dhe të ruajmë ato vlera të cilat janë themeli i begatisë dhe sigurisë. Arsimi është me rëndësi strategjike për të transmetuar vlerat tona morale dhe ekonomike.



95. Një shoqëri e bazuar tek arsimit lulëzon duke zbuluar çdo talent dhe duke e promovuar atë sa më herët që të jetë e mundur: ne asnjëherë nuk mund të pohojmë që kemi personel të trajnuar të mjaftueshëm. Në qoftë se qeniet njerëzore jetojnë dhe punojnë më gjatë, matura ekonomike dhe sociale dhe angazhimi ynë për njëri tjetrin kërkojnë që ne të përvetësojmë në të gjitha etapat e jetës sonë kompetenca të reja. Mësimi gjatë gjithë jetës është siguria më e mirë për tu përballur me peripecitë e jetës. Kur dijet rinovohen me shpejtësi më të madhe se kurrë dhe karrierat e ardhshme bëhen gjithnjë e më të sofistikuara, atëherë çështja e përvetësimit të arsimit dhe trajnimit optimal bëhet çështje sociale e Shekullit 21.

96. Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje duhet të kërkojmë orientimin tek disa udhëzime. Na duhet më tepër orientim, më tepër fleksibilitet dhe më tepër transparencë në sistemin tonë të arsimit. Ne duam të përmirësojmë cilësinë dhe performancën në të gjitha sferat. Ne duam të rivlerësojmë mësimnxënien në praktikë dhe me praktikë dhe të zgjerojmë përkufizimin e arsimit për të mbuluar idealet që ja vlen të ruhen dhe që të jetë në përputhje me kërkesat e reja. Ne për këtë duam arsimin që nga mosha e herët dhe gjatë gjithë jetës. Dhe këtë ne e bëjmë për arsye humane, sociale dhe ekonomike. Është më mirë, më e drejtë dhe më ekonomike si për fëmijët edhe për të rriturit që të investojnë në arsim dhe në trajnim më mirë se sa të përpiqemi të korrigjojmë prirjet e gabuara nëpërmjet transferimit të pagesave apo masave sociale. Kjo është arsyeja për se ne udhëhiqemi nga thënia e urtë: "Parandalimi është më i mirë se kurimi".

### ***Arsimi që prej Fillimit***

97. Fëmijët dhe të rinjtë janë krijuar dhe mendje hapur, në qoftë se ata vendosen në mjedisin e duhur. Kështu, ne duam të forcojmë familjet si dhe të krijojmë institucionet e reja të mësimnxënies për fëmijët. Është e domosdoshme që të ndërlihet gjithnjë e më fort mësimnxënia në fëmijërinë e hershme me arsimin formal në shkollë. Mendojmë se ndarja e arsimit nga kujdestaria parashkollore është artificiale dhe jashtë kohe. Fëmijët kanë nevojë që herët për një mjedis emocionues ku të eksplorojnë dhe të zbulojnë botën në formë loje. Qendrat e kujdesit dhe çerdhet gjithashtu janë institucione arsimore. Kjo është arsyeja për se ne duam të krijojmë parakushtet për promovimin e fëmijëve nga



tre deri në dhjetë vjeç individualisht dhe sipas aftësive dhe shprehive të tyre. Ne mbështetim vazhdimin e trajnimit të specialistëve. Edhe karrierat duhet të jenë transparente.

98. Sistemi i diferencuar shkollor i ka qëndruar testit të kohës dhe ka provuar se është një model i suksesit. Ne hedhim poshtë sistemin e shkollës gjithëpërfshirëse. Për ne ylli që na drejton është: “Pas çdo përfundimi, vazhdimi”. Duhet të krijohet kuadri i duhur për të përmirësuar në mënyrë të vazhduar shkollat dhe për t’i bërë ato të përshtatshme për nxënësit. Çdo nxënës ka aftësi dhe e meriton që të shkojë në shkollën që do të mundësojë rritjen e fuqive të tij. Ne nuk presim që një shkollë me kushte të ngjashme të prodhojë rezultate më të dobëta se sa shkollat e krahasueshme.

99. Ne duam që të marrim masa të ndryshme në lidhje me konkurrencën e shkollave për arsimin më të mirë. Ne duam standarde kombëtare të detyrueshme dhe një vlerësim efektiv të hapur dhe transparent, por ne duam gjithashtu më tepër liri dhe përgjegjësi personale për shkollat në mënyrë që ato të ndjekin për veten e tyre mësimet të cilësisë më të lartë. Ne duhet të ripërqendrohemi tek kërkimi arsimor i bazuar mirë dhe raportimi i vazhdueshëm për çështjet arsimore. Standardet arsimore për të cilat bihet dakord duhet të implementohen fort. Bashkëpunimi mes shteteve duhet të lejojë krahasimin, veçanërisht në lidhje me provimet përfundimtare dhe lëvizshmërinë për pasojë. Ne jemi të angazhuar për përgjegjësinë e shtetit për shkollën dhe sistemet arsimore. Institucionet arsimore të krijuara nëpërmjet iniciativës së lirë private janë pjesë e domosdoshme e këtij sistemi arsimor.

100. Përgjegjësi më e madhe personale nevojitet për të kryer këtë detyrë dhe për tu mundësuar shkollave që të implementojnë marrëveshjen e tyre. Mësuesit japin një kontribut të madh në shoqëri. Trajnimi i tyre është elementi kyç për arsimin e dobishëm dhe efikas në shkolla. Veç trajnimit të diferencuar dhe të bazuar mirë të specialistëve që ata mund të kenë, duhet të vihet në qendër të vëmendjes praktika pedagogjike. Trajnimi i mëtejshëm duhet të shtrihet rregullisht dhe të përditësohen kompetencat. Një numër i përshtatshëm mësuesish të kualifikuar është një parakusht për cilësinë e shkollës. Edhe për ta, duhet t’ia vlejë arritja.

101. Qëllimi i shkollës shkon përtej transferimit të njohurive. Të rinjtë kanë nevojë edhe për vlera dhe virtyte sociale në mënyrë që të përballojnë me sukses jetën e tyre. Respekti për demokracinë dhe sundimin e ligjit duhet të transmetohet përsëri e përsëri. Arsimi politik është i pashmangshëm. Ai lidhet me promovimin e programeve të shkëmbimit në Europë për nxënësit e shkollave dhe të rinjtë në përgjithësi. Arsimi muzikor dhe fetar janë të qenësishëm për zhvillimin tërësor të një personaliteti. CDU është e mendimit se arsimi fetar duhet të jetë pjesë e programit mësimor shkollor në të gjithë shtetet federale. Përveç mësimave fetare protestante dhe katolike, duhet të mësohen edhe mësimet e feve të tjera në qoftë se lind nevoja, në gjuhën gjermane dhe me mësues të trajnuar në Gjermani për këtë gjë. Shkollat duhet të inspektohen nga shteti.

102. Arsimi nuk fillon vetëm në shkollë dhe nuk mbaron pas shkollës. Numri aktual i fazave të arsimit dhe trajnimit nëpër të cilat kalojnë të rinjtë duhet të reduktohet. Ato duhet të fillojnë më herët dhe të mbarojnë më herët. Megjithatë, ato duhet të plotësohen nga kurse të mëtejshme trajnimi më vonë në jetë. Aftësia për të mësuar gjatë gjithë jetës duhet të kultivohet sa më herët që të jetë e mundur në jetë dhe të ushqehet në shkollë dhe me sesione trajnimi dhe të plotësohet me trajnime të cilësisë së lartë dhe të dobishme të mëtejshme në të gjitha etapat e jetës. Sipërmarrjet mund të luajnë një rol të rëndësishëm këtu duke krijuar shanse për tu trajnuar të rinjtë dhe për tu mundësuar punonjësve të rritur që të përvetësojnë trajnim të mëtejshëm.

### ***Shumanshmëria, Diferencimi dhe Fleksibiliteti***

103. Një nga pikat e forta të sistemeve tona arsimore është natyra e shumëllojshme e koncepteve tona të mësimnxënies dhe të metodave të mësimnxënies. Ne jemi të angazhuar për një sistem shkollor të orientuar nga talentet dhe të diferencuar i cili ofron jo vetëm shanse të orientuara nga praktika por edhe të orientuara nga teoria për trajnimin. Këto aspekte të ndryshme duhet të mbeten, megjithatë, sa më transparente dhe fleksibël që të jetë e mundur. Performancat e nivelit të lartë kanë rëndësi të madhe për të ardhmen e vendit tonë. Si të tillë, duhet të promovohen personat shumë të talentuar.



104. CDU mbështet një zgjerim të përshtatshëm të sistemit shkollor gjithëditor duke pasur parasysh siç duhet përfshirjen e klubeve dhe grupeve të nderit. Pritshmëria jonë këtu është se shkollat gjithëditore do të ofrojnë një rritëm ditor të strukturuar nga ana pedagogjike që do të përfshijë arsimin shëndetësor, sportin, muzikën dhe aktivitetet e artit dhe transmetimin e njohurive të kompetencave sociale.

105. Njerëzit me aftësi të kufizuara në mësimnxënie dhe njerëzit e sfiduar fizikisht kanë nevojë për vëmendje të veçantë, inkurajim dhe asistencë e cila do të lidhet me nevojat e tyre individuale. Shoqërimi i njerëzve me aftësi të kufizuara me njerëzit me aftësi të pakufizuara, pikat e tyre të forta dhe të dobëta, të cilat janë një çështje e natyrshme, duhet tu bëhen të qarta fëmijëve sa më herët që të jetë e mundur, në mënyrë që të parandalohet absolutisht çdo barrierë që mund të zërë vend mendërisht ose që mund të manifestohet nëpërmjet sjelljes.

### ***Cilësia dhe Arritja***

106. Ne duam që cilësia dhe arritja të jenë kritere të qenësishme për të gjithë sistemin arsimor. Ne shikojmë tek parimi “Kërko dhe promov” një parim të përgjithshëm për aktivitetet pedagogjike. Qëllimi dhe objektivi i çdo përpjekje është që të nxirren në pah pikat e forta të çdo të riu, të promovohet besimi i tyre dhe aftësitë e tyre, tu lejohet atyre që të kalojnë nëpërmjet përvojave të dobishme për të qenë në gjendje që të arrijnë diçka në jetë.

Këto parime dhe maksima, sipas mendimit tonë, vlejnë për këdo, pavarësisht se sa të shumëfishta janë talentet, përvojat apo shprehitë tona. Ai që kërkon nga të tjerët ose u beson atyre për atë që ata janë në gjendje ta bëjnë ka mendësi sociale.

107. Prandaj, ne duam më tepër arsim dhe arsim më të mirë për të gjithë. Veç kësaj, do të dëshironim që të shtronim rrugën për sa më shumë nxënës që të jetë e mundur që të arrijnë rezultatet maksimale. Parashkrimi i lëndëve që merren në provim apo përmbajtjeve të tjera të mësimnxënies dhe kompetencat kyçe në programet tona mësimore themelore në këtë drejtim është një kontribut vendimtar.

108. Arsimi për të gjithë, transparenca sociale dhe performancat e nivelit

të lartë mund të arrihen vetëm nëpërmjet kompetencës gjuhësore. Gjuha është çelësi për arsimin dhe trajnimin dhe integrimin në botën dhe shoqërinë profesionale. Një numër në rritje i fëmijëve, veçanërisht ata me prejardhje imigranti, nuk kanë njohuri të përshtatshme të gjuhës gjermane. Që fëmijët të jenë në gjendje të bashkohen në biseda dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në arsim që nga dita e parë në shkollë, është e domosdoshme që të krijohet promovimi i gjuhës së synuar në kopshte, teste të detyrueshme gjuhësore përpara regjistrimit dhe programet paralele intensive të mësimit të gjuhës për fëmijët me mangësi. Në këtë drejtim, edhe familja e fëmijës duhet të përfshihet shumë. Në të njëjtën kohë, kompetenca shumë-gjuhësore dhe ndërkulturore e këtyre fëmijëve duhet të merret parasysh dhe të promovohet qëllimisht. Të gjithë fëmijëve u kërkohet që të përvetësojnë që nga viti i parë i tyre në shkollë të paktën një gjuhë të huaj përveç gjuhës gjermane.

109. Cilësia e arsimit të universitetit dhe për pasojë kualifikimi i atyre që mbarojnë universitetin dhe kërkuesve kanë një rëndësi jetësore në shoqërinë e bazuar tek arsimi. Ne duam të sigurojmë kualifikimet më të larta dhe të ruajmë pozicionin e Gjermanisë si qendër e njohur ndërkombëtarisht për talentet. Për t'u arritur ky qëllim është e domosdoshme që të kemi një sistem universitetesh, kolegësh për trajnimin e mësuesve, akademi të muzikës dhe artit, shkolla të larta të shkencave të aplikuara, universitete të arsimit për sipërmarrjet, institucione të larta arsimore me orientim profesional dhe trajnim në detyrë dhe institucione private të arsimit të lartë. Çdo lloj institucioni terciar duhet të asistohet. Për të munduruar që institucionet terciare të funksionojnë në mënyrë të besueshme, buxheti kombëtar duhet t'i plotësojë nevojat siç duhet për infrastrukturën bazë të këtyre institucioneve. Duke përdorur pagesa kursi të menaxhueshme nga ana sociale, institucionet e arsimit të lartë duhet të jenë në gjendje që të përmirësojnë, me objektiva specifike, kurset e mësimdhënies që ata ofrojnë dhe të zhvillojnë hartimin e kurseve speciale. Ekselencia edhe në mësimdhënie duhet të jetë një çështje sistematike në universitetet gjermane dhe në institucionet e tjera terciare.

Studentet duhet të inkurajohen të zhvillojnë më tej pikat e tyre të forta, ofrtë në kurset e orientuara nga praktika apo në trajnimin në shkencë dhe kërkimin. Një ndryshim nga një universitet tek tjetri duhet të jetë

i mundur me të njëjtin kualifikim. Rritja e programeve ndërkombëtare të shkëmbimeve kërkon që studentët të përvetësojnë disa kualifikime kyçe, të cilat në të ardhmen do të jenë me përfitim për Gjermaninë si një qendër e aktiviteteve ekonomike. Këtu, edhe koordinimi midis kurseve, profesioneve shkencore dhe familjeve do të luajë një rol të rëndësishëm. Një kusht për suksesin në këtë drejtim është përhapja e skemës së të drejtave të studimit.

110. Uniteti i kërkimit dhe mësimdhënies vazhdon të jetë një parakusht i qenësishëm për historinë e suksesit të universiteteve gjermane. Për tu mundur atyre që të vazhdojnë në këtë mënyrë, duhet të inkurajohet kërkimi akademik pararojë dhe konkurrenca mes universiteteve duhet të forcohet. Ne duam që tu japim universiteteve liri dhe përgjegjësi personale dhe më pak ndërhyrje shtetërore. Ne do ta çlirojmë kërkimin në Gjermani nga të gjitha pengesat burokratike.

### ***Njohuritë Praktike dhe Aftësia***

111. Ne duam të krijojmë një drejtpeshim të arsyeshëm midis teorisë dhe praktikës. Më tepër se kurrë, shumë profesione praktike tani kanë nevojë për rritjen e tyre të ardhshme për më tepër njohuri teorike. Në shumë profesione akademike, është një avantazh të përvetësosh njohuritë praktike sa më herët dhe sa më intensivisht që të jetë e mundur. Ne duam ta rivlerësojmë mësimnxënien me përvojën praktike. Universitetet e shkencave të aplikuara dhe universitetet e arsimit të sipërmarrjeve, për këtë arsye, janë një histori suksesi sepse ky injektim reciprok i teorisë dhe praktikës, karrierës dhe studimeve ka qenë vërtetë i suksesshëm.

112. Ky sistem i dyfishtë është një model për kombinimin e teorisë dhe praktikës për trajnimin profesional në Gjermani. Ai ka avantazh të lartë në konkurrencën ndërkombëtare dhe parandalimin më të mirë të papunësisë të rinisë. Këtu, industrinë dhe shkollat ndajnë përgjegjësinë për trajnimin. Ai hap perspektiva për futje të reja në vende pune dhe avancim karriere dhe për trajnim profesional gjatë gjithë jetës. Kjo është edhe një mënyrë e nxitjes së interesit tek të rinjtë dhe të rejat në shumanshmërinë e mjeteve dhe faciliteteve të trajnimit të disponueshme për ta gjatë orientimit të karrierës së tyre.

Disa të rinj nuk janë në gjendje që të kryejnë me sukses ndonjë trajnim profesional në përpjekjen e parë të tyre. Sot, shumë shpesh, atyre u lëshohen certifikata për atë që nuk janë në gjendje ta bëjnë në vend që tu japen certifikata për atë që mund të bëjnë. Jemi të mendimit se secili është në gjendje të bëjë diçka. Kjo është arsyeja përse të rinjtë që janë më pak efikas, kanë nevojë për shanse të tjera për të hyrë në vende të reja pune. Këto mundësi do të çojnë në kualifikime që mund të përdoren për të fituar vende pune për të cilat mund të lëshohen certifikata. Kjo nga ana e saj mund të çojë në kontakte dhe hapje të mëtejshme. Çdo lloj trajnimi është më i mirë se sa mospasja e trajnimit fare.

Për të qenë të suksesshëm në këtë ushtrim na duhen procedura të zhdërvjellëta në sistemin e dyfishtë të trajnimit. Për këtë qëllim shërbimi më i mirë këtu janë trajnimi cilësor në etapa dhe veçanërisht pjesët që përbëjnë trajnimin si module të kufizuara dhe të standardizuara të mësimnxënies për të cilat certifikatat lëshohen në mënyrë autonome dhe konsiderohen si performancë për trajnimin. Veç kësaj, duhet të ushqehet bashkëpunimi midis aktorëve, veçanërisht midis shkollave që japin arsimin e përgjithshëm dhe atyre që japin arsimin profesional. Për ta bërë trajnimin e dyfishtë më tërheqës duhet të përmirësohen perspektivat e përkohshme dhe përjashtimore për të diplomuarit e institucioneve profesionale që dëshirojnë të futen në universitete.

113. Të rinjtë zhvillojnë kompetencat e tyre krijuese në mënyrë të jashtëzakonshme kur në fillim të jetës së tyre profesionale e ndjejnë se ato nevojiten dhe inkurajohen. Duhet të formohen për këtë arsye kushtet bazë në mënyrë të tillë që punëdhënësit privatë dhe publikë të tregojnë gatishmëri më tepër se më parë për të ofruar fasilitetet trajnuese. Në këtë rast, ne mbështetemi tek vullnetarizmi, ndjenja e përgjegjësisë dhe motivimi me objektiv në vend të përdorimit të forcës së shtetit.

114. Mobiliteti përbën një pjesë të kërkesave të botës së punës. Kjo është arsyeja për se neve na nevojitet mjedisi arsimor europian në të cilin kurset arsimore dhe përfundimi dhe certifikimi i kurseve të jenë të krahasueshme dhe të njihen reciprokisht.



115. Ne kemi një detyrë jetësore që të lemë pas një sistem arsimor funksionues. Arsimi është stimulimi i të gjithë fuqive dhe aftësive të qenies njerëzore për tu mundësuar atyre që të zhvillohen si individë dhe personalitete që janë në gjendje të marrin vendimet vetë. Ne do të përkrahim sistemin arsimor duke e rinovuar atë. Vërtetë, në kohërat e pasigurta dhe të errëta që po jetojmë tani, të cilat, sidoqoftë, na hapin shanse të shumta, i gjithë sistemi arsimor po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Si i tillë, ne do të dëshironim të ruanim gjallërinë e arsimit në mënyrë që tu jepen ideve dhe idealeve vlerat e tyre. Në të njëjtën kohë ne do të forcojmë arsimin ekonomik, matematik dhe të shkencave të natyrës. Arsimi dhe politika e kërkimit i cili ngushton horizontin e tij vetëm në përdorimin praktik është i destinuar të dështojë. Pjesëmarrja, siguria dhe begatia për të gjithë nëpërmjet arsimit për të gjithë janë vetëm të mundshme, në qoftë se arsimi në vetvete ka kuptim dhe qëllim dhe në qoftë se vlerat e tij pranohen dhe çmohen.

## 2. Gjermania Kureshtarë: Kërkimi Shkencor Siguron Begatinë dhe Zhvillimin

116. Shkencat dhe kërkimi vendosin për pasurinë materiale dhe jo materiale të një shoqërie dhe kontribuojnë në zgjidhjen e sfidave serioze që paraqiten nga rritja e popullsisë në botë. Këto janë esenciale për përparimin në mjekësi, sigurinë botërore të ushqimit, sigurinë e përgjithshme, komunikimin, lëvizshmërinë miqësore ndaj ambientit dhe furnizimin me energji. Shkencat humane nga ana e tyre japin njohuritë e domosdoshme për orientimin në një botë që ndryshon me shpejtësi.

Pasuria e ideve dhe krijimtaria e qenies njerëzore janë avantazhe jetësore që Gjermania i ka në këtë botë konkurruese. Vetëm nëpërmjet shpirtit të zbulimit dhe pasurisë së shpikjeve që ne mund të ofrojmë përgjigje bindëse për pyetjen: me çfarë dhe si duam të jetojmë nesër: idetë e reja të arritjes së bollëkut të së ardhmes kërkohen nga ana tjetër një rol më thelbësor se sa i kemi akorduar kërkimit shkencor në ndërgjegjen publike dhe nga ana tjetër, implementimin e tij nëpërmjet



produkteve të përfunduara të tregtueshme në Gjermani. Si ekonomia më e madhe në Europë, Gjermania duhet të luajë një rol vendimtar në kërkimin dhe zhvillimin e teknologjive kryesore në Shekullin e 21 për të ruajtur dhe për të shtyrë më tej aftësinë e saj konkurruese ndërkombëtare.

117. CDU është e angazhuar për lirinë e shkencës dhe kërkimit. Shanset dhe risqet e përfshira në kërkimin shkencor duhet të peshohen në mënyrë të ndërgjegjshme. Liria e kërkimit shkencor përfundon aty ku ndikohet negativisht dinjiteti njerëzor ose kur rrezikohet krijimi i Zotit.

118. Gjermania zë një pozicion udhëheqës ndërkombëtar në shumë fusha të kërkimit që duhet të zgjerohen. Kërkimi bazë në veçanti, i cili në radhë të parë ka synimin që të japë njohuri dhe të shërbejë vetëm në mënyrë indirekte në qëllimin ekonomik, kërkon subvencione nga shteti. Kërkimi në universitete ka të drejtën e veçantë që të marrë subvencione të veçanta nga shteti. Sepse edhe shumica e brezave të njëpasnjëshëm të shkencëtarëve trajnohen aty.

119. Prandaj, idetë e reja çojnë në begatinë dhe zhvillimin e të ardhmes në qoftë se njohuritë bazë të përvetësuara kthehen në zbatim konkret, veçanërisht për prodhimin e produkteve të tregtueshme dhe për dhënien e shërbimeve. Kërkimi i orientuar nga e ardhmja kërkon ngritjen e rrjeteve dhe aleancave strategjike të kërkimit, bazë kërkimin e aplikuar, institucione mësimore të larta, institute kërkimi dhe industri. Arritjet e novacionit shpesh nuk janë gjë tjetër veçse shpikje të individëve. Kufijtë kombëtarë përshkohen nëpërmjet bashkëpunimit midis institucioneve kërkimore dhe shoqërive ndërkombëtare. Kjo është arsyeja për se ne duhet t'i kombinojmë të gjitha përpjekjet në të gjitha këndet dhe nivelet.

120. Si pjesë e kërkimit modern, është e domosdoshme të mendojmë përtej disiplinave individuale. Problemet dhe sfidat e brezave kërkojnë kërkim gjithnjë e më ndërdisiplinor. Zgjidhjet për vendosjen e prirjeve shpesh çojnë në projekte kërkimi ndërdisiplinore të disa fushave. CDU pret përgatitjen e të gjithë disiplinave, shkencave humane, shkencave sociale, shkencave të natyrës dhe shkencave të inxhinierisë që të bashkëpunojnë.



121. Shkenca, industria dhe shteti janë së bashku përgjegjëse për inovacionin dhe për të ardhmen e aftësisë konkurruese të Gjermanisë si qendër e kërkimit teknologjik dhe shkencor. Në vitin 2015 shpenzimi për kërkimin dhe zhvillimin duhet të rritet në 4 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP). Prandaj, shoqëritë dhe qeveritë federale dhe të shteteve duhet të japin kontributin e tyre përkatësisht. Politika financiare e qeverisë për këtë arsye duhet të veprojë si një motor novacioni dhe të krijojë një kuadër të përshtatshëm për incentivat tatimore në mënyrë që të tërheqë më tepër investime. Ato përbëjnë një parakusht të rëndësishëm për novacionin në Gjermani.

122. Transferimi i gjetjeve të kërkimit në industri kryhet veçanërisht nëpërmjet rrjeteve inovative. Shkëmbimi reciprok midis shkencëtarëve, shoqërive dhe sponsorizuesve duhet të zgjerohet dhe të forcohet si një element jetësor i sistemit tonë të kërkimit. Hetimet që lindin nga institucionet e mësimin të lartë dhe për pasojë krijimi i shoqërive të bazuara tek teknologjitë e reja si dhe imigracioni i shoqërive novatore nga vendet e huaja duhet të inkurajohet dhe të mbështetet. Rruga nga rezultatet e kërkimit tek produkti i tregut është jashtëzakonisht e vështirë, veçanërisht në lidhje me firmat e teknologjisë të lartë.

123. Shoqëritë e mesme të cilat kanë një impakt të lartë në ekonominë e Gjermanisë dhe krijojnë numrin më të lartë të vendeve të punës në vend shpesh nuk kanë departamentet e tyre të kërkimit. Veçanërisht është e rëndësishme për ne që të forcojmë kapacitetin e tyre kërkues dhe novator. Aktorët rajonalë në industri, shkencë dhe politikë duhet të mbështeten nga qeveritë federale dhe shteti për të identifikuar dhe zgjeruar ndonjë potencial novator. Në të njëjtën frymë, duhet të forcohet akoma futja e ndërmarrjeve të biznesit të mesëm në promovimin e kërkimit evropian.

124. Që të ketë sukses novacioni, kërkuesit nuk duhet të shtrëngohen në mënyrë të panevojshme nga burokracia. Kërkimi ka nevojë për forma fleksible të organizimeve dhe më tepër mirësi për eksperimentim në projektimin e institucioneve shkencore. Liria dhe përgjegjësia personale, ekselencia dhe konkurrenca si dhe niveli i lartë i trajnimit janë udhëzime të CDU-së.

### 3. Kultura: Shprehja e Identitetit Kombëtar

125. Gjermania është një komb i kulturës europiane, karakterizuar veçanërisht nga tradita kristiane – hebre dhe iluminizmi. Arti dhe kultura formësojnë jo vetëm identitetin e individit por edhe të kombit tonë. Ne duam ta ruajmë trashëgiminë e pasur kulturore të vendit tonë e cila përcaktohet nga diversiteti i Shteteve Federale dhe autoriteteve vendore.

126. Diversiteti kulturor është pjesë e shoqërisë tonë vibrante, kontribuon në cilësinë e jetës në Gjermani dhe kontribuon në përgatitjen tonë për të guxuar në territor të ri. Vizioni jonë kulturor është një Gjermani kozmopolite e cila si rezultat i traditave të saj është e hapur ndaj kulturave të tjera. Vitaliteti dhe tërheqja kulturore e Gjermanisë bazohen sot edhe në shkëmbimet e saj të stileve të jetës me njerëz dhe kultura të tjera.

127. Ne jemi të angazhuar për lirinë e artit. Shteti dhe politika nuk përgjigjen për artin dhe format e saj të shprehjes. Megjithatë, ai përgjigjet për kushtet në të cilat ato lulëzojnë. Arti është një formë e veçantë e shqyrtimit të realitetit. Ai mbijeton nga kureshtja dhe aventura. Edhe forcimi i talenteve krijuese është një faktor vendimtar për konkurrencën e Gjermanisë. Ekonomia kulturore është një faktor i rëndësishëm për përcaktimin e saj. CDU është e angazhuar që të promovojë artin dhe kulturën si një detyrë madhore publike për qeverinë federale, shtetet federale dhe autoritetet vendore. Kjo vlen për ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore si dhe promovimin e artit bashkëkohor. Ajo përfshin arritjet kryesore në art si dhe kulturën me bazë të gjerë. Ajo përfshin edhe traditat e rrënjosura thellë si dhe mënyrat popullore të shprehjes dhe kontributeve nga refugjatët, të vendosurit vonë dhe imigrantët. Promovimi i kulturës nuk është e njëjta gjë me dhënien e subvencionit ekonomik. Vërtet është një investim i domosdoshëm në të ardhmen e shoqërisë sonë.

128. Përveç përgjegjësisë së shtetit, edhe përfshirja e shoqërisë civile është absolutisht e domosdoshme. Ne duam të përmirësojmë kushtet kuadër për promovimin privat të kulturës nëpërmjet fondacioneve, patronazheve dhe sponsorizimeve.



129. Pjesë e kulturës sonë është kujtesa e gjallë dhe përfshin të gjithë historinë gjermane me të gjitha uljet dhe zbritjet e saj.

Përvojat e periudhave të nacional socializmit dhe veçanërisht të holokaustit të veçantë, janë ngulitur thellë në kujtesën e qytetarëve të Republikës Federale Gjermane. Një lloj tjetër përvoje ka të bëjë me përballimin e diktaturës SED. Me rëndësi të madhe janë gjithashtu revolucioni i vjeshtës 1989 dhe ribashkimi i Gjermanisë. Historia e komunizmit në RDGJ nuk është thjesht një ngjarje e Gjermanisë Lindore. Ashtu si historia e nacional socializmit, kjo përbën një pjesë të historisë kombëtare gjermane si dhe historisë të Europës. Ajo lidhet me fatin e atyre njerëzve që u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Thjesht përmendja e viktimave të dëbimit dhe trashëgimisë së tyre kulturore përbën një pjesë të kujtesës së gjallë të përvojave të një populli të tërë. Ne nuk do të hedhim në harresë edhe arritjet e shkëlqyera të rindërtimit dhe integritit të njerëzve që u zhvendosën dhe të refugjatëve pas Luftës së Dytës Botërore.

Një përkujtim i përshtatshëm dhe dinjitoz i lirisë dhe rezistencës të paqes dhe kontributeve të pajtimit dhe arritjeve të ndërtimit ekonomik dhe politik është i pashmangshëm për hir të mënyrës të ndershme të trajtimit të historisë tonë. Ajo përbën edhe një pjesë të spikatur të konceptit të kombit tonë dhe të ndërtimit të traditës së tij demokratike. Gjithashtu ai demonstroi hedhjen poshtë të çdo sistemi totalitar dhe diktatorial.

Arsimi, shkenca, letërsia dhe arti në veçanti thirren që të kontribuojnë për të rritur ndërgjegjen e njerëzve tanë dhe për tu mundësuar atyre që ta shqyrtojnë gjithë historinë Gjermane.

130. Pa kulturë nuk ka arsim dhe pa arsim nuk ka kulturë. Arsimi kulturor është i domosdoshëm për të ndihmuar individët që të zhvillojnë personalitetet e tyre dhe të marrin pjesë në procesin demokratik dhe në jetën e shoqërisë. Dimensionin kulturor është një parakusht i qenësishëm për transferimin e orientimit dhe dijeve. Të rinjtë në veçanti duhet të prezantohen me artin dhe kulturën sa më herët që të jetë e mundur. Është e vetmja mënyrë se si mund të rritet kërkesa dhe oferta për karriera artistike dhe mjedise kulturore. Arsimi kulturor duhet të fillojë në shtëpi dhe nuk duhet të mbarojë pas shkollës.

Sipas mendimit të CDU-së, arsimi kulturor është një pjesë integrale e sistemeve arsimore publike dhe atyre të asistuara.

131. Gjuha gjermane është më tepër se sa thjesht një mjet komunikimi. Ajo është një aspekt i gjallë i kulturës të vendit tonë dhe një forcë lidhëse në shoqërinë tonë. kjo është arsyeja për se ne jemi të përgjegjshëm për të trajtuar gjuhën gjermane me kujdesin dhe xhelozinë më të madhe.

132. Politikat kulturore dhe arsimore jashtë shtetit shërbejnë për të përhapur gjuhën gjermane dhe aspekte të tjera të kulturës tonë dhe duhet të promovojë dialogun midis kulturave të tjera në botë si dhe demokracinë dhe të drejtave të njeriut. Puna e shkollave dhe institucioneve shkencore si dhe qendrave dhe organizatave kulturore të cilat përpiqen për t'i dhënë një pamje autentike vendit tonë jashtë shtetit duhet të forcohen. Politika e jashtme kulturore promovon reputacionin e Gjermanisë në botë dhe bashkëpunimin e Gjermanisë me partnerët e saj ndërkombëtarë duke përfshirë botën ekonomike.

133. Media e lirë përbën një përbërës të qenësishëm të rendit tonë demokratik. Ato janë pjesë e kulturës sonë e cila meriton mbrojtje të veçantë dhe një faktor i rëndësishëm ekonomik me përgjegjshmëri të madhe. Ruajtja e diversitetit e cilësisë së përmbajtjes së medias ka përparësi të madhe në një mjedis mediatik që ndryshon gjithmonë. Gjithashtu është relevante që të njihet konkureshmëria ndërkombëtare e shërbimeve gjermane të medias. Në interes të pavarësisë së medias, ne kundërshtojmë çdo përfshirje financiare, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të partive politike në media dhe sipërmarrjet e medias.

Si pjesë e diversitetit të masmedias, ne kemi edhe sistemin e dyfishtë të testuar në mënyrë tradicionale të stacioneve shtetërore dhe private. Politika e medias duhet të sigurojë që të ketë një konkurrencë të ndershme e cila u jep të dy sistemeve një shans të barabartë për tu zhvilluar. Sistemi i transmetimit shtetëror i kushton vëmendje të veçantë arsimit, kulturës dhe informacionit. Kështu, ai promovon dhe prodhon kulturë në të njëjtën kohë. Ai ka përgjegjësinë e veçantë të integritit dhe përfaqësimit të njerëzve me prejardhje imigracioni dhe realitetet e jetëve të tyre.

134. Si rezultat i ndikimit të tyre të veçantë punonjësit e medias dhe

gazetarët kanë një shkallë të lartë përgjegjësie për jetën sociale dhe kulturore si dhe arsimimin politik të qytetarëve. Është pjesë e detyrës të arsimit dhe edukimit në familje, kopshte dhe shkolla që të japin kompetencën bazë të medias si një ndihmë për orientimin. Punonjësit e medias kanë një përgjegjësi veçanërisht ndaj të rinjve. Mbrojtja e rinisë duhet të rritet në mënyrë të vazhdueshme në çdo nivel moshe; standardet e saj duhet të përkufizohen dhe të vendosen në mënyrë më precize dhe çdo shkelje duhet të ndëshkohet rëndë.

## V. RINOVIMI I EKONOMISË SOCIALE TË TREGUT NË NJË BOTË TË GLOBALIZUAR

135. Globalizimi është një fenomen i krijuar nga njeriu që mund ndikojë dhe të formësojë. Globalizimi nuk duhet të konsiderohet si etapa finale e shtetit social dhe ekonomisë sociale të tregut në qoftë se sigurojmë që politikat të janë ekonomikisht të shëndosha dhe të drejta nga ana sociale. Ai do shënonte përkundrazi fillimin e pranimit në mbarë botën. Një politikë e re ekonomike duhet të krijojë me vendosmëri standardet e ekonomisë sociale të tregut në të gjithë botën.

136. CDU e bazon formësimin e saj të globalizimit tek kuptimi ndërkombëtar i kushteve të një rendi botëror human dhe të drejtë. Qëllimi i këtij konceptimi duhet të jetë që të gjitha qeniet njerëzore duhet të arrijnë më tepër liri dhe begati nëpërmjet globalizimit. Ai duhet të sigurojë që liria e fituar t'i shërbejë njerëzimit.

137. Për sa i përket CDU-së, ekonomia sociale e tregut është një model për sukses i cili na bën të mundur që edhe në të ardhmen të jetojmë në liri, begati dhe siguri. CDU është e angazhuar për këtë model ekonomik dhe social i cili u përgjigjet edhe sfidave të botës së globalizuar.

138. CDU është partia e ekonomisë sociale të tregut. Bashkë me Ludwig Erhard, ajo zbatoi ekonominë sociale të tregut kundër të gjithë llojeve të kundërshtimeve gjatë periudhës pas luftës së dytë botërore dhe i solli sukses Republikës Federale të Gjermanisë. CDU e refuzon socializmit dhe format e tjera të kolektivizimit. Kjo vlen edhe për kapitalizmin pa fre, i cili beson plotësisht në mekanizmin e tregut dhe

nuk është në gjendje që të gjejë zgjidhje për çështjet sociale të kohës sonë. Ekonomia sociale e tregut mbetet për ne një model edhe në një Gjermani të ribashkuar dhe në epokën e globalizimit.

## 1. Parimet e Rendit për Prosperitetin, Përfaqësimin dhe Sigurinë

139. Ekonomia sociale e tregut lind nga qenia njerëzore e veçantë si krijimi i zotit, dinjiteti i së cilës është i pacenueshëm. Është një rend në të cilin liria, solidariteti dhe drejtësia kanë një marrëdhënie simbioze – reagojnë ndaj njëri-tjetrit dhe plotësojnë njëri-tjetrin.

140. Ekonomia sociale e tregut është më tepër se sa një sistem ekonomik. Ajo është një model i shoqërisë. Ajo garanton kuadrin brenda së cilit mund të zhvillohet shpirti krijues i individëve. Kështu, ekonomia sociale e tregut është një rend social ekonomik i demokracisë liberale. Sepse ajo ka të njëjtën shtysë si shteti kushtetues: interesi i saj është mbrojtja e dinjitetit njerëzor dhe lirisë kundrejt ndërhyrjes së shtetit dhe arbitraritetit të qenieve të tjera njerëzore. Ajo kontribuon qenësisht në stabilitetin e brendshëm të komunitetit.

141. Ekonomia sociale e tregut e merr forcën e saj nga liria dhe përgjegjësia dhe konkurrenca dhe solidariteti të cilat formojnë një entitet dhe promovojnë njëra tjetrën në mënyrë reciproke. Ajo është lidhja e pazgjidhshme midis rendit ekonomik liberal dhe rendit social nëpërmjet solidaritetit. Ekonomia sociale e tregut është një fenomen i mendësisë sociale. Kjo vjen nga që ajo e bën të mundur për njerëzit që të jetojnë sipas përkufizimit të tyre të pavarësisë dhe t'i gjejnë mjetet e jetesës për vete dhe ata që kanë varësi. Është një mendësi sociale sepse i bën individët të kombinojnë fuqitë e tyre për të bashkëpunuar si komunë. Është orientuar nga ana sociale sepse e bën solidaritetin mbi të cilin bazohen sistemet tona publike të organizuara të sigurisë sociale ekonomikisht të suksesshëm. Ekonomia sociale e tregut garanton begatinë dhe sigurinë për të gjithë. Ekonomia sociale e tregut do të thotë pjesëmarrje edhe për ata që nuk janë në gjendje t'ia dalin vetë. Ja se si ajo e vë në jetë drejtësinë sociale.

142. Ekonomia sociale e tregut bashkon dëshirën për të performuar



dhe solidaritetin. Lehtësitë e bazuara tek solidariteti nuk duhet të gjytmtojnë dëshirën e individit për të performuar. Performanca është një themel i qenësishëm i begatisë. Me këtë themel mund të sigurohet liria sociale.

143. Ekonomia sociale e tregut është një sistem konkurrence. Politika e ekonomisë sociale të tregut është një politikë e rendit. Politika e tregut social hap për industrinë rrugë liberale për të promovuar arritjen dhe krijon një furnizim gjithëpërfshirës të mallrave dhe shërbimeve për qytetarët. Ajo i mundëson çdo njeriu që të silltet në mënyrë të përgjegjshme në treg. Ajo merr si të vërtetë një qeveri të aftë që u siguron qytetarëve të saj kushte konkurruese. Kjo përfshin aksesin e lirë ndaj tregtisë, lirinë e kontratës, mbrojtjen kundër barrierave të tregut, mbrojtjen kundër abuzimit të fuqisë së shoqërive të cilat monopolizojnë tregjet dhe bërjen të mundur që të arrihet transparenca e tregut. Në ekonominë sociale të tregut një kusht për mbrojtjen e pasurisë është se ajo mund të jetë e dobishme për këdo dhe për pasojë i bën thirrje ndjenjës së tyre të përgjegjesisë sociale.

144. Me krijimtarinë e tyre dhe dëshirën për të arritur diçka industrialistët dhe menaxherët e shoqërive shërbejnë si një shtyllë e fortë e ekonomisë sociale të tregut. Për të arritur suksesin për vendin tonë, është e domosdoshme për gratë dhe burrat që të jenë gati të ngrenë sipërmarrje biznesi dhe të marrin risqe. E gjithë shoqëria përfiton nga firmat të cilat punojnë në mënyrë produktive dhe nxjerrin fitime. Të përpiqesh të nxjerrësh fitime shërben si siguri dhe zhvillimi i mëtejshëm për shoqërinë dhe për pasojë edhe si përmbushje e një detyre ndaj shoqërisë. CDU është e angazhuar për sipërmarrjen liberale dhe të përgjegjshme nga ana sociale. Industrialistët dhe menaxherët e shoqërive krijojnë vende pune për të ardhmen dhe kanë një ndikim në imazhin e Gjermanisë në botë nëpërmjet reputacionit të tyre dhe identitetit të tyre kulturor. Për të pasur sukses në aktivitetet e tyre industrialistëve u duhet një dorë e lirë për të vepruar si dhe kuadri i duhur i kushteve dhe insentivave. Në këtë rast, zhvillimi i shoqërisë duhet të ketë një impakt në situatën financiare të industrialistit ose menaxherit të shoqërisë.

145. Kush operon si biznesi, merr përgjegjësi. Kjo vlen për biznesin dhe për marrëdhëniet shoqërore, në lidhje me mjedisin dhe brezat e



ardhshëm dhe drejtpërdrejt midis bashkëpunëtorëve tanë dhe familjeve të tyre. Kjo do të thotë se shoqëritë duhet të promovojnë barazinë e burrit dhe gruas në të gjitha nivelet deri në pozicionet drejtuese si dhe njohjen e parimit të pagës të barabartë për punën e barabartë ose një lloj të mirë. Industrialistët vizionarë e dinë se kjo është në interesin e tyre. Parimi udhëheqës i ekonomisë sociale të tregut është pronari – industrialisti i përgjegjshëm. Përgjegjësia personale për këtë arsye duhet të forcohet edhe në Gjermani për menaxherët e punësuar.

146. Partneriteti social, marrëveshja e lirë kolektive dhe pjesëmarrja në vendimmarrje në formën e përfaqësimit të interesave të punonjësve dhe bashkëvendosja janë parimet themelore të rendit tonë ekonomik dhe social si dhe një shprehje e etikës sociale të kishave kristiane. Kuptimi ynë për dinjitetin e punëtorit kërkon pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje gjë që parashikon kushtet e shërbimit për vendin e tij të punës.

147. Ashtu si punëdhënësit, punonjësit kontribuojnë mjaft nëpërmjet punës së tyre, efikasitetit të tyre dhe dëshirës së tyre për të performuar për suksesin e sipërmarrjeve të tyre të biznesit, të ekonomisë në tërësi dhe në këtë mënyrë në pasurinë dhe zhvillimin e vendit tonë. Në të njëjtën kohë ata japin një kontribut jetësor për sigurinë e tyre dhe atë të të afërmeve të tyre.

Industria ka nevojë për punëtorë të trajnuar mirë, krijues dhe të motivuar në mënyrë që të jetë e suksesshme. Punonjësit kanë nevojë për shansin që të marrin pjesë në vendimmarrje, për përgjegjësi dhe një atmosferë liberale për të zhvilluar aftësitë e tyre gjerësisht dhe me sukses. Arsimi dhe trajnimi i mëtejshëm garanton aftësinë e tyre për të punuar dhe kapacitetin e tyre performues. Veç kësaj, punonjësit kanë nevojë për mbështetje themelore nga ligjet sociale dhe të punës për planifikimin e jetës së tyre. Ata meritojnë pjesëmarrjen e duhur në begatinë e shoqërisë.

148. Zhvillimi i mëtejshëm i një firme dhe siguria e punësimit në Gjermani mund të bëjë të domosdoshme shkëmbimin e vendeve të punës në vende të huaja. Megjithatë, ne presim që shoqëritë të marrin vendime të tilla të gjykuara mirë, duke i njohur efektet sociale që ata mund të kenë në shoqëri dhe të veprojnë në favor të Gjermanisë.



## 2. Ekonomia e Tregut Social në një Botë të Globalizuar

149. Ekonominë sociale të tregut mund ta ruajmë vetëm nëpërmjet lirisë dhe konkurrencës më të madhe dhe jo nëpërmjet barrierave dhe rregullimeve të tepërta. Ashtu sikurse jemi më të shtrenjtë me krahasimet ndërkombëtare, po kështu duhet të jemi më të mirët. Në një botë dinamike na duhet një Gjermani kureshtare, novatore dhe krijuese. Në ditët e sotme më tepër se kurrë sukcesi ekonomik varet nga teknologjia, talentet dhe toleranca. Vetëm një shoqëri e hapur dhe të shumëllojshme krijon mjedisin krijues në të cilin mund të parashtrohen idetë dhe garantohet begatia nëpërmjet novacionit.

150. Në hartimin e strategjive të saj të globalizimit, CDU si parti e popullit merr parasysh dhe me theks të njëjtë interesat e industrialistëve dhe punonjësve, dhënësve të shërbimeve dhe përfituesve të shërbimeve, zonat urbane si dhe zonat rurale. Në përputhje me parimet tona kristiane, do të dëshironim të krijonim perspektiva më të mira për ata njerëz që jetojnë në zonat më pak të zhvilluara të botës, edhe në qoftë se kjo do të thoshte konkurrencë më e madhe ekonomike për ne në Gjermani. Synimi ynë është që të arrijmë shanse të barabarta, qoftë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar. Ne duam të përdorim ndikimin tonë në botë. Ne e konsiderojmë ndërlihdjen tregtare ndërkombëtare si një forcë shtytëse në luftën kundër varfërisë, urisë, sëmundjeve epidemike, analfabetizmit, korrupsionit, abuzimit me të drejtat e njeriut, diskriminimi dhe konfliktet e armatosura.

151. Komuniteti ekonomik dhe i vlerave të Bashkimit Europian është një model i suksesshëm i cili demonstroi se është e mundur që të arrihet një sistem i tregjeve të hapur dhe të konkurrencës ndërsa ruhen përsëri identitetet specifike kombëtare dhe standardet ligjore, sociale dhe ekologjike në përfitim të të gjithëve. Në të njëjtën kohë, Europa është një aktor i fortë në implementimin e një kuadri të drejtë të rendit për një ekonomi të globalizuar. Ne duam ta forcojmë BE-në për përmbushjen e kësaj përgjegjësie të rëndësishme të së ardhmes.

152. Ne jemi të angazhuar që të përmirësojmë efektivitetin,

forcën, transparencën dhe efikasitetin e organizatave ekzistuese ndërkombëtare. Ato janë mjetet e përshtatshme për avancimin e formimit të një rendi botëror të lirë dhe human. Shtetet e forta ekonomikisht duhet të marrin përsipër përgjegjësinë e tyre për të ndihmuar shtetet ekonomikisht të dobëta për të fituar njohje. CDU do që të përdorë institucionet ekzistuese në komunitetin ndërkombëtar që të promovojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe standardet e domosdoshme ekologjike dhe minimale sociale. Puna e fëmijëve dhe shfrytëzimi i punëtorëve nuk duhet të tolerohet.

153. CDU gjithmonë ka përkrahur një politikë që beson në krijimin e tregjeve të lira dhe konkurrencës së ndershme. Tregtia e lirë shumëpalëshe është një parakusht jetësor për rritjen ekonomike globale dhe drejtësinë. Hapja e tregjeve për tregti dhe kapital si dhe konkurrencë ndërkombëtare duhet të ndodhë në kushte të ndershme. Sot, këto kushte të krahasueshme dhe të drejta për konkurrencë nuk mund të konstatohen akoma. Kjo është arsyeja përse ne do të angazhohemi për tu kujdesur që të implementohen standardet ndërkombëtare.

154. Vetëm mekanizmi i tregut nuk është gjithmonë në gjendje që të parandalojë formimin e monopoleve dhe karteleve. Për të parandaluar ndonjë ushtrim të pakufizuar të fuqive nga aktorët ndërkombëtarë të sektorit privat dhe publik, është e domosdoshme që të mbrohet liria e tregjeve ndërkombëtare. Kjo kërkon rregulla konkurrence të koordinuara në mënyrë ndërkombëtare.

155. Ka një rivalitet në rritje midis bindjeve të politikës ekonomike dhe aktiviteteve të shteteve të cilët përpiqen të zbatojnë qëllimet ekonomike strategjike kombëtare duke ndërhyrë aktivisht. Ne duam gjithashtu t'i bindim këto shtete për drejtësinë e konkurrencës të lirë dhe të ndershme dhe të forcohet kuadri i rendit ndërkombëtar. Megjithatë, për sa kohë që termat e shtrembëruara të konkurrencës ekzistojnë akoma dhe kërcënohen interesat tona kombëtare në fushat me rëndësi të madhe dhe strategjike, mund të jetë legjitime që të zbatohen këto interesa nëpërmjet ndërhyrjes së qeverisë. Pavarësisht kësaj, liria e tregut ende mbizotëron.

156. Të drejtat e pasurisë intelektuale të propozuara qartë janë baza



për përfshirjen tonë afatgjatë në kërkim dhe zhvillim dhe për këtë arsye një parakusht i rëndësishëm për suksesin tonë ekonomik. Si do që të jetë, e drejta e pronësisë e patentave dhe ideve nuk respektohet në disa instanca në mbarë botën. Gjermania është veçanërisht një vend për inovacion e vendos atë në pozicionin qendror në organizimin e tregtisë botërore për të marrë, për të vendosur, për të zbatuar dhe konsoliduar rregullat detyruese dhe të pranuar për mbrojtjen e pasurisë intelektuale.

157. Firmat që operojnë globalisht mund ta shmingin legjislacionin kombëtar. Krijimi i tregjeve në përputhje me një rend politik të caktuar nuk mund të jetë kurrë i përsosur dhe rregullimi i tepërt mund të çojë në kufizime ekonomike. Kështu, më tepër ne mbështetemi tek shoqëritë që janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë e tyre. Detyrat vullnetare si “Global Compact” e Kombeve të Bashkuara apo udhëzimet e OECD për firmat ndërkombëtare, duhet të mbështeten për këtë arsye.

158. Tregu financiar global kontribuon në rritjen e begatisë në botë dhe u mundëson që të përfitojnë rritje ekonomike nëpërmjet investimit shumë vendeve në pragun e zhvillimit. Tregjet e hapura dhe konkurrentët e lirë sigurojnë tërheqje dhe likuiditet të tregut gjerman të kapitalit. Fondet që pluskojnë në kërkim të mundësive të investimit, të tilla si fondi privat i aksioneve, mund të kontribuojë edhe në Gjermani për t’i bërë sipërmarrjet e biznesit më konkurruese. Pavarësisht kësaj, fondet e grupeve të veçanta private të investimit aktualisht janë rritur shumë herë mbi kapacitetin e tregut të shoqërive dhe bankave kryesore. Për këtë arsye, duam t’i përdorim organizatat ekzistuese ndërkombëtare për të gjetur një kuadër rendi dhe transparence në fushat e tregtisë dhe të tregjeve financiare.

159. Në sajë të çmimeve të favorshme dhe shumanësisë së produkteve që rrjedhin nga konkurrenca ndërkombëtare, konsumatorët nga janë njëra anë përfituesit dhe nga ana tjetër bashkëformuesit e procesit të globalizimit. Nëpërmjet vendimeve të tyre për të blerë dhe investuar ata investojnë edhe në suksesin që produktet e veçanta dhe prodhuesit e tyre arrijnë në treg. Shumë mallra të huaja të shitura në tregun gjerman nuk prodhohen sipas kushteve të njëjta sociale, ligjore dhe ekologjike si mallrat e prodhuara në Gjermani. Ne duam t’i përmirësojmë parimet e vendimmarrjes të konsumatorëve të cilët

janë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tyre dhe për pasojë, të promovojmë transparencën nëpërmjet futjes së vulave të vlefshme dhe të besueshme ndërkombëtarisht në mallrat e konsumatorit.

### 3. Biznesi dhe Punësimi

160. Në pak dekadat e fundit shumë njerëz kanë humbur interesin tek ekonomia sociale e tregut. Përshtypja e krijuar është se ajo nuk është në gjendje të zgjidhë problemet qendrore ekonomike dhe sociale, veçanërisht papunësinë e lartë. Megjithatë, nuk është ekonomia sociale e tregut që pengon zgjidhjen e këtyre problemeve, por më tepër abuzimi konstant me parimet e tyre themelore. Globalizimi vërtet tregon qartë gabimet e tyre.

161. Ne duhet t'i përsëritim intensivisht parimet bazë të rendit të ekonomisë sociale të tregut dhe t'i vëmë ato në perspektivën e tyre të drejtë në mënyrë që të arrihen qëllimet e punësimit të plotë, të rritjes graduale dhe të përshtatshme ekonomike, buxhete solide dhe sisteme të qëndrueshëm të sigurisë sociale. Kjo përfshin edhe ruajtjen e krijimit dhe përdorimin e matur të burimeve natyrore. Vetëm atëherë ne do të jemi edhe në të ardhmen toka e lirisë dhe drejtësisë, e progresit dhe sigurisë, e të qenit bashkë dhe do ta mbajmë njëri-tjetrin. Parimi i solidaritetit duhet të jetë udhërrëfyes. Me rëndësi të madhe duhet të jenë: sa më pak ndërhyrje shtetërore që të jetë e mundur dhe sa më shumë mbështetje shtetërore që të jetë e nevojshme. Gjermania ka nevojë për reforma themelore në mënyrë që të jetë e sigurt, të rritë begatinë tonë dhe të arrijë drejtësinë. Këtu, drejtësia sociale renditet në krye të shanseve të qytetarëve për të mbijetuar.

162. Nëpërmjet këtyre reformave, ekonomia sociale e tregut do tu mundësojë qytetarëve që të vendosin më mirë në mënyrë të përgjegjshme për kushtet e tyre të jetesës në vend që të jenë gjithnjë në fundin marrës. Pjesëmarrja sociale dhe pjesëmarrja politike janë të ndërvarura. Vetëm nëpërmjet veprimit të përbashkët e fiton ekonomia sociale e tregut dhe demokracia besimin e qytetarëve.

#### ***Më Tepër Konkurrencë, më Tepër Liri dhe më Tepër Pjesëmarrje***

163. Konkurrenca e një vendndodhje ekonomike lulëzon me dinamikën



e ndërmarrjeve të saj të biznesit. Kjo është arsyeja përse ekonomia gjermane bazohet në traditën shumëshekullore të zejeve, ndërmarrjeve të mesme të biznesit, tregtinë, profesionet e lira, industria, një sistem i zhvilluar mirë i punëtorëve të kualifikuar si dhe furnizimin e mallrave afër shtëpive, nga njëra anë dhe shoqërive globalisht konkurruese dhe ndërkombëtarisht të suksesshme nga ana tjetër. Shqetësimet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të biznesit, firmave të dhënies së shërbimit dhe shoqërive artizanale si dhe bizneseve të lira janë shtylla kurrizore e ekonomisë gjermane. Ato garantojnë përqindjen më të lartë të shanseve të trajnimit dhe vendeve të punës. Për këtë arsye detyra e shtetit është që të mbështetë në mënyrë të veçantë ata që garantojnë jetesën e qytetarëve dhe për sektorin e vogël dhe të mesëm të biznesit duke ju ofruar atyre kushtet kuadër optimale. Më tepër treg do të thotë më tepër shanse për njerëzit që t'ia dalin vetë. Ne duam ta ulim kontributin e shtetit, të pakësojmë burokracinë dhe ta bëjmë ligjin e punës transparent dhe fleksibël. Ne duam gjithashtu që ta bëjmë ligjin e tatimeve konkurrues dhe të përmirësojmë kushtet për financimin e ndërmarrjeve të biznesit.

164. Synimi ynë është që të krijojmë besimin si një parakusht për më shumë investime në Gjermani. Ne synojmë të forcojmë Gjermaninë si një vend tërheqës për qendrat e biznesit si dhe si një qendër për investimet për kapitalistët me risk ndërkombëtar dhe të arrijmë një përqindje të lartë të krijimit të vlerës në vendin tonë. Kthimi i Gjermanisë në një qendër financiare do t'i sjellë asaj më tepër rritje dhe punësim.

165. Ne duhet ta bëjmë të mundur arritjen e lirisë dhe konkurrencës më të madhe. Kjo do të thotë në veçanti hapjen dhe ruajtjen e më tepër tregjeve, ndalimin e konkurrencës të padëshiruar dhe kundërveprimin ndaj përqendrimit të fuqisë ekonomike që mund të rrezikojë konkurrencën. Ne duam të kufizojmë dhe eventualisht të heqim subvencionet shtetërore dhe më tej të privatizojmë ndërmarrjet shtetërore të biznesit. Nivelin e qeverisjes vendore, gjithashtu, shteti duhet të ndërhyjë vetëm në qoftë se një performancë nga një firmë private nuk është aq e mirë sa ose madje më e mirë se e një firme pronë shtetërore.

166. Shumë detyra të politikës së konkurrencës janë përqendruar në

tregun e brendshëm në Europë. Kundër sfondit të sfidave më të forta të tregut të brendshëm dhe globalizimit, ne duam të sigurohemi që të modernizohet kontrolli i konkurrencës së BE-së dhe të zhvillohet më tej, duke konsideruar siç duhet autoritetet kombëtare të konkurrencës dhe rendin e konkurrencës.

167. Konkurrenca është një parakusht i qenësishëm për një mbrojtje të fortë të konsumatorëve. Sepse çdo monopol që pengon konkurrencën, redukton shumëllojshmërinë dhe lirinë e zgjedhjes së konsumatorëve. Të drejtat e konsumatorit janë të drejta civile. Mbrojtja e konsumatorit është një detyrë politike gjithëpërfshirëse. Ajo është pjesë e një politike gjithëpërfshirëse për konsumatorin e cila kërkon një drejtpeshim midis interesave të konsumatorit dhe biznesit në një përpjekje për të ruajtur një shkallë të lartë të cilësisë së jetës. Është e rëndësishme që të arrihet një mbrojtje optimale e konsumatorit nëpërmjet një drejtpeshimi midis vetëvendosjes dhe mbrojtjes shtetërore. Informacioni i besueshëm, gjithëpërfshirës dhe objektiv për produktet dhe cilësinë e tyre u mundësojnë konsumatorëve që të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme. Udhëzimi ynë është ai i konsumatorit të pjekur, të pavarur dhe të mirinformuar. Mbrojtja e konsumatorit nuk është detyrë vetëm e shtetit, por edhe e prodhuesve, përpunuesve, furnizuesve dhe konsumatorëve. Ne nuk duam ndonjë manipulim shtetëror të konsumatorit.

168. Një vend tërheqës ekonomik kërkon një infrastrukturë që funksionon mirë. Në lidhje me Gjermaninë veçanërisht, si një vend transit në zemër të Europës, integrimi ekonomik i Europës do të thotë një rritje e lartë në densitetin e trafikut. Përdorimi më i mirë, zgjerimi më i mirë me objektiv dhe formësimi inteligjent i infrastrukturës së transportit në të gjitha fushat janë gjithashtu mjaft të rëndësishme për një rritje më të madhe. Kjo vlen edhe për mundësitë e zhvillimit të zonave të mbipopulluara dhe zonave rurale. Ka nevojë për një zhvillim të mëtejshëm të infrastrukturës në vendet e reja edhe ato të vjetra. Vetëm shteti nuk do të jetë në gjendje të plotësojë kërkesën e lartë për investim që do të vijë si rezultat i këtij ushtrimi. Kjo është arsyeja përse iniciativat e suksesshme nga institucionet private financuese të infrastrukturës së transportit duhet të shfrytëzohen në mënyrë më intensive se kurrë. Veç kësaj, një furnizim i sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe ekonomik i energjisë është nevojë bazë e një vendi cilësor.



169. Gjermania varet nga efikasiteti dhe shtysa novatore e qytetarëve të saj dhe e ekonomisë së saj. Ne duam të hapim më tepër tregje në të ardhmen. Inovacionet, produktet dhe shërbimet e reja që lindin nga Gjermani vërtetë do të kenë një shans në tregun botëror në qoftë se ato mund të përdoren edhe në Gjermani. Toka e shpikjeve dhe patentave duhet përsëri të jetë toka e implementimit të ideve. Gjermania duhet të prodhojë trurin më të lartë të kokave të qarta dhe vizionarë punëtorë, t'i kërkojë këto koka në të gjithë botën, dhe tu ofrojë atyre kushte tërheqës kuadër. Ka një kërkesë urgjente për profesionet në fuqinë punëtore, shërbimet dhe biznesin.

### ***Punë për të Gjithë***

170. Punësimi për të gjithë është parimi themelor i drejtësisë sociale. Punësimi pranon vetë realizimin, fut entuziazmin në jetë edhe është shtysa vendimtare për pjesëmarrjen në veprimtaritë shoqërore. Secili nevojitet; askush nuk duhet të lihet jashtë. Puna sjell të ardhura dhe krijon pasuri. Ekonomia sociale e tregut kërkon punësim të plotë. Kjo është detyra e shtetit dhe e partnerëve tariforë. Papunësia masive është e padurueshme, e papranueshme dhe e dëmshme për ekonominë. Një mungesë perspektive në zhvillim mund të ndikojë familje të tëra dhe të pengojë shanset e mbijetesës së shumë brezave të ardhshëm.

171. Papunësia në Gjermani është kryesisht një çështje strukturore. Ne, për këtë arsye, na nevojitet jo vetëm një rritje më e qëndrueshme, por edhe investime me objektiv në arsim dhe një reformë gjithëpërfshirëse e tregut të punës. Ne duam shanse më të mira punësimi për të moshuarit, të pakualifikuarit dhe të papunët e përhershëm. Janë veçanërisht këta njerëz që ndihen të përjashtuar nga liria dhe pjesëmarrja.

172. Në lidhje me tregun e punës, ne përkrahim një drejtpeshim të drejtë midis mbrojtjes legjitime të nevojave të punonjësve, shanseve të punësimi dhe për njerëzit e papunë dhe interesave të ndërmarrjeve të biznesit. Rregullat e mbrojtjes së punës në tregun e punës ose në ligjin e punës duhet të formulohen në mënyrë të tillë që të mos favorizojnë papunësinë. Duke e bërë fleksible mbrojtjen e punonjësve kundër largimeve të paligjshme nga puna, gjë që përmirëson perspektivat e punësimi të të papunëve, është, në këtë rast, një ligj i drejtësisë. Në këtë mënyrë, detyra e arritjes së drejtpeshimit të drejtë midis interesave duhet të merret së bashku me partnerët tariforë.



173. Autonomia kolektive e negociuar është një garanci për stabilitetin e Gjermanisë si një vend ekonomik. Ajo është një pjesë integrale e rendit kuadër të ekonomisë sociale të tregut. Palët e marrëveshjes së sindikatave (sindikatat dhe punëdhënësit) kanë filluar tashmë të gjejnë përgjigje fleksible për peizazhin ndryshues të punës së shekullit 21. Marrëveshjet e ngurta të degëve të sindikatave, të cilat i trajtojnë bizneset në të njëjtën mënyrë, nuk janë përgjigje e përshtatshme. Sindikatat dhe shoqatat e punëdhënësve janë të lutura të lëshojnë më tej pjesë të përgjegjësisë së tyre në biznese. Në këtë mënyrë, marrëveshjet kuadër të sindikatave që janë bërë nga qendra mund të plotësohen në një mënyrë të decentralizuar në përputhje me nevojat specifike. Ne duam ta plotësojmë këtë proces duke krijuar një kuadër më të garantuar ligjërisht për aleancat e sipërmarrjeve të biznesit. Ne do të vazhdojmë të rritim bashkëvendosjen dhe përfaqësimin e interesave të punonjësve në një mënyrë që do të jetë largpamëse, me marrëdhënie të ngushta me bizneset dhe miqësore ndaj punëtorit. Ky orientim i politikës duhet të marrë në konsideratë gjithashtu ndërvarësinë ndërkombëtare të sipërmarrjeve.

174. CDU do të rritë më tej mundësitë e punonjësit të veçantë për të marrë pjesë më tepër se kurrë më parë në suksesin dhe kapitalin e shoqërive të tyre brenda kuadrit të partneritetit social. Kjo krijon për punëtorin burime shtesë të të ardhurave, mjete shtesë për të ndihmuar të moshuarit dhe më tepër drejtësi dhe rrit identifikimin e punëtorit me shoqërinë e tij. Instrumentet korresponduese duke përfshirë mbrojtjen kundër paaftësisë paguese duhet të lidhen me sipërmarrjen e biznesit sa më shumë që të jetë e mundur dhe të pranohen kushtet e veçanta në të cilat operon çdo shoqëri. Veç kësaj, pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë ngre bazën e kapitalit të shoqërive.

175. Begatia sociale vjen nëpërmjet punës. Më tepër rritje, më tepër punë, janë të ndërvarura. Duke përdorur modelet e orëve fleksible të punës, p.sh., kontabiliteti vjetor i orëve të punës, puna mund të organizohet në një mënyrë më fleksible dhe produktive. CDU inkurajon organin tri-palësh në këtë drejtim që të eksplorojë mundësinë e ruajtjes nga paaftësia paguese prej llogarive të orëve të punës.

176. Kufizimi detyrues i njerëzve që kanë arritur moshën e tyre të ligjshme të pensionit apo limitin e parashikuar me ligj të moshës të



biznesit nga shërbimi aktiv shpesh me të drejtë konsiderohet nga të interesuarit jo dinjitoze. Kufijtë e moshës kanë kuptim kur ata përdoren për të llogaritur pretendimet e pensionit. Ai që, gjithsesi, dëshiron të shkojë përtej atij kufiri në parim nuk duhet të ndalohet që ta bëjë këtë. Reciprociteti midis botës së punës dhe komunitetit të punës duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që të zotërojë sa më shumë që të jetë e mundur ndryshimet demografike që po ndodhin.

177. Të gjithë qytetarët duhet të jenë në gjendje që të përfitojnë të ardhura të mjaftueshme që tu garantojnë jetesën. Politika jonë e punës parashikon si më poshtë: 'Arritja duhet të shpërblehet'.

Kjo është në përputhje me parimin e drejtësisë për performancën d.m.th., ai që punon duhet të ketë më shumë se sa ai që nuk punon. Ne duam kushte kuadër të cilat do ta bëjnë punësimin ligjor dhe pagat më tërheqëse edhe për njerëzit më pak të kualifikuar, me punë të thjeshta dhe paga korresponduese miqësore ndaj punësimit. Kjo duhet të motivojë edhe punëkërkuessit që të kapin shanset e vendeve të punës dhe të inkurajojë gjithashtu punëdhënësit që të krijojnë vende të reja pune. Ne duam të promovojmë punësimin, jo papunësinë.

178. Ne nuk duam ndonjë konkurrencë për pagat më të ulëta. Huatë imorale, të cilat qartësisht e tejkalojnë pagat e zakonshme të degëve vendore, për këtë arsye, duhet të ndalohen.

179. Kostot shtesë të pagave kontribuojnë në papunësinë dhe punën e paligjshme. Ne duam të reduktojmë gradualisht kostot shtesë të pagës dhe të shkëputim shpenzimet e sigurimit social nga kostoja e punës dhe në këtë mënyrë të parandalojmë rivendosjen e vendeve të punës në vende të huaja ose kthimin e tyre në vende të paligjshme pune.

## 4. Formësimi i Ndryshimit Demografik – Siguria Sociale për të gjithë Brezat

180. Solidariteti dhe siguria sociale nuk vijnë në radhë të parë nga shteti. Qenia njerëzore është nga natyra një qenie sociale, së cilës i pëlqen t'i përkasë një komuniteti dhe është e aftë dhe e angazhuar për solidaritet. Ka shumë vende në institucione duke filluar nga familja deri tek lagjja, aktivitetet honorifike, klubet, iniciativat qytetare, ku

solidariteti jetohet çdo ditë. Nëse dëshirojmë të përmbahemi parimeve të sigurisë sociale, atëherë solidariteti duhet të vazhdojë të lindë nga qendra e shoqërisë, ose përndryshe ai do të zhduket plotësisht një ditë. Martesa, familja, fëmijët, shkolla dhe trajnimi profesional janë më të rëndësishme për shanset e qenies njerëzore në jetë dhe për mirëqenien sociale të ardhshme të personit se sa shumë gjëra të tjera.

Punonjësit socialë japin shërbime të qenësishme për shoqërinë mbi bazën e ligjshme konstitucionale të solidaritetit.

181. CDU është e angazhuar për një politikë sociale e cila përmirëson shanset e njerëzve në jetë dhe bashkekzistencën e tyre në shoqëri. Ne hedhim poshtë çdo koncept të sigurisë dhe solidaritetit që bazohet vetëm në mbështetjen financiare. Vetëm kombinimi i përgjegjësisë personale, asistencës shtetërore dhe përfshirjes civile mund të krijojë sigurinë për të cilën kanë nevojë qeniet njerëzore.

182. Shteti social ka rritur shumë deri tani. Ai mbetet i domosdoshëm. CDU ka luajtur një rol jetësor në formësimin e sistemeve të sigurisë sociale. Nëpërmjet mbrojtjes të bazuar tek solidariteti kundër risqeve të këtyre sistemeve u jepet njerëzve siguri. Ata kanë sjellë begati, liri sociale dhe pjesëmarrje të një game të gjerë. Megjithatë, ata mund të përmbushin detyrën e tyre në të ardhmen në qoftë se ata zhvillohen dhe ndryshohen më tej. Synimi ynë është të kemi një shtet social efektiv i cili e motivon fort individin dhe bën të mundur për të që të marrë iniciativën e tij dhe të marrë përsipër përgjegjësi personale brenda kuadrit të aftësive të tij.

183. Në formësimin e sistemeve të sigurisë sociale ne ndjekim tre parime bazë: 1. Ata duhet të forcojnë parimin e përgjegjësisë personale. 2. Ata duhet të jenë në përputhje me parimin e drejtësisë në të gjithë brezat. 3. Ata nuk duhet të shkelin parimin e barazisë së performancës. Varësia e tyre nga punësimi që sjell fitim duhet të reduktohet. Kjo është arsyeja përse siguria sociale dhe punësimi që sjell fitim duhet të ndahen dhe mbështetja financiare të zgjerohet. Sistemet tona të sigurisë sociale duhet të plotësojnë llojet e ndryshme të nevojave, fazat e ndryshme të jetës dhe kushtet e ndryshme të jetesës. Në këtë frymë, risqet bazë duhet të shmangen për të gjithë. Duhet të rritet gatishmëria dhe aftësia e individit për t'ia dalë vetë. Në të gjithë sistemet e sigurisë



konkurrenca, transparenca, efikasiteti, ndërgjegjshmëria për kostot dhe përgjegjësinë dhe parimi i subsidiaritetit duhet të çohen përpara. Ne duam të luftojmë me të gjithë fuqinë tonë abuzimin e shpenzimeve sociale dhe punën e paligjshme. Sepse ato minojnë solidaritetin.

### ***Sigurimi Shëndetësor***

184. CDU do që secili në Gjermani, pavarësisht nga të ardhurat, mosha, risku i shëndetit, të marrë tani dhe në të ardhmen kujdes të mirë shëndetësor sa më pranë pragut të derës që të jetë e mundur dhe të marrë pjesë në përfitimet e avancimit mjekësor. Zgjedhja e lirë e mjekut dhe karrierave të lira shëndetësore janë pjesë e sistemit të dhënies së kujdesit liberal të shëndetit.

185. Duke pasur parasysh ndryshimin demografik dhe progresin e bërë në mjekësi dhe teknologjinë mjekësore, struktura, organizimi dhe financimi i sigurimit të detyrueshëm dhe privat shëndetësor do të rritet më tej në të ardhmen. Përgjegjësia personale, masat paraprake dhe parandalimi duhet të forcohen më tej. Efikasiteti dhe potenciali ekonomik gjithashtu duhet të shfrytëzohen dhe aftësia e individit për të zgjedhur dhe për të marrë vendimet e tij duhet të hapet më tej.

186. Është përgjegjësia dhe interesi i çdo individit që të parandalojë sëmundjen nëpërmjet mënyrës së tij të jetesës dhe ruajë një shëndet të mirë. Parandalimi, për këtë arsye, duhet të bëhet një shtyllë individuale krahas trajtimit akut, rehabilitimit dhe kujdesit. Një hap i spikatur drejt forcimit të përgjegjësisë personale, parandalimit dhe promovimit të shëndetit të mirë është zhvillimi i modeleve me bonus, kontributet vullnetare dhe të tepërta.

187. Në mënyrë që të ruhet cilësia, siguria e kujdesit dhe aftësia financuese e sistemit tonë liberal të sistemit të kujdesit shëndetësor të vetë-administruar, ne dëshirojmë ta bëjmë konkurueshmërinë tonë të cilësisë më transparente.

188. Ne do të plotësojmë në etapa financimin e sigurimit shëndetësor të detyruar që lidhet me të ardhurat e fituara me elementë primi solidar. Këto elemente do të zëvendësohen sa më shpejt që të jetë e mundur nga një model primi sigurimi bazuar në kapitalin e përbashkët. Njerëzit

me të ardhura më të pakta do të marrin kompensim. Meqenëse fëmijët përbëjnë një nga parakushtet më të rëndësishme për vazhdimësinë e sistemit të solidaritetit, i gjithë komuniteti do të përgjigjet për sigurimin. Kompensimi social dhe sigurimet e fëmijëve do të financohen me fondet buxhetore. Nëpërmjet kësaj shpërndarjeje graduale të kostove të kujdesit shëndetësor nga kostot e punës financimi i sistemit të sigurimeve do të bëhet i qëndrueshëm.

### ***Sigurimet për Moshën e Vjetër***

189. Sigurimi për të moshuarit në Gjermani qëndron mbi tre shtylla: skemat e kontratës së pagesave vjetore të detyrueshme, skemat e shoqërive të sigurimeve dhe skemat e sigurimit privat.

190. Fondi i pensioneve të sigurimeve sociale të detyruara paguar nëpërmjet kontributeve që mbulojnë koston (burimi i pensionit financiar nga pagesa siç fitohet) për momentin është forma më e rëndësishme e sigurimit të të moshuarve. Ajo bazohet në sistemin e pajtimit të brezit. Si rezultat i ndryshimeve në piramidën e moshës së popullatës dhe rënia afatgjatë e punëtorëve që paguajnë sigurime shoqërore gjithnjë e më pak, punëtorët përballen me një numër gjithnjë e më të lartë pensionistësh. Marrëveshja e brezit për këtë arsye duhet të vendoset mbi një bazë të re të qëndrueshme e cila u ofron të rinjve një plan më të sigurt jete dhe të moshuarve një sasi më të madhe varësie.

191. Brezat punues fitojnë nëpërmjet kontributeve të tyre një përqindje të madhe të të ardhurave të brezit që nuk është më i punësuar dhe për pasojë ruan ekzistencën e vazhduar të komunitetit të solidaritetit nëpërmjet fëmijëve të tyre. Kjo është edhe arsyeja përse mbrojmë një shoqëri miqësore ndaj familjes e cila njih shtrëngimet e shumëfishta për prindit (dhe mësuesit) dhe i shpërblen ata.

192. Në të ardhmen, fondi i pensioneve të sigurimeve sociale të detyruara duhet gjithashtu të ketë një lidhje të dallueshme me kontributin dhe nuk duhet ta kalojë një nivel të caktuar të sigurimit pa u bërë një mbingarkesë për kontribuuesin. Fondi i pensioneve të sigurimeve sociale të detyruara do të kalonte një risk identifikimi në goftë se do të kryente vetëm shërbime që mund të përfitoheshin pa



pagesë nga skema të tjera të sigurimeve. Pasoja do të ishte një sigurim minimal, si sigurimi bazë, për këdo.

193. Pensioni i detyrueshëm është më tepër se sa një instrument për parandalimin e varfërisë në moshën e vjetër. Ai i garanton secilit një sasi lirie dhe shpërblen arritjen e cila arrihet nëpërmjet pagesës së detyrimeve, rritjen e fëmijëve ose kujdesin për të afërmit. Ai gjithashtu krijon garancinë e domosdoshme për të mbijetuarit dhe njerëzit që nuk mund të punojnë më për shkak të sëmundjes.

194. Në të ardhmen pensioni i detyrueshëm nuk do të jetë më në gjendje që të ruajë standardet e zakonshme të jetesës në moshën e vjetër. Për këtë arsye janë të domosdoshme forma të tjera të pensionit, të tilla si skemat private dhe të shoqërive të pensioneve të kontribuojnë për të siguruar standarde të denja jetese në moshën e vjetër. Këto skema duhet të mbështeten në mënyrë efikase dhe të qëllimshme.

195. Skema e pensionit për moshat e vjetra të shoqërive po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Në këto ditë pritet më tepër mobilitet dhe fleksibilitet nga punëmarrësi. Veç kësaj, duhen marrë parasysh edhe kushtet kuadër të pensionit të moshës së vjetër. Ne mbështetim edhe llogaritë personale të utilitetit të moshës së vjetër jashtë shoqërive, në të cilat punëdhënësit dhe punëmarrësit mund të paguajnë dhe të administrojnë si pretendime në një afat të shkurtër (afate pe skadim). Pretendimi për këtë pension shoqërie duhet të jetë tashmë i garantuar pas një periudhe të shkurtër kohore.

### ***Sigurimi Kujdesit***

196. Sigurimi i kujdesit që është futur nga sindikata ka provuar se është efektiv. Në të ardhmen, ai duhet të paguajë kontribute të besueshme për të shmangur ndonjë risk të kujdesit dhe të kryejë kujdesin e cilësisë së lartë dhe vëmendjen. Është i domosdoshëm një angazhim gjithëpërfshirës për parandalimin e risqeve në të ardhmen. Si do që të jetë, kjo nuk e çliron individin nga kryerja e përgjegjësisë së tij personale dhe iniciativa e parandalimit të risqeve të kujdesit dhe hartimin e procesit të kujdesit.

197. Për të mundësuar financime të sigurimit të kujdesit social, duhet

të plotësohet gradualisht financimi i qëndrueshëm i detyrueshëm i sigurimit të detyruar shëndetësor që lidhet me të ardhurave të fituara me elementë të primit solidar dhe të zëvendësohet sa më shpejt që të jetë e mundur në përputhje me parimin e drejtësisë për të gjithë brezat nga një model i primit të sigurimit të bazuar tek kapitali i përbashkët.

198. Parandalimi dhe rehabilitimi duhet t'i paraprijnë masave të kujdesit. "Trajtimi i pacientëve të jashtëm është më i mirë se sa trajtimi i pacientëve të brendshëm" është ylli ynë drejtues. Duhet të zhvillohen dhe të forcohen format e reja të strehimit dhe kujdesit. Me anë të buxheteve të kujdesit që mund të implementohen me lehtësi nga qytetarët që kanë nevojë për kujdesin vetë si pacient i jashtëm, gjysmë pacient i jashtëm apo pacientë të brendshëm dhe nëpërmjet kohës të shpenzuar për kujdesin, ne duam të forcojmë sistemin e kujdesit shtëpiak dhe të çmojmë angazhimin e personelit infermier në një mënyrë më të mirë.

199. Ndryshimet në strukturën dhe financimin e sigurimit të kujdesit infermier japin shanse për t'i bërë më dinamik përfitimet e kujdesit infermier dhe nevojën për ri-përcaktimin e kujdesit infermierë, veçanërisht për hir të njerëzve me aftësi të kufizuara si dementia. Qëllimi ynë është të sigurojmë një nivel realisht konstant të përfitimeve të kujdesit infermier dhe të parandalojmë nevojën në rritje për pagesë shtesë të shpenzimit të atyre që kanë nevojë për kujdesin infermier, të afërmeve të tyre dhe përfituesve të ndihmës sociale.

### ***Sigurimi i Papunësisë***

200. Në të ardhmen, edhe sigurimi i papunësisë do të garantojë, në rast papunësie, sigurim të kufizuar përkohësisht të një përqindjeje të madhe të të ardhurave të marra gjatë punësimit të mëparshëm. Nëpërmjet ofrimit të punës, marrjes dhe rifillimit të punës, sigurimi i papunësisë përmbush funksione të tjera të rëndësishme sociale, shëndetësore dhe ekonomike.

201. Sigurimi i papunësisë mbetet një sigurim i bashkuar i cili i jep kujtdo siguri për përqindje të barabartë të nivelit të tyre të të ardhurave gjatë një periudhe të përshtatshme kohore dhe redukton së bashku riskun individual. Periudha për tërheqjen e parave të papunësisë duhet të



lidhet me periudhën e pagimit të kontributit. Për sa i përket CDU-së, sigurimi i papunësisë ka një rëndësi të madhe nga pikëpamja e nevojës për një treg pune më fleksibël.

202. Sigurimi i papunësisë bën të mundur për të papunët që të mos pranojnë vendin e parë të punës që u ofrohet, por në vend të kësaj të gjejnë një vend pune që i përshtatet aftësive të tyre. Megjithatë, njerëzit e papunë duhet të pranojnë detyrën e tyre për të qenë fleksibël dhe të pranojnë vende pune të pakëndshme.

203. Sigurimi i papunësisë duhet të jetë i gatshëm që të promovojë punësimin dhe në parim të kufizojë veten me funksionin e tij të sigurimit. Synimi ynë i parë është të garantojmë më tepër punësim në tregun e punës. Duke e çuar më tej këtë synim, ne duam që të vëmë në jetë instrumentet e politikës të tregut aktiv. Detyrat e shoqërisë si garantimi i mundësive për trajnim do të financohen nëpërmjet fondeve nga buxheti.

### ***Sigurimi i Dëmtimeve Industriale***

204. Sigurimi i detyruar i dëmtimeve industriale luan një rol të rëndësishëm në lidhje me sigurinë e punëtorit në punë, parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e shëndetit. Ai është një shtyllë e rëndësishme e parandalimit, kujdesit mjekësor dhe rehabilitimit. Duhet të jetë e mundur në të ardhmen që të vlerësohet sigurimi i detyruar i dëmtimeve industriale të vetë-administruara në fushat e tij me përgjegjësi më të gjerë nëpërmjet kritereve të tij ekonomike dhe të kufizohet me aksidentet e ndodhura gjatë punësimit ligjor.

### ***Sigurimi Social për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara***

205. Ne duam të sigurojmë pjesëmarrjen e ardhshme dhe vetëvendosjen e njerëzve me aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë se njerëzit me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë njëloj në çdo gjë – në të gjitha aktivitetet intelektuale, sociale, kulturore, profesionale dhe politike në shoqëri. Ne duam të krijojmë kushtet kuadër për këtë gjë.

Aftësitë e kufizuara shpesh shoqërohen me kufizime pak a shumë të rënda që nuk mund të kompensohen gjithmonë. Një shoqëri e



bazuar tek solidariteti mbështet njerëzit me aftësi të kufizuara aty ku mbështetja është e dukshme dhe duhet të kompensohen dizavantazhet intelektuale. Megjithatë, kjo nuk i trajton ata si me patronazh, me kujdes dhe vëmendje të ekzagjeruar.

206. Është e domosdoshme për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe njerëzit jo me aftësi të kufizuara që të mësojnë sa më herët që të jetë e mundur që të shoqërohen automatikisht me njëri-tjetrin dhe të shikojnë pikat e tyre të ndryshme të forta dhe të dobëta. Mënyra më e mirë për t'ia dalë mbanë është nëpërmjet rritjes dhe edukimit të përbashkët në familje, institucionet e fëmijërisë së hershme dhe shkollave. Ashtu si dhe në rastin e lehtësive të infermierisë dhe kujdesi shtëpiak, parimi themelor: “Trajtimi i pacientit të jashtëm është më i mirë se sa trajtimi i pacientit të brendshëm”, duhet të ndiqet edhe këtu për koordinimin me njerëzit me aftësi të kufizuara dhe të afërmit e tyre. Për sa ju përket fëmijëve, kjo do të thotë se një përvojë e përbashkët e bazuar tek shtëpia për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me aftësi jo të kufizuara duhet të zërë vend qendror. Pjesëmarrja e njerëzve me aftësi të kufizuara në jetën e punës duhet të mbështetet si një përpjekje për të ofruar më tepër shanse pune në tregun e parë të vendeve të punës.

207. Ne duam të krijojmë një mjedis jete në të cilin të gjithë qeniet njerëzore, qofshin me aftësi të kufizuara apo të rrënuar, të mund të lëvizin ngado lirshëm. Parakushti jetësor për këtë është një shoqëri pa barriera. Shumë njerëz me aftësi të kufizuara janë të kufizuar rëndë në lëvizshmërinë e tyre. Duhet të forcohet ndërgjegjshmëria për nevojën për një shoqëri pa barriera në qytet dhe në planifikimin urban.

## 5. Buxhet i Qëndrueshëm për një Gjermani Solide

### ***Reduktimi i Borxhit dhe Ndalimi i Marrjes së Borxheve të Tjera***

208. Tani për tani, barra e borxhit në Gjermani është pothuajse shtypëse. Veç kësaj, një pjesë tepër e vogël e potencialit financiar të vendit investohet për të ardhmen. Ndryshimi demografik në Gjermani gradualisht po bëhet një barrë e rëndë për sistemet e sigurisë sociale dhe buxhetin kombëtar. Kjo është arsyeja përse duhet të reduktojmë në mënyrë drastike borxhin kombëtar. Një politikë që do të ndjekë



në mënyrë konsistente reduktimin e marrjes së borxheve do të rrisë besimin dhe përgatitjen e qytetarëve dhe industrialistëve për të investuar në vendin e tyre ekonomik. Borxhet e sotme janë taksat e së nesërme.

209. Begatia e vendit tonë rrezikohet në qoftë se shteti vazhdon të shpenzojë më tepër se sa merr. Në qoftë se ne nuk i themi ndal marrjes hua, shteti nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrat e qenësishme në të ardhmen. Ne duam një vend që të sigurojë të ardhmen e fëmijëve të tij dhe jo të jetojë në kurriz të tyre. Ne duam një vend në të cilën qeveria të jetë në gjendje të ndihmojë qytetarët më të dobët. Në lidhje me këta njerëz të cilët varen nga ndihma e shtetit dhe duke respektuar siç duhet drejtësinë mes brezave, do të thoshim: “Futja në borxh kombëtar është jo sociale”.

210. Për të frenuar marrjen e mëtejshme të borxhit publik, para së gjithash, është e domosdoshme të përcaktohet në kuptimin më të ngushtë të termit ‘Investimi Publik’. Mund të financohen me kredi vetëm ato investime që krijojnë aset ose pasuri. Veç kësaj, borxhet që rezultojnë nga investimet e financuara me kredi, duhet të anulohen në parim pas një afati përfundimtar të vendosur në dhënie. Kjo siguron që rregullimet kushtetuese të kenë efektivisht huamarrje të kufizuar dhe që qeveria vërtet të frenohet në marrjet e reja të borxheve. Si afat i fundit nga mesi i dekadës tjetër, ne do të donim t’i ndalonim fare huamarrjet e reja që do të kufizojnë mundësitë e huamarrjeve të reja për shumën të pranueshme. Ky kufizim duhet të futet në Ligjin Bazë, në kushtetutat e shteteve federale dhe në instrumentet legjislative të autoriteteve vendore.

211. Ne përpiqemi për një marrëveshje të përbashkët për huamarrjen midis Federatës, shteteve dhe qeverisjeve vendore. Në kohërat e rritjes ekonomike, duhet të merren masa parandaluese kundër lëkundjeve të ardhshme të tregut, dhe në të njëjtën kohë të reduktohet marrja borxh nga vendi. Veç kësaj, të gjitha tatimet dhe shpenzimet në të gjitha nivelet duhet të shqyrtohen shpesh herë për tu siguruar që të jenë të qenësishme dhe efektive. Për të siguruar transparencën në shpenzimin qeveritar, ne duam t’i detyrojmë qeverinë, rajonet dhe qeverisjet vendore të respektojnë parimet e kontabilitetit tregtar.

212. Vendet e punës për të gjithë dhe një buxhet solid i shtetit janë të ndërvarura. Për këtë arsye ne do të rinovojmë sistemin e të ardhurave kombëtare në atë mënyrë që të lehtësojmë faktorin: punë. Ne duam t'i shkëpusim kostot shtesë për pagat nga kostoja e punës në mënyrë që të bëjmë të mundur krijimin e vendeve të tjera të punës në Gjermani. Kjo është arsyeja për se ne duam të reduktojmë taksat e drejtpërdrejta dhe kontributet sociale dhe ta financojmë këtë reduktim të barrës nëpërmjet taksave indirekte. Gjëja e rëndësishme është kjo: reduktimi i barrës nga taksat të drejtpërdrejta dhe kontributet sociale të paktën duhet të jenë aq sa ngarkesa shtesë me taksën indirekte.

### ***Reforma e Ligjit Financiar***

213. Federalizmi i Gjermanisë ka nevojë për një ligj financiar transparent. Përgjegjësitë e organeve të ndryshme publike duhet të jenë të praktikueshme. Vetëm atëherë ai mund të marrë vendimet e duhura politike dhe t'i bëjë ato bazën e zgjedhjes së tij për vendimin. Prandaj ne duhet për këtë arsye të sigurojmë respektimin e parimit të lidhshmërisë.

Ligji financiar duhet të marrë në konsideratë siç duhet skenarët e ndryshëm të përfshirë, të krijojë kushtet kuadër të krahasueshëm në shtete të ndryshme dhe të garantojë incentiva, në mënyrë që të forcohet fuqia e tyre ekonomike dhe financiare. Ne e përkrahim konkurrencën federale me kushte të ndershme. Do të rritet mbajtja e shumave të shteteve që do të mblidhen kur situatat e tyre ekonomike të bëhen më të fuqishme. Pas një rregullimi të përkohshëm deri në vitin 2019, duhet të jetë e mundur që të arrijmë në një kompensim të thjeshtë financiar pa rregullime speciale për të gjithë shtetet. Gjithashtu, pakti i solidaritetit për këtë periudhë kohore do të ketë kaluar.

214. Ne duam tua bëjmë të mundur shteteve që të marrin përsipër përgjegjësinë e tyre financiare dhe në këtë mënyrë, të krijojnë kushtet përkatëse kuadër në ligjin e tatimeve. Vendet që mbajnë kufijtë deri në nivelet e marrjes të borxhit prej tyre dhe nuk kontribuojnë në arritjen e dispozitave të Traktatit të Maastricht duhet t'i nënshtrohen në të ardhmen një ushtrimi përmirësimi.



215. Ne duam të fusim një sistem të lajmërimit të hershëm me një ligj buxheti të emergjencës. Ai siguron që në të ardhmen të ndërmerret veprim jo vetëm kur vihen re emergjencat buxhetore. Si kusht për ndihmë nga Federata duhet të nënshkruhet një marrëveshje përmirësimi midis Federatës dhe shtetit në fjalë.

216. Qeveritë vendore, gjithashtu duhet të fuqizohen për të marrë përsipër gjithnjë e më tepër përgjegjësinë e tyre. Kapaciteti i tyre financiar ka një impakt imediat në jetën e përditshme të qytetarëve. Kjo është arsyeja përse ne do të vazhdojmë të zhvillojmë sistemin e tatimeve të komunitetit vendor, në mënyrë që të rritim efikasitetin e qeverive vendore që t'ia dalin vetë për banorët e tyre.

### ***Tatimet – të Thjeshta dhe të Drejta***

217. Duke paguar tatimet e tyre qytetarët vënë në dispozicion të shtetit mjetet e domosdoshme financiare për të përmbushur detyrat e tij. Në mënyrë që qytetarët të pranojnë ligjin e tatimeve, ai duhet të ndjekë këto parime: i thjeshtë, i ulët dhe i drejtë. Kjo korrespondon me vlerat bazë të solidaritetit, përkatësisht se njerëzve me kapacitet financiar duhet tu jepen përgjegjësi më të mëdha se sa atyre që janë të dobët. Në të njëjtën kohë, ligji i tatimeve nuk duhet të kufizojë lirinë financiare të qytetarëve nëpërmjet tatimeve të ekzagjeruara. Ligji i tatimeve i cili parashikon përqindje të ulëta tatimore promovon performancën dhe iniciativën dhe u mundëson qytetarëve që të marrin masa paraprake për të parandaluar ndonjë risk në jetë. Një sistem i thjeshtë tatimesh krijon më tepër barazi se sa një sistem i komplikuar i cili përpiqet të mbulojë çdo detaj. Sa më i komplikuar që të jetë ai, aq më tepër avantazhe i ofron atij që është në gjendje të punësojë konsulencë të shtrenjtë, pa të cilën nuk do të ishte në gjendje të përdorte mundësitë për të kursyer nga tatimet.

218. Një sistem tatimor largpamës për shoqëritë duhet të fillojë nga dija bazë se shoqëritë në radhë të parë janë ente ekonomike dhe tatimpaguese. Ai duhet të formësojë barrën e tatimit në mënyrë të tillë që t'ia vlejë krijimi dhe vazhdimi i zhvillimit të sipërmarrjeve të biznesit në vendin tonë, duke krijuar shanse për vende pune dhe duke investuar në kërkim dhe zhvillim. politika e tatimeve është edhe një politikë novatore. Ajo duhet të jetë në gjendje sa më shumë që të jetë e mundur,

të garantojë dhe të bëjë të thjeshtë dhe transparente paanësinë në konkurrencë që nuk varet nga reforma e ligjit të shoqërive. Në këtë rast, duhet të jemi të përgatitur të përballojmë rrjetin e ekonomive në mbarë botën.

## 6. Duke u Bazuar në Arritjet Historike - Të Mbështesim Zhvillimin e Shteteve të Reja Federale

219. Nëpërmjet Revolucionit të 17 Qershorit 1953 dhe veçanërisht Revolucionit Paqësor 1989, populli i ish Republikës Demokratike Gjermane (RDGJ), duke besuar tek liria, demokracia dhe ekonomia sociale e tregut, vunë premisat për ribashkimin e Gjermanisë. Të gjithë gjermanët, nga lindja dhe nga perëndimi, duhet të jenë krenarë për këtë arritje historike. Shtetet e reja federale me traditat e tyre të mëdha historike dhe kulturore u japin gjermanëve një shtysë të re.

220. Shtetet e reja federale kanë bërë një transformim vendimtar nga diktatura totalitare drejt një demokracie dhe nga një ekonomi e planifikuar nga qendra në një ekonomi sociale të tregut. Në sajë të angazhimit dhe solidaritetit në të gjithë Gjermaninë, transaksionet e transferimit financiar unik nga ana historike, këmbëngulja dhe vendosmëria për të zhvilluar, shumë fusha tani po lulëzojnë dhe ofrohen si ana moderne e Gjermanisë në zemër të Europës.

221. Nëpërmjet reformave në sektorin e arsimit, përshpejtimit të procesit të planifikimit të lehtësuar nga reduktimi i telasheve burokratike dhe në bashkëpunim të ngushtë me industrinë, shkencën dhe teknologjinë, shtetet e reja federale dhe banorët e tyre kanë marrë përsipër rolet e novatorëve.

222. Reperkursionet e diktaturës komuniste, ndarja e Gjermanisë dhe ekonomia e keq menaxhuar si dhe humbja unike nga ana historike e qytetarëve të klasës së mesme janë ende të freskëta në kujtesën tonë. Një ekonomi që mund ta mbajë veten është ende duke u bërë. Pavarësisht shumë sukseseve të shënuara në përpjekjet e modernizimit, ka ende deficite të infrastrukturës në sektorin publik dhe në strukturën ekonomike.



223. Si rezultat i zgjerimit të Bashkimit European në Lindje, po lindin shanse të reja ashtu si në rastin e presionit shtesë të konkurrencës në ekonominë e Gjermanisë Lindore të strukturuar dobët. Shumë shoqëri të vogla dhe të mesme nuk kanë bërë përgatitje të mjaftueshme për to dhe të gjitha kërkesat e globalizimit.

224. Transformimi demografik i vazhdueshëm po qëllon shtetet lindore më fort se sa shtetet përëndimore. Një reduktim drastik në ritmin e lindjeve, plakja si dhe emigrimi i shumë të rinjve të orientuar nga arritja dhe mjaft të kualifikuar ka humbjet e veta në burimet disi të rralla të vendit. Historia e Republikës Federale të Gjermanisë ka demonstruar në shumë sfera se është e mundur të përjetohet një ndryshim nga fushat e emigracionit në fushat me objektiv. Synimi i politikës të CDU-së është që rajonet në lindje të Gjermanisë të ofrojnë perspektiva tërheqëse për njerëzit.

225. Kemi nevojë të forcojmë edhe shoqërinë civile në shtetet e reja federale, d.m.th., si një themel për demokracinë, sundimin e ligjit dhe ekonominë sociale të tregut. Vetëm një shoqëri civile funksionuese mund të sjellë një hov ekonomik dhe stabilitetin e shoqërisë sonë demokratike liberale. Në shtetet federale nuk kemi nevojë vetëm për një dorë të lirë më të madhe për proceset ekonomike të tregut dhe politikat me mendësi konkurruese për hapjen ekstensive dhe klauzolat eksperimentale në lidhje me ligjin federal. Popullit duhet t'i jepen edhe më tepër shanse për të marrë përgjegjësi për të ardhmen e tyre. Kështu, ne krijojmë kushtet për aktorët që të mbeten në vendin e tyre me njohuritë dhe shprehitë e tyre dhe për investitorët të sjellin kapitalin e tyre në shtetet e reja. CDU i kushton vëmendje të veçantë integritit të të rinjve efikas në tregun rajonal të punës. Njëpërmjet bashkëpunimit të të gjithë aktorëve, kjo do të kontribuojë për stabilizimin demografik të rajoneve.

226. Zonat novatore, me rritje ekonomikisht dinamike zhvillohen veçanërisht në qytetet e mëdha, në zonat me popullsi të madhe dhe qendrat turistike. Ne duam të mbështetim iniciativat e sipërmarrjes në qoftë se ato çojnë në një strukturë konkurruese të shoqërisë brenda shoqërive operuese të mesme dhe të mëdha në gjithë rajonin. Në këtë drejtim, ne duhet të përqendrojmë fondet tona për mbështetjen në zonat e rritjes me rrjetin e tyre të industrisë të orientuar nga

teknologjia, shkenca dhe kultura. Është me vend që të krijohet një lidhje midis kërkimit të shquar dhe teknologjisë së lartë, nga njëra anë dhe shoqërive dhe kreditorëve nga ana tjetër në mënyrë që të zhvillohen produkte të përfunduara të tregtueshme të rangut botëror.

227. Zonat e rritjes duhet të bashkohen me rajonet më të dobëta nga ana strukturore nëpërmjet infrastrukturave të tyre efikase, veçanërisht nëpërmjet një shërbimi tërheqës të pasagjerëve, në mënyrë që këto rajone të dobëta nga ana strukturore të marrin pjesë gjithashtu në bum-in ekonomik. Në rajonet me dendësi popullore të ulët dhe në zonat që nuk kanë mbipopullim ne duhet të përqendrohemi në mbështetjen e sektorëve dhe degëve specifike. Promovimi i rajoneve veçanërisht me dizavantazh në shtetet e reja federale nëpërmjet Bashkimit Europian duhet të vazhdohet në mënyrë që të përballohet konkurrenca në nivel ndërkombëtar.

228. Shtetet e reja federale kanë nevojë që tu jepen të gjitha fondet e premtuara atyre në paktin e solidaritetit deri në vitin 2019. Fondet duhet të përdoren për qëllimin e mbylljes së hendeqeve që ekzistojnë akoma në infrastrukturë, promovimin me objektiv të investimit dhe kompensimin për fuqinë financiare të autoriteteve vendore më të ulët se sa përpjesëtimorja. Kjo është një përpjekje për të arritur zhvillimin ekonomik vetë-mbështetës dhe modernizimin e mëtejshëm.

229. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës të transportit është një parakusht esencial për hovin ekonomik. Rrugët europiane të trafikut, veçanërisht ato brenda Europës së Mesme dhe Lindore dhe rajonit të Detit Baltik duhet të ndërtohen me shpejtësi.

230. Investimet e qëndrueshme në industri dhe infrastrukturë mund të jenë të suksesshme vetëm në qoftë se do merret në konsideratë evolucioni demografik. Infrastrukturat që nuk përdoren sipas kapacitetit duhet të ndryshohen për t'ju përshtatur evolucionit demografik. Gjithashtu, duhet të pranohen standardet e ndryshme të mënyrës së jetesës dhe administrimit. Megjithatë, shteti duhet të marrë përgjegjësi për standardet minimale të jetesës. Synimi ynë është akoma të arrijmë standardet e barabarta në kushtet e jetesës. Iniciativa personale duhet të zhvillohet në vendin e duhur. Cilësia e jetës do të përkufizohet në mënyrë të ndryshme në të ardhmen jo vetëm në shtetet e reja.



## VI. TË RUAJMË ATË QË KA KRIJUAR ZOTI DHE JETA - MJEDIS NË TË CILIN JA VLEN TË JETOHET

### 1. Mbrojtja e Dinjitetit Njerëzor – nga fillimi deri në fund të jetës

231. Dinjiteti i pacenueshëm i njerëzimit si krijimi i Zotit nuk mund të vendoset në dispozicion të qenieve njerëzore të papërgjegjshme. Ai duhet të mbrohet. Qenia njerëzore është gjithmonë një subjekt dhe kurrë nuk duhet të bëhet një objekt. Dinjiteti i njerëzimit gjithashtu është burimi dhe pika orientuese për vlerësimin e sfidave bio-teknike. Ai kërkon respektim dhe mbrojtje të jetës njerëzore në të gjitha etapat. Duke filluar nga spermat dhe qelizat vezë, jeta e palindur kërkon vëmendjen tonë të veçantë dhe trajtimin tonë kritik të mundësive të hapura ndaj zhvillimit të shpejtë të diagnostikimeve paranatale. Ne kërkojmë ndalimin e diagnostikimeve para implantimit (PID). Ne nuk pranojmë shifrat e larta të aborteve të cilat përfshijnë edhe abortet e vona. Ne duhet t'i ndihmojmë burrat dhe gratë të vendosin për jetën.

232. Shërimi, lehtësimi i dhimbjes dhe shoqërimi i njerëzve, jeta e të cilëve është në rrezik janë të gjitha shprehje të humanitetit, solidaritetit dhe dashurisë me bazë kristiane për fqinjin. Njerëzit me aftësi të kufizuar, të sëmurët, ata që janë duke vdekur dhe njerëzit në situata të tjera të vështira të jetës kanë të drejtën e një jete dinjitoze. Ne mbështetim mjekësinë paliative, punën e lëvizjes për kujdesin paliativ dhe format e tjera të shoqërimit në vdekje, të cilat u lejojnë pacientëve që i afrohen vdekjes dhe të afërmve të tyre që të kenë një ndarje me dinjitet. Ne refuzojmë eutanazinë aktive. Ne duam të inkurajojmë përgatitjen e njerëzve për të dhuruar organe.

233. Kërkimi në shkencën bio-mjekësore ofron zgjidhje për problemet në të ardhmen dhe kontribuojnë mjaft për kurimin e sëmundjeve dhe lehtësimin e vuajtjes. Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme të peshohen risqet kundër përfitimeve që sjell ai. Respektimi për



dinjitetin e njerëzimit ka përparësi mbi lirinë e kërkimit dhe sigurimin e konkureshmërisë sonë. Ne jemi në favor të mbrojtjes konsistente të embrionit dhe refuzojmë kërkimin në ripërdorimin e embrionit. Ne do ta mbronim këtë si në nivelet europiane edhe ato ndërkombëtare. Refuzojmë klonimin e qenieve njerëzore.

## 2. Mbrojtja e Burimeve Natyrore

234. Sipas besimit kristian njeriu, natyra dhe mjedisi janë krijimi i zotit. Është detyra jonë ta mbrojmë krijimin. Parimi i qëndrueshmërisë është një pjesë integrale e politikës Kristian Demokrate: Ne duam ta mbrojmë dhe t'ia dorëzojmë fëmijëve tanë një botë që ende ja vlen të jetohet nesër. Brezat e ardhshëm kanë të drejtën për zhvillim ekonomik, mirëqenie sociale dhe një mjedis të padëmtuar.

235. Mbrojtja mjedisore orientuar drejt së ardhmes dhe klimës krijojnë shanse për vende pune. Arsimit ekologjik, kërkimit dhe zhvillimit, teknologjisë mjedisore, mbrojtjes mjedisore, mbrojtjes së klimës dhe novacionet pasuese, për këtë arsye, u duhet dhënë mbështetje e qëndrueshme. Në interes të klimës dhe mbrojtjes mjedisore, ne dëshirojmë të ruajmë rolin udhëheqës të Gjermanisë në botë në lidhje me teknologjitë mjedisore. Në këtë mënyrë, ne do të jemi në gjendje të japim një kontribut substancial për të vlerësuar krijimin në vendin tonë, krijimin e vendeve të reja të punës dhe forcimin e klasës së mesme.

236. Çrrënjësja e varfërisë dhe mbrojtja e burimeve natyrore kanë varësi reciproke. Edhe varfëria çon në mbi-përdorimin e natyrës. Si rezultat, diversiteti biologjik dhe për pasojë burimet jetësore të njerëzve që jetojnë aty eventualisht do të shkatërrohen. Kështu, për ne, politika e mbrojtjes mjedisore përbën një pjesë të rëndësishme të politikës sonë të jashtme dhe të zhvillimit dhe një kontribut në drejtësinë globale.

237. Sipas pikëpamjes sonë, mbrojtja e mjedisit dhe avancimi ekonomik nuk e kundërshtojnë njëra tjetrën. Veçanërisht në një kohë kur kufijtë midis kapacitetit ekologjik të tokës po bëhen gjithnjë e më të qarta është me vend të themi: “Rritja ekonomike e qëndrueshme është e mundur kur mbrojtja e mjedisit dhe klimës merret parasysh gjatë procesit”. Veç kësaj, një përdorim ekonomik dhe efikas i burimeve po bëhet gjithnjë e



më tepër një avantazh kostoje dhe vendi. Për këtë arsye, ne mbrojmë një ekonomi sociale të tregut, me theksin tek çështjet ekologjike e cila do të ndjekë qëllimet mjedisore të parashtruara me kërkimin dhe zhvillimin e rritur, sistemet shpikëse me objektiv dhe programet e promovimit si dhe kuadrin e orientuar nga ana mjedisore. Ne mendojmë gjithashtu se në këtë rast duhet të vendosen tatimeve për konsumin afatgjatë të burimeve ose për barrën mjedisore në vend të taksave. Fitimet e mbledhura në këtë mënyrë do të zgjidhin për një kohë të gjatë çështjet që shqetësojnë mbrojtjen mjedisore dhe klimën.

238. CDU mbron përdorimin e kujdesshëm dhe ekonomik të burimeve të shterrueshme, një qëndrim pozitiv drejt kërkimit dhe zhvillimit si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve natyrore që promovon krijimtarinë dhe përgjegjësinë personale. Është e rëndësishme të kemi një arsim të cilësisë së lartë mbi mjedisin. Bashkë me shkollat, autoritetet vendore, shtetet federale, shoqatat mjedisore dhe të mbrojtjes së natyrës si dhe fermerët dhe punonjësit e pyjeve ne duam të ngulitim tek qytetarët një sjellje të ndërgjegjshme nga ana mjedisore.

### ***Mbrojtja e Klimës***

239. Ndryshimi global klimatik ka shkaktuar dëme të rënda tek krijimi dhe shanset e jetës së ardhshme për brezat e ardhshëm. Ne e shikojmë këtë si një detyrë etike dhe një detyrë politike e një rëndësie të madhe për të ardhmen për të kundërvepruar kundër këtij zhvillimi të ri: CDU përkrah faktin që Gjermania duhet të vazhdojë të jetë në pararojë të mbrojtjes së klimës dhe një përcaktues i ritmit në arenën ndërkombëtare. Bashkë me shumë vende të industrializuara, vende prag dhe vende në zhvillim, duam të promovojmë mbrojtjen e klimës. Një marrëveshje ndërkombëtare për ndryshimin e klimës që pas vitit 2012 dhe që bazohet në Marrëveshjen e Kjotos, merr incentiva ekonomike dhe pjesëmarrje aktive nga vendet e industrializuara, prag dhe në zhvillim, të cilat kanë qëndruar deri tani larg, përbën një hap gjigant.

240. Gjermania është e angazhuar për reduktimin e emisioneve të saj të gazrave të serave me 21 për qind deri në vitin 2012. Deri në 2020 ne duam të reduktojmë emisionet e gazrave të serave me të paktën 30 përqind kundrejt vitit 1990. Në këtë frymë, ne e konsiderojmë të

rëndësishme për vendet e tjera të industrializuara që të angazhohen gjithashtu për një reduktim serioz të emetimeve të gazrave të serave.

241. Ne ndjekim një strategji të dyfishtë për të luftuar ndryshimin e klimës, i cili vendos vlera detyruese prag për emetimet e gazrave nga serat dhe promovon përdorimin dhe zhvillimin e teknologjive miqësore ndaj klimës. Dioksidit të karbonit i duhet dhënë çmimi i përshtatshëm në mbarë botën në mënyrë që investimet në teknologjitë miqësore ndaj klimës të jenë të suksesshme. Masat e duhura këtu janë negociimi i ligjeve të emetimeve dhe transferimit të teknologjive në vendet në zhvillim dhe vendet prag me pajisje të përshtatshme për klimën. Synimi ynë është të kufizojmë ngrohjen globale deri në 20 gradë celsius krahasuar me situatat e paindustrializuara.

242. Kursimi i energjisë, rritja e efikasitetit së energjisë dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme janë shtyllat kryesore të politikës sonë për mbrojtjen e klimës. Në të njëjtën kohë është e domosdoshme që të zhvillohen që tani strategjitë për kufizimin e efekteve negative të ndryshimit të klimës. Një nga masat, për shembull, është përshtetimi i mbrojtjes nga baticat e larta dhe i bregdetit tonë. Mbi të gjitha, duhet të zhvillohen strategji të përshtatshme për përdorimin e tokës në kushtet e ndryshuara klimatike.

### ***Furnizimi i Sigurt me Energji***

243. Kërkesa për energji është duke u rritur shumë në mbarë botën. Për sa i përket varësisë së Gjermanisë nga importimi i lëndëve të para të rralla dhe të kushtueshme të energjisë, furnizimi me energji që është e sigurt, miqësore ndaj mjedisit dhe ekonomike, është një problem politik me rëndësi të madhe. Ne duam ta reduktojmë riskun e varësisë nga importi. Burimet e importit dhe rrugët e furnizimit me materiale të energjisë duhet të shpërndahen dhe partneritetet e energjisë dhe furnizimi dhe shtetet transit të zgjerohen dhe intensifikohen. Me anë të një politike të përbashkët energjie në Bashkimin European ne duam të forcojmë themelet mbi të cilat qëndron furnizimi i energjisë sonë.

244. Ne mbrojmë përdorimin ekonomik të burimeve tona të energjisë, përshtetimin e shfrytëzimit të burimeve tona të energjisë së rinovueshme në vend dhe zhvillimin e teknologjive më efikas të



prodhimit. Ne e shikojmë një potencial mjaft të madh në rindërtimin e sektorit të energjisë. Deri në vitin 2020 do të përpiqemi të dyfishojmë prodhimin e energjisë krahasuar me vitin 1990. Në këtë rast, do të ishte e domosdoshme që të decentralizojmë fasilitetet për prodhimin e energjisë.

245. Parimi bazë i furnizimit të sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe të pranueshëm nga ana ekonomike të energjisë është përzierja e përhapur gjerësisht e energjisë. Ne duam të formësojmë përdorimin e burimeve të energjisë nga fosilet të cilat janë po aq të përshtatshme për klimën sa është e mundur dhe në këtë mënyrë të krijojmë parakushtet për krijimin në Gjermani të një nga parqet e prodhimit të energjisë të durueshme nga ana mjedisore në botë.

246. Si burim energjie të brendshme energjitë e rinovueshme mund të kontribuojnë mjaft për të trajtuar rritjen e sigurisë së energjisë dhe për mbrojtjen e klimës. Ato ofrojnë shanse për një rritje miqësore ndaj mjedisit, për fushat novatore të biznesit dhe vendet e reja të punës. Në të njëjtën mënyrë, ne duam të vazhdojmë në mënyrë të rreptë të përdorim lëndët e para që mund të rriten përsëri si dhe burime të tjera energjie të ri-gjenerueshme. Këto përbëjnë perspektivën e zhvillimit të energjisë të erës jashtë shtetit, energjisë diellore dhe bio-termale dhe energjisë gjeo-termale. Për këtë duam të forcojmë teknologjitë për ruajtjen e energjisë.

247. Nëpërmjet incentivave të përshtatshme për novacionin teknologjik, do të dëshironim ta shtynim përpara konsumimin e burimeve të energjisë së rinovueshme. Nga viti 2020, ne gjithashtu duam që përqindja e energjisë së rinovueshme të të gjithë konsumimit të energjisë të ketë arritur të paktën 20 për qind. Veç rritjes në konsumimin e energjisë së rinovueshme në sektorët e energjisë dhe të karburanteve, përqindja e saj në prodhimin e burimeve të energjisë së ngrohtë dhe të ftohtë gjithashtu duhet të rritet. Synimi ynë është që në vitin 2050 energjitë e rinovueshme do të garantojnë pjesën kryesore të furnizimit me energji.

248. Në të ardhmen e parashikueshme ne nuk mund të bëjmë pa përdorimin e energjisë bërthamore për të prodhuar energji elektrike në Gjermani. Ajo luan një rol thelbësor si një masë e ndërmjetme

deri sa alternativat e qëndrueshme dhe ekonomike të energjisë të jenë të disponueshme me sasi të mjaftueshme. Brenda kuadrit të strategjive tona për mbrojtjen e klimës ne përqijemi për një zgjerim të kohës të ciklit për centralët e sigurt të energjisë bërthamore. Ajo që ne konsiderojmë si më e qenësishme është që të merren masat më të larta të sigurisë në çdo central. Në këtë drejtim, depozitimi i sigurt i mbetjeve radioaktive është me rëndësi të madhe. CDU është e angazhuar të ruajë kompetencat ekzistuese shkencore, teknologjike dhe të sigurisë në Gjermani. Kjo është e vetmja mënyrë se si Gjermania mund të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë në centralët bërthamore dhe në të njëjtën kohë të sigurojë shanse punësimi.

249. Kërkimi energjetik dhe teknologjitë e reja të energjisë novatore janë të domosdoshme për furnizimin e qëndrueshëm me energji. Ne duam të promovojmë energjinë e përhapur dhe të hapim kërkimin për energji dhe teknologji që do të kontribuojë në zhvillimin e burimeve energjetike miqësore ndaj klimës dhe zhvillimin e mëtejshëm të teknologjive që prodhojnë energji si dhe përdorimin racional të burimeve. Impiante moderne të pastra për minierat e qymyrit dhe impiantet e gazit përfshihen ashtu sikurse dhe kërkimi për fuzionin bërthamor. Ka shanse të mëdha për rritjen e shoqërive tona dhe për krijimin e vendeve të punës.

250. Për të ndërprerë rritjen e çmimeve të energjisë ne duam të punojmë drejt një konkurrueshmërie të shëndoshë në tregjet e energjisë dhe të gazit. Ne jemi të angazhuar që të largojmë shtrëngesat e konkurrencës dhe përshpejtojmë zgjerimin e infrastrukturës së lirë të arritshme për një tregti pa gabime ndërkufitare të energjisë dhe gazit në zonët e tregut europian.

### ***Formësimi i Mobilitetit në një Mënyrë të Pranueshme për Mjedisin***

251. Mobiliteti është nevoja bazë e shoqërive moderne dhe parakusht për zhvillimin ekonomik dhe begatinë. Kjo nevojë duhet të merret parasysh pa qenë nevoja që Gjermania të bllokohet në trafik apo që shëndeti ose qytetarët të rrezikohen. Ne mbështetim reduktimin e mbingarkesës së mjedisit tonë në sektorin e transportit dhe inkurajojmë zhvillimet që lidhen me të. Duam të reduktojmë zhurmën e trafikut dhe



ndotjen e ajrit. Përdorimi inteligjent i masave për drejtimin e trafikut, reduktimi konstant i ndotësve të dëmshëm, promovimi për automjete që emetojnë ndotës të ulët nëpërmjet taksave, konsiderimi i trafikut të ajrit në trajtimin e emetimeve si dhe promovimi i sistemeve publike të transportit të pasagjerëve për distanca të shkurtra, sipas pikëpamjes sonë, janë zgjedhje të mundshme. Në lidhje me një projektim të pranueshëm për mjedisin të transportit, trafiku me anije dhe hekurudhë po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Dhe mbi të gjitha ne do të krijojmë incentiva për zhvillimin e mëtejshëm të teknologjive lëvizëse kursyese dhe do të inkurajojmë përdorimin e burimeve alternative të energjisë.

252. Nëpërmjet kushteve kuadër efikase nga ana ekologjike dhe instrumenteve ekonomike të tregut ne duam të rritim qëndrueshmërinë klimatike të ajrit, trafikun e anijeve dhe të hekurudhës. Ne mendojmë se është e domosdoshme të reduktohet në mënyrë drastike emetimi i CO<sub>2</sub> të automjeteve të reja me teknologji të përmirësuar të motorit, përdorimin e karburantit bio dhe masave të tjera. Ne duam të reduktojmë në mënyrë drastike përdorimin e karburantit për të gjitha automjetet. Kjo do të mbrojë mjedisin dhe xhepat e konsumatorëve në të njëjtën kohë.

### ***Mbrojtja e Diversitetit të Natyrës***

253. Për shkak të rënies dramatike në mbarë botën të shumëllojshmërisë së specieve ne përkrahim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës. Ne duam të mbështetim vendet në zhvillim në ruajtjen nga ana e tyre të bio-diversitetit dhe përdorimit të tij të orientuar nga zhvillimi dhe të zhvillojmë në mënyrë efektive instrumentet për mbrojtjen e bio-diversitetit. Për të arritur këtë është absolutisht e domosdoshme që të krijohet një sistem europian dhe mbarë-botëror i fushave të mbrojtjes dhe fushave me lloje të ndryshme përdorimi në tokë dhe në det si një rrjet mbarë-botëror të jetës. Në këtë drejtim ne përkrahim edhe krijimin e një organizate të pavarur botërore të Kombeve të Bashkuara. Ne përkrahim gjithashtu një rregullim ligjor ndërkombëtar detyrues për mbrojtjen e pyjeve, veçanërisht për mbrojtjen e pyjeve të virgjëra.

### ***Në Mbështetje të Mbrojtjes së Kafshëve***

254. Respekti për të gjithë krijimin na detyron të sillemi në mënyrë të përgjegjshme ndaj krijesave të tjera. Mbrojtja e zogjve është një shqetësim i madh për ne. Ne insistojmë që zogjtë duhet të mbahen në përputhje me speciet e tyre dhe si pjesë e krijimit që duhet respektuar. Eksperimentet me kafshët duhet të reduktohen deri në minimumin më të vogël dhe të zëvendësohen me metoda të tjera.

### ***Trashëgimia jonë Natyrore: Një Shtëpi***

255. Peisazhet diverse natyrore dhe kulturore në Gjermani janë një pjesë veçanërisht e vlefshme e atdheut tonë. Ne duam ta ruajmë këtë trashëgimi jashtëzakonisht të pasur kombëtare natyrore edhe për brezat e ardhshëm.

256. Toka dhe toka e papunuar të cilat janë të fundme duhet të mbrohen, veçanërisht në zonat e populluara krahasimisht dendur në Gjermani. Përdorimi i rezervave të tokës duke ju referuar veçanërisht mbulimit të boshllëqeve të ndërtimit në qendrat e qytetit duhet të marrë precedencë mbi përdorimin e hapësirave mbi lëndinat e gjelbërta. Përdorimi i tokës duhet të reduktohet sa më shumë që të jetë e mundur. Politikat tona do të garantojnë kushtet kuadër në këtë drejtim.

## **3. Një e Ardhme për Bujqësinë dhe Zonat Rurale**

257. CDU do që të shikojë një bujqësi dhe pyje ekstensiv dhe lulëzues në Gjermani. Ne e shikojmë prodhimin e artikujve ushqimorë të cilësisë së lartë si detyrën tonë thelbësore në bujqësinë tonë. Fermerët dhe punonjësit e pyjeve duhet të prodhojnë lëndë të para të rëndësishme rigjeneruese dhe burime natyrore të rinovueshme. Për shumë breza deri tani ata janë kujdesur për peizazhin tonë kulturor dhe kanë pasur një impakt në zonat tona rurale. Ata e bëjnë këtë duke qenë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tyre ndaj njerëzimit, kafshëve, natyrës dhe mjedisit. Ata janë klientë të rëndësishëm për njerëzit e angazhuar në zeje dhe biznes. Në të njëjtën kohë, bujqësia dhe pyjet sigurojnë gjërat themelore të rikrijimit, argëtimit dhe turizmit.

258. Duke ruajtur dhe duke u kujdesur mirë për burimet, pronarët e tokës private luajnë një rol të rëndësishëm. Përgjegjësia personale dhe identifikimi i njerëzve me pronën e tyre është më efektive se sa pagesat që vendos shteti. Shërbimet që jepen në mbrojtje të mjedisit dhe natyrës në interes të publikut të gjerë duhet të nderohen. Është me rëndësi të madhe që të mbulohen ato me marrëveshje kontraktuale.

259. Udhërrëfyesi për CDU-në është një bujqësi shumë-funksionale dhe sipërmarrëse e cila pranon rrënjët e saj të fshatit dhe promovon në të njëjtën kohë krijimtarinë dhe novacionin. Ne e konsiderojmë të rëndësishme për shtetin që të tërheqim kontrollin e tij mbi tregjet e mallrave bujqësore dhe burokracinë e ngathët dhe masat e tepërta rregullatore. Orientimi i tregut, krijimtaria, edukimi i mirë dhe aftësitë e mira menaxhuese po bëhen kualifikimet kyçe që kërkohen. Ne do të forcojmë bujqit dhe ekspertët e pyjeve në këtë drejtim. Në këtë frymë, nuk bëjmë ndonjë dallim midis formave të biznesit dhe faciliteteve të prodhimit, bujqësisë konvencionale dhe organike. Diversiteti dhe orientimi i tregut të bujqësisë gjermane dhe prodhimit të ushqimit dhe shpërndarja për mjeteve do të jenë e pranishme si në tregun ndërkombëtar dhe tregun rajonal.

260. Ne kërkojmë që prodhimi dhe kushtet e punës të fermerëve të përmirësohen në politikën bujqësore europiane. Ne synojmë një konkurrencë të ndershme në tregjet e mallrave bujqësore europiane dhe ndërkombëtare. Angazhohemi që të harmonizojmë kushtet kuadër ligjore në Bashkimin Europian dhe konsiderimin serioz dhe koordinimin e aspekteve të mbrojtjes së mjedisit, natyrës, konsumatorëve dhe kafshëve.

261. Ne duam zona që janë të gjalla dhe që t'ia vlejë të jetosh në to. Ato janë vendndodhje për biznesin, kulturën, natyrën dhe rikrijimin. Ato kanë nevojë për perspektiva zhvillimi që e bëjnë të mundur për njerëzit të jetojnë atje dhe të gëzojnë një jetesë të mirë dhe kushte pune dhe mjedise arsimore. Vëmendja jonë e veçantë tërhiqet nga zonat rurale të pazhvilluara nga ana ekonomike dhe strukturore. Ato vazhdojnë të kenë nevojën e mbështetjes tonë të fortë për të zhvilluar infrastrukturën e tyre sociale dhe teknike dhe për të rritur fuqinë e tyre ekonomike.



262. Plantacionet e lëndëve të para rigjeneruese ose përdorimi i energjive të rinovueshme ofron shumë shanse për një dinamikë ekonomike dhe teknologjike përtej gamës së bujqësisë dhe kultivimit të pyjeve. Ne duam të vazhdojmë të rritim rolin udhëheqës të Gjermanisë në këtë fushë në lidhje me kultivimin e orientuar nga klima.

263. Inxhinieria gjenetike e gjelbër mund të kontribuojë mjaft në të ardhmen jo vetëm për sigurinë e ushqimit, por edhe për sigurinë e energjisë. Çështjet e sigurisë dhe siguria absolute duhet të marrin përparësi mbikonsideratat ekonomike. Përdorimi i inxhinierisë gjenetike për të arritur një përdorim më efikas të lëndëve të para, për të siguruar furnizimin me lëndë të para dhe për prodhimin e drithërave për energji duhet të ketë një kërkim të kujdesshëm. Kërkimi i suksesshëm duhet të ndiqet në Gjermani nga implementimi praktik i konstatimeve për produktet e reja.

264. Ne duam të promovojmë në mënyrë më serioze bujqësinë shumë-funksionale në të cilin ndodh kultivimi dhe përpunimi, dhe vazhdon marketingu i produkteve në procesin ekonomik rajonal.

## **VII. QYTETARË AKTIVË, NJË SHTET I FORTË, NJË VEND ME MENDJE TË HAPUR**

### **1. Forcimi i Shoqërisë Civile – Inkurajimi i Nismave Proaktive**

265. Rendi ynë demokratik liberal dhe institucionet e tij politike formojnë bazën e demokracisë tonë vibrante. Synimi ynë është që të konsolidojmë në mënyrë të vazhdueshme pronësinë dhe respektin për këtë rend. Në një botë që ndryshon me shpejtësi si kjo e jona, qëndrueshmëria e vendit varet nga fakti se qytetarët mund të kujdesen për njëri tjetrin dhe ta kuptojnë atë si një shprehje e lirisë së tyre personale dhe të shoqërisë. Ne duam një marrëdhënie midis qytetarëve dhe shtetit që bazohet tek partneriteti dhe besimi. Ne duam një shtet që mbështet qytetarët e tij, u jep besim, i ndihmon ata, u jep fuqi atyre



dhe u mundëson njësitë përkatëse më të vogla që të jenë të lira dhe personalisht të përgjegjshme.

266. Pjesëmarrja demokratike e qytetarëve shprehet në zgjedhjet dhe votimin e tyre si dhe në format e ndryshme të përfshirjes qytetare. Demokracia jonë e gjallë ka nevojë për angazhim të vullnetshëm dhe të lirë për mirëqenien e përgjithshme dhe mbështetet tek qytetarët aktivë.

267. Shpirti publik lind kohezionin në komunitet. Dedikimi i qytetarëve tanë është i pazëvendësueshëm. Çdo njeri ka aftësitë që mund ta pasurojnë të gjithë komunitetin. Çdo individ ka përgjegjësi të përbashkëta për mirëqenien e përgjithshme. Shpirti publik dhe një ndjenjë e përgjegjësisë demonstrohen në martesë, familje, kishë, vendin e punës, klube, shoqata, iniciativa të qytetarëve si dhe në komunitete, autoritetet vendore dhe tek shteti.

268. Pa punë vullnetare shoqëria jonë do të ishte varfëruar. Njerëzit që angazhohen në aktivitete honorifike, të cilët bëjnë punë sociale dhe kryejnë projekte qytetare për të gjallëruar njerëzit dhe për t'i ndihmuar ata financiarisht, duhet të inkurajohen dhe nuk duhen të shtrëngohen me rregulla dhe rregullore.

269. Ne duam qytetarë që janë të hapur ndaj përfshirjes qytetare dhe pranimit të përgjegjësisë. Zyrat honorifike dhe agjencitë vullnetare mund të organizojnë dhe mbështetin aktivitetet vullnetare. Ne përkrahim njohjen e aktiviteteve vullnetare dhe shërbimin vullnetar si profesionistë.

270. Shumë njerëz duke përfshirë veçanërisht burra dhe gra të biznesit kontribuojnë mjaft në mirëqenien tonë. Me përmirësimin e mëtejshëm të ligjit për donacionet, aktivitetet jo fitimprurëse dhe tatimet ne duam të mbështetim më tej angazhimin e tyre.

271. Shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile dhe grupet i përkasin një shoqërie civile aktive dhe të lirë. ata përcaktojnë në mënyrë të pavarur detyrat e tyre brenda kufijve të mirëqenies së përgjithshme. Ata kryejnë diskutime sociale dhe politike.

## **Sportet**

272. Sportet bashkojnë, ndërtojnë, aktivizojnë, emocionojnë dhe integrojnë njerëzit. Sportet kontribuojnë edhe në trajnimin e vlerave humane, të tilla si toleranca, ndershmëria, performanca, konkurrenca, përgjegjësia dhe e bëjnë njeriun që të pranojnë kufijtë e vet. Kështu, sportet mund të kontribuojnë mjaft në një botë paqësore dhe më të mirë.

Klubet janë baza e sporteve gjermane. Sponsorizimi i besueshëm i klubeve dhe atyre që marrin përsipër aktivitetet vullnetare atje janë qëllime jetësore të politikës sonë të sporteve. Sportet, ushtrimet fizike dhe ushqimi i shëndetshëm kontribuojnë mjaft në mirëmbajtjen e një shëndeti të mirë. Përgjegjësia personale e individit në sistemin e dhënies të kujdesit shëndetësor duhet të inkurajohet me incentiva. Parandalimi i sëmundjes nëpërmjet sporteve dhe lëvizjes redukton barrën e sistemeve tona sociale.

Institucionet e paprekura dhe një infrastrukturë sportive diverse janë parakushte të domosdoshme për të gjitha aspektet e sporteve aktive.

273. Ne përkrahim parimin e arritjeve në sporte, për sportet humane të niveleve të larta. Sportet e niveleve të larta luajnë një funksion të modelit të rolit për të gjithë nivelet e sporteve. Ne nuk mund të bëjmë pa promovimin e sporteve në forcat e armatosura federale gjermane, shërbimi policor dhe shërbimi doganor, dhe masën e lartpërmendur. Sportet, shkolla dhe arsimiti dhe trajnimi profesional duhet të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë promovimin e tyre me objektiv dhe sistematik për sportistët dhe sportistet e ardhshme të talentuara. Ne e përkrahim zhvillimin e shkollave elite për sportet. Performancat e njerëzve me aftësi të kufizuar në përgjithësi apo sportet e niveleve të larta janë magjepsëse dhe janë një shprehje e fuqisë së vullnetit dhe angazhimit të pavarur. Sportet dhe lëvizja forcojnë kapacitetin personal të performancës japin vetëbesim, lehtësojnë mobilitetin hapësinor dhe social të njeriut dhe janë një nxitës në jetë.

Shanset dhe incentivat për njerëzit me aftësi të kufizuar që të mundin të merren me sport duhet të zgjerohen më tej. Ne duhet të sigurojnë facilite sportive me akses pa barriera.

274. Dopingu shkatërron vlerat bazë të sportit, mashtron bashkë-konkurrentët dhe spektatorët dhe rrezikon jo vetëm shëndetin e sportistëve dhe sportisteve. Pranimi i sportit profesional varet gjerësisht nga një luftë realiste dhe e suksesshme kundër dopingut.

Dopingu konstatohet edhe në trajnimin në qendrat e trajnimeve dhe në aktivitetet e argëtimit dhe duhet një betejë e përbashkët për të gjithë aktorët në sport, politikë, industri, media dhe në fakt në të gjithë shoqërinë.

## 2. Për një Shtet të Fortë: Liria dhe Siguria për Qytetarët

275. Shteti ynë garanton dinjitetin dhe lirinë e qytetarëve. Ai e merr autoritetin e tij veçanërisht nga respektimi i të drejtave bazë. Ai duhet të promovojë mirëqenien e individit dhe të komunitetit. Në një shoqëri demokratike nuk ka të drejta pa përgjegjësi dhe nuk ka liri pa përgjegjësi.

276. Disa nga detyrat kryesore të shtetit janë mbrojtja e ligjeve bazë dhe parandalimi i abuzimit me pushtetin. Ai duhet të mbrojë qytetarët e tij nga kërcënimet e brendshme dhe të jashtme dhe të përmbushë përgjegjësinë e tij për të siguruar lirinë dhe paqen. Ai duhet t'i mundësojë individit që të zhvillojë veten lirshëm, të forcojë të dobëtin dhe të kujdeset që risqet të cilat individit nuk mund t'i përballojë vetëm të përballohen kolektivisht nëpërmjet solidaritetit. Veç këtyre, shteti duhet të mirëmbajë dhe të zhvillojë më tej rendin që është absolutisht i domosdoshëm për bashkekzistencën. Ai duhet gjithashtu të ruajë lirinë dhe diversitetin e pikave të forta dhe aftësive në shoqëri. Ai duhet të ruajë burimet natyrore për ne dhe për brezat e ardhshëm dhe të kontribuojë për mirëmbajtjen e krijimit të Zotit.

277. Në mënyrë që shteti të përqendrohet në përgjegjësitë e tij thelbësore ai nuk duhet të mbingarkohet me kërkesa, as të mbajë apo të marrë përsipër ato detyra që bien ndesh me parimet bazë të përgjegjësisë, lirisë dhe ndihmës nga shteti. Një shërbim efikas civil është parakusht për infrastrukturën e besueshme publike. Shërbimi i përhershëm civil mbetet i domosdoshëm në lidhje me ruajtjen e detyrave sovrane të shtetit. Ne duam një shtet të fortë por të vogël.

## *Liria në Përgjegjësi drejt Zotit dhe Njeriut*

278. Shteti ynë liberal lulëzon mbi premisat që vetë ai nuk është në gjendje t'i garantojë. Shteti nuk mund të parashkruajë vlerat. Këto vlera formojnë më tepër konsensusin social për një jetë në liri dhe përgjegjësi.

279. Ne pranojmë preambulën e Ligjit Bazë dhe në këtë mënyrë, përgjegjësinë tonë ndaj Zotit dhe njeriut. Ligji Bazë është i bazuar mbi parimet që janë të rrënjosura mbi besimet kristiane. Ato kanë një impakt të madh/themelor në vendin tonë dhe shoqërinë tonë. Nuk është vetëm detyra e kishës por edhe një përgjegjësi madhore e shtetit dhe qytetarëve që ta ruajnë atë në ndërgjegjen tonë dhe ta ruajnë dhe ta mirëmbajnë atë. Simbolet kristiane duhet të mbeten të dukshme në publik. Ato duhet të mbrohen në të njëjtën mënyrë si të Dielat e Krishtera dhe festat.

280. Në të njëjtën kohë ne njohim faktin se fetë e tjera gjithashtu transferojnë vlera që kanë një ndikim pozitiv në shoqërinë tonë dhe rendin tonë themelor liberal. Ne i respektojmë të gjitha përkatësitë fetare dhe presim të njëjtin qëndrim nga të gjithë njerëzit me përkatësi të tjera fetare. Ne kemi një përgjegjësi të veçantë ndaj komuniteteve hebre dhe sinagogave në Gjermani. Ata janë pjesë e kulturës tonë dhe përbëjnë një pjesë të domosdoshme integrale të shoqërisë sonë. Ata kontribuojnë në të njëjtën kohë për reputacionin e Gjermanisë në botë nëpërmjet aktiviteteve të tyre qytetare.

281. Ne pranojmë vetëmjaftueshmërinë dhe pavarësinë e kishave kristiane dhe kongregacioneve të tjera të njohura. Ne nënvizojmë përgjegjësinë e tyre të përbashkët për mirëqenien e qytetarëve. Ne mbështetim për këtë arsye sistemin e tyre ekzistues të mbledhjes së detyrimeve për kishën. Ne pranojmë arritjet e tyre shembullore në shërbimin praktik të qenieve të tyre njerëzore. Liria e kishave dhe organizimet fetare për të sjellë ndikimin e tyre moral mbi shoqërinë duhet të mbetet pa njollosur. Sundimi i ligjit liberal tek ne garanton të drejtën e praktikës së lirë fetare. Ne presim që të gjitha shtetet dhe qeveritë në mbarë botën të mbrojnë lirinë e tyre fetare. Ne duam të inkurajojmë një dialog të vazhdueshëm midis feve.



## ***Rendi Bazë Liberal Demokratik***

282. Parimi i bashkekzistencës i qenieve njerëzore në Gjermani është rendi i vlerave në Ligjin Bazë. Pikërisht mbi këtë themel të hedhur mirë është bashkuar kombi ynë në një shtet ligjor federal demokratik, liberal, social.

283. Ne përqafojmë demokracinë përfaqësuese e cila lidh udhëheqjen politike me përgjegjshmërinë demokratike. Demokracia përfaqësuese nuk përjashton elementet e demokracisë së drejtpërdrejtë. Këto elementë mund të plotësojnë në mënyrë të arsyeshme sistemin përfaqësues në nivel rajonal.

284. Ne jetojmë në një shoqëri me pikëpamje, opinione dhe interesa të ndryshme mbi botën. Kjo kërkon një formim demokratik të opinionëve në të cilën opinionet dhe interesat kundërshtuese të shkrihen në shumica, pa marrë parasysh shqetësimet dhe opinionet e pakicave. Parimi i shumicës lidhet me mbrojtjen e pakicave.

285. Partitë politike kanë një përgjegjësi të veçantë ndaj shtetit dhe shoqërisë. Ato veprojnë për shqetësimet sociale, kontribuojnë në formimin e opinionëve mbi çështjet politike dhe inkurajojnë qytetarët që të marrin pjesë në jetën politike. Ato përmbushin detyrën e tyre kur fitojnë besimin e qytetarëve dhe ofrojnë udhëzime objektive të qarta dhe jo partizane për vendimmarrjen e tyre. Proceset e tyre të formimit të opinionëve dhe puna duhet të jenë transparente.

Partitë popullore të qendrës u drejtohen të gjithë njerëzve në Gjermani. CDU si një parti popullore e qendrës është veçanërisht në gjendje të shkrijë interesat e ndryshme dhe të fokusohet në mirëqenien e përgjithshme.

286. Liria dhe përgjegjësia e medias është në përputhje me shoqërinë tonë të lirë. Ato janë efektive në formimin e opinionëve të publikut dhe kontribuojnë në fuqinë e shtetit. Pavarësia dhe diversiteti i tyre janë parakushte për këto funksione.

## ***Liria dhe Siguria në Sundimin e Ligjit***

287. Detyra e ligjit është të sigurojë bashkekzistencën e njerëzve në liri dhe paqe. Sundimi i ligjit siguron që të gjithë autoriteti i shtetit të lidhet me legjislacionin dhe ligjet. Ligji i jep shoqërisë sonë një kuadër për rendin. Ai vendos vlerat dhe përcakton kufijtë ndaj asaj që jemi në gjendje të bëjmë, veçanërisht kur rrezikohet dinjiteti njerëzor dhe liria. Sundimi i ligjit tek ne garanton sigurinë e drejtësisë.

288. Liria dhe siguria janë nevojat bazë të qenies njerëzore. Ato janë të ndërvarura. Monopoli i pushtetit të shtetit për të mbrojtur lirinë dhe sigurinë çon në pozicionin sovran që merr përsipër shteti. Shteti që nuk mbron veten kundër armiqve të tij shet lirinë e qytetarëve të tij. Për këtë arsye, na nevojitet vigjilenca përballë çdo intolerance, ekstremizmi dhe dhune. Nuk duhet të ketë tolerancë kundër intolerancës. Pas përvojës së dhimbshme me dhunën të motivuar nga ekstremizmi, jemi plotësisht të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që ne kemi për të luftuar kundër grupeve ekstremiste të krahut të djathtë dhe të krahut të majtë.

289. Parandalimi i krimit, mbrojtja nga rreziqet e sigurisë dhe rendit publik si dhe informacioni dhe dyshimi i krimit dhe keqbërjes janë parakushte të domosdoshme për një bashkekzistencë paqësore. Parandalimi i krimit është detyrë e të gjithë shoqërisë. Në këtë rast, familja dhe shteti me mbështetjen e medias duhet të marrin përsipër luftën kundër dhunës nga të rinjtë, e cila ndodh në shumë raste për shkak të integritetit të pasuksesshëm, roleve të keqkuptuara në shoqëri dhe mungesës së perspektivës. Vetëm një person që jeton pa frikë për veten, familjen e tij dhe pronën e tij mund ta besojë shtetin. Një shtet që neglizhon sigurinë, rrezikon që të refuzohet.

290. Konsiderimi i kriminalitetit si gjë e vogël është rrugë e gabuar. Ai që shkel ligjin dhe në këtë mënyrë sillet kundër rendit të vlerave të shoqërisë sonë duhet të llogaritet ndjekjen e rëndë dhe ndëshkimin e rëndë. Policia dhe gjyqësori luftojnë krimin. Një demokraci e qëndrueshme duhet t'i lejojë organeve shtetërore të përdorin me kujdes teknikat që nevojiten për të luftuar krimin dhe të marrë informacionin e domosdoshëm. Interesat e mbrojtjes së të dhënave duhet të jenë në përputhje me interesin për të luftuar krimin në mënyrë efektive. Mbrojtja e të dhënave nuk duhet të çojë në mbrojtjen e keqbërësve.



291. Terrorizmi që vepron brenda dhe krimi i organizuar janë në rritje. Qytetarët duhet të mbrohen kundër tyre. Bashkëpunimi ndërkombëtar i institucioneve që luftojnë krimin/institucionet korrektuese dhe gjyqësori duhet të rriten. Krimi pa kufij duhet të ndeshet me zbatimin pa kufij të ligjit.

292. 'Islamizmi' politik dhe 'Islamizmi' terrorist, të cilët e vënë interpretimin e tyre radikal të Islamit mbi kushtetutën tonë përbëjnë një rrezik serioz për qytetarët e Gjermanisë dhe gjithashtu për njerëzit që bashkohen me sundimin e shumicës mes myslimanëve. Ne do të promovojmë kohezionin social të të gjithë demokratëve përtej gjithë kufijve fetarë dhe në të njëjtën kohë do të luftojmë me konsekuencë fundamentalistët e dhunshëm.

293. Ai që do të përmirësojë sigurinë e brendshme duhet të forcojë policinë. Sigurimi i brendshëm në vendin tonë ka marrë një dimension global në saj të sfidave të reja. Instrumentet dhe organet e sigurisë së brendshme dhe të jashtme duhet të lidhen dhe të koordinohen fort. Për të realizuar konceptin tonë të sigurisë kombëtare, duhet të përmirësohet bashkëpunimi midis Federatës, shteteve dhe qeverive vendore.

Një aspekt i këtij koncepti të forcimit të vendin tonë janë edhe Forcat e Armatosura të Gjermanisë Federale. Në situatat e rrezikut serioz Forcat e Armatosura Federale gjermane duhet të dislokohen brenda. Forcat e Armatosura duhet të tregojnë aftësitë e tyre të veçanta për kapërcimin e rreziqeve që paraqet terrorizmi ndërkombëtar, dhe bashkë me policinë federale dhe rajonale, të mbrojnë qytetarët kundër katastrofave.

### ***Vazhdimi i Reduktimit të Burokracisë së Tepërt***

294. Ne e refuzojmë një shtet që rregullon çdo aspekt të jetës njerëzore. Ne kundërshtojmë rregullimin e tepërt nëpërmjet ligjeve dhe instrumenteve ligjore dhe burokracinë e tepërt në administratë. Liria qytetare dhe ekonomia sociale e tregut nuk duhen të mbyten nga një përmbytje normash. Ligjet dhe rregullat ekzistuese duhet të shqyrtohen rregullisht në lidhje me arsyen e të qenit të tyre. Duhet të provohet nga ligjvënësi dhe të dokumentohet domosdoshmëria e bërjes së ligjeve dhe rregulloreve të reja. Mund të ndiqet ky parim: "Në qoftë se nuk



është e nevojshme të miratohet një ligj, atëherë është e nevojshme të mos kalohet ligji”. Në të ardhmen, zgjidhjet dhe rregullimet e thjeshta ligjore në parim do të zbatohen vetëm për periudha të kufizuara. Ligjet duhet të jenë të qarta dhe sa më të shkurtra që të jetë e mundur. Natyra e qartë dhe sistematike e një ligji duhet të përmirësohet më tej. Duhet të thjeshtohen proceset administrative dhe strukturat zyrtare dhe duhet të rriten ofertat e qeverisë.

295. Çrrenjosja e telasheve burokratike duhet të fillojë me vendosjen e qëllimeve të shtetit. Çrrenjosja e burokracisë të panevojshme në favor të një administrate publike efikase që silltet tek dera e qytetarëve në një detyrë urgjente dhe konstante – në interes të qytetarëve, ekonomisë dhe shtetit. Qytetarët munden dhe duan të bëjnë me komunitetin dhe në komunitet më tepër se sa lejohen të bëjnë nga një divizion i errët dhe i papenetrueshëm shtetëror i punës dhe kompetencave. Ne duam në të gjitha nivelet shtetërore si dhe në nivelin europian një caktim të qartë të detyrave dhe sferave të përgjegjësisë. Është e rëndësishme të përqendrohen në të gjitha nivelet përpjekjet tona për reduktimin e burokracisë.

### ***Gjyqësori Efektiv dhe Zbatimi Konsistent i Ligjit***

296. Gjyqësori i pavarur është shtylla kurrizore e shtetit tonë ligjor. Ai mbron qytetarët nga arbitrariteti dhe abuzimi i pushtetit dhe siguron që secilit t’i jepet haku.

Proceset e gjata ligjore pengojnë restaurimin normal të paqes ligjore. Ne duam të mbajmë të përmirësojmë në qoftë se nevojitet efikasitetin e gjykatave të ligjit dhe prokurorisë publike.

297. Zbatimi i ligjit duhet të marrë parasysh interesat e sigurisë së qytetarëve. Ne synojmë ri-integrimin e ish kriminelëve në shoqëri, por qytetarët duhet të mbrohen në mënyrë të përhershme edhe nga kriminelët e rrezikshëm. Siguria dhe rehabilitimi nuk janë kontradiktore me njëra tjetrën. Gjithashtu, rehabilitimi duhet t’i nënshtrohet mbrojtjes së qytetarëve nga kriminelët. Mbrojtja e viktimës i paraprin mbrojtjes së kriminelit.



## ***Sistemi i Shtetit Social***

298. Sundimi liberal i ligjit dhe shteti social plotësojnë njëri tjetrin. Një sistem social i drejtë duhet të sigurojë kushtet kuadër të ekzistencës humane për të gjithë dhe të garantojë asistencën në kohët e katastrofave dhe emergjencave. Drejtësia sociale duhet të jetë veçanërisht efektive në lidhje me të dobët. Garantimi i jetës në një shtet social nuk do të çojë në paaftësinë nëpërmjet shtetit. Ajo duhet të promovojë efikasitetin e individit dhe të kërkojë përfshirjen e tij të përbashkët – edhe këtu, vepron parimi i solidaritetit.

### ***Federalizmi dhe Vetëqeverisja Vendore***

299. Struktura gjermane federale është një shprehje e vetëkuptimit të rritur plotësisht solid kulturor dhe historik i atdheut dhe identitetit të qytetarëve. Federalizmi dhe qeverisja vendore janë parime të qenësishme të rendit të shtetit tonë. Ne duam ta ruajmë dhe ta zhvillojmë atë. Ato kontribuojnë për sigurimin e lirisë së qytetarëve dhe për shpërndarjen e pushtetit shtetëror. Ato lehtësojnë promovimin e karakteristikave të ndryshme dhe interesave specifike të rajoneve të veçanta dhe të autoriteteve vendore. Zonat urbane dhe autoritetet vendore demonstrojnë çdo ditë në mënyrë të re në se funksionon apo jo komuniteti ynë. Në mjedisin imediat njerëzor të jetesës pranimi i sistemit tonë të komunitetit demonstron nëpërmjet përfshirjes aktive të qytetarëve dhe përcaktimit dhe pjesëmarrjes të tyre të përbashkët në procesin e vendimmarrjes vendore. Gjatë europianizimit dhe globalizimit autoritetet vendore të vetëqeverisjes janë pika më e rëndësishme e referimit dhe pika e ankorimit të shoqërisë sonë.

300. Detyrat publike duhet të përmbushen në përputhje me aftësinë e tyre ndaj qytetarëve në nivelin e qeverisjes vendore ku ushtrimi i tij është gjithmonë i mundshëm dhe i arsyeshëm. Duhet të krijohet një institucion financiar i përshtatshëm për qeverisjen vendore. Në lidhje me shpërndarjen e kompetencave dhe juridiksionit midis federatës, shteteve dhe qeverisjeve vendore, duhet të aplikohen parimet e ndihmës nga shteti dhe lidhjeve.

301. Bashkëpunimi i shteteve federale dhe legjislacionit dhe administratës federale është një parim i rëndësishëm i sistemit tonë

federal. Kjo vlen për bashkëpunimin midis vetë shteteve që ne duam të promovojmë. Detyra dhe përgjegjshmëria politike nga Federata, shtetet dhe qeverisjet vendore duhet të jenë të dukshme.

302. Federalizmi e fiton kuptimin e tij brenda kuadrit të globalizimit dhe zgjerimit dhe thellimit të Bashkimit Europian. Gjermania pasuron procesin nëpërmjet strukturave federale dhe përvojave që vijnë prej tyre.

### 3. Gjermania, Vendi i Integritit

303. Misioni kyç politik për CDU është integrimi i emigrantëve, veçanërisht fëmijëve dhe të rinjve të brezit të dytë ose të tretë. Ne e shikojmë integrimin si një proces gradual në përgjegjësinë e imigrantëve, të politikës dhe të gjithë shoqërisë. Migrimi dhe integrimi duhet të organizohen; ne e kuptojmë atë si një shans dhe pasurim. Politika jonë duhet të orientohet nga interesat social ekonomike të Gjermanisë të cilat në mënyrë të vazhdueshme marrin parasysh dimensionin europian të migracionit. Ajo duhet të jetë e ndërgjegjshme gjithashtu për detyrat e saj humanitare dhe përgjegjësinë e saj në lidhje me vendet më pak të zhvilluara.

304. Na nevojitet imigracioni i rregulluar për njerëzit me aftësitë të mëdha, të motivuar, punëtorë të cilët dëshirojnë të jetojnë, të punojnë, të adoptojnë vlerat tona dhe të pranojnë vendin tonë si shtëpinë e tyre. Gjermania duhet të bëhet tërheqëse për këta njerëz. Ata janë një aset për vendin tonë.

305. Ne ruajmë përgjegjësinë tonë historike për pranimin e atyre që janë vendosur vonë në Gjermani ndërsa në të njëjtën kohë edhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës në vendet e tyre të originës.

306. Gjermania është një vend me mendje të hapur dhe tolerant në të cilën gjermanët dhe të huajt jetojnë dhe punojnë paqësisht me njëri tjetrin. Gjermania gjithmonë ka pritur njerëz dhe i ka integruar shumicën e tyre me sukses, në mënyrë që tu mundësojë atyre të zhvillojnë talentet e tyre dhe të zhvillojnë vendin tonë nga ana intelektuale dhe kulturore dhe ta pasurojnë nga ana sociale dhe ta



zhvillojnë më tej. Nëpërmjet arritjeve të tyre, ata kanë qenë në gjendje që të përfitojnë një farë njohje. Në të njëjtën kohë, Republika Federale e Gjermanisë u jep shumë njerëzve statusin e refugjatit për arsye humanitare. Kjo është në përputhje me sensin tonë të përgjegjësisë bazuar në konceptin kristian të njerëzimit.

307. Gjermania është vendi i integrit. Integrim do të thotë pranimi i diversitetit kulturor mbi bazën e vlerave bazë të përbashkëta. Integrimi do të thotë gjithashtu të marrësh përgjegjësi për vendin tonë. Ne nuk e pranojmë bashkekzistencën e pa lidhur dhe shfaqjen e shoqërive paralele që nuk marrin parasysh sundimin e ligjit. Ai që do të jetojë në Gjermani duhet të pranojë vlerat dhe normat qendrore të sistemit tonë demokratik liberal, pa hequr dorë nga origjina dhe rrënjët e tij. Megjithatë, të drejtat e njeriut dhe demokracia janë të diskutueshme, ekziston e drejta e diferencës kulturore. Kjo vlen veçanërisht për trajtimin e barabartë të grave dhe burrave (d.m.th., barazia gjinore). Mbi të gjitha, secili duhet të bashkohet, qofshin emigrantë apo shoqëria pritëse. Një person që në mënyrë konstante hedh poshtë integrimin duhet të llogaritet sanksionet.

308. Njohja e gjuhës gjermane është kyçe për integrimin. Kërkesat e qarta dhe realiste nuk paraqesin vështirësi për ne. Ato janë në të kundërt baza e integrit social. CDU përkrah promovimin gjithëpërfshirës të integrit. Integrimi prek të gjitha sferat politike.

309. Integrimi i suksesshëm paraqet kërkesa për individin dhe sjell gjithashtu përgjegjësi të komunitetit dhe të shtetit. Ai ka nevojë për bashkëpunimin e secilit dhe prek çdo aspekt të jetës. Integrimi vendoset i drejtë në bashkekzistencën me të tjerë në komunitet. Barra e integrit të suksesshëm është mbi kishën, komunitetet fetare, institucionet kulturore dhe arsimore, organizatat e migracionit, media, sporti, fondacioneve, klubeve dhe shoqatave, shoqërive dhe sindikatave. Në këtë mënyrë, ne të gjithë përfitojmë nga një integrim i suksesshëm dhe imigracion i kontrolluar në biznes dhe punë si dhe në jetën tonë të përditshme me njëri tjetrin.

310. Ne e konsiderojmë natyralizimin si një shprehje e procesit të suksesshëm të integrit, që është në të njëjtën kohë pjesëmarrje e barabartë me të gjitha të drejtat dhe detyrat. Ky është një moment

vendimtar në jetën e individit i cili shpreh besnikërinë e tij ndaj kombit tonë. Ai duhet të njihet dhe të inkurajohet duke pasur parasysh një rënie në shifrat e dhënies së shtetësisë të marrë me një vlerësim vizual.

311. CDU ka inkurajuar planin kombëtar të integritit dhe mbështet një koncept gjithëpërfshirës të integritit i cili do të bëjë bashkë politikën e punës dhe ato sociale, të familjes, arsimore dhe të jo gjermanëve/të huajve nën të njëjtën ombrellë të quajtur politika e re e integritit. Kjo është mënyra dhe rruga që ne do të arrinim në një shoqëri të bazuar tek partneriteti.

## VIII. PRANIMI I PËRGJEGJËSIVE DHE INTERESAVE TË GJERMANISË

### 1. Shansi i Gjermanisë është Europa

312. CDU është partia gjermane për Europën. Që prej fillimit ajo ka çuar para me pasion procesin e unifikimit në Europë. Paraqitur me guxim nga Konrad Adenauer dhe më tej thelluar nga Helmut Kohl pas ribashkimit të Gjermanisë, ne jemi të angazhuar për vazhdimin e integritit të Europës. Bashkimi European është në interes të të gjithë shteteve anëtare dhe qytetarëve të tyre. Fuqia e Europës është gjithashtu shansi i Gjermanisë.

313. Europa është një shoqëri kulturore dhe e vlerës. Ajo bashkon qytetarët e saj në ndërgjegjen e tyre për identitetin e tyre. Shtetet kombe dhe identiteti i popujve të tyre janë komponentët e rrënjosur thellë të një Europe të unitetit në diversitet. Traditat e përbashkëta, fetë, idetë, arritjet intelektuale të kontinentit tonë lidhin së bashku njerëzit tanë përtej dallimeve kombëtare dhe rajonale, politike dhe ekonomike.

314. Koncepti kristian i njerëzimit si pjesë e trashëgimisë së përbashkët europiane është thelbësor për identitetin european. Edhe në këtë epokë të globalizimit ai është ende elementi themelor për formësimin e të ardhmes së Europës.



315. Në interesin tonë, Gjermania duhet të luajë një rol aktiv në përfundimin e procesit të unifikimit në Europë. Një Europë e përshtatshme mund të kujdeset më mirë për interesat tona në epokën e globalizimit së bashku me partnerët tanë transatlantik me të cilët jemi të gjithë të lidhur me vlerat e përbashkëta, lirinë, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

316. Uniteti europian është historia më e madhe politike e suksesit të kontinentit tonë. ai është modeli dhe pika e orientimit për shumë pjesë të botës. Që prej Luftës së Dytë Botërore, Europa sjell liri, paqe dhe begati. Uniteti Europian është çelësi për qëndrueshmërinë e tyre. Sot, Bashkimi Europian na garanton më tepër siguri të brendshme dhe të jashtme se më parë. Ne jemi të bindur se: Bashkimi Europian është përgjigjja më e mirë ndaj sfidave, të tilla si globalizimi, emigracioni, kërcënimet e reja ndaj sigurisë, ndryshimit klimatik dhe sigurisë së energjisë.

Asnjë shtet i veçantë nuk mund t'i përballojë dhe t'i zgjidhë këto sfida. Gjermanët dhe partnerët e tyre në Bashkimin Europian kanë të njëjtin fat të përbashkët. Sovraniteti i secilit shtet të veçantë mund të zhvillohet efektivisht në qoftë se ai praktikohet së bashku.

317. Gjëja e rëndësishme është se Bashkimi Europian pranohet nga qytetarët e tij. Ai duhet të fitojë fuqi të re bindëse për qytetarët e tij, sepse paqja, begatia dhe siguria janë të vetë dukshme për shumicën e qytetarëve në Bashkimin Europian. Ne duam të forcojmë nëpërmjet politikave tona besimin e qytetarëve tanë në Bashkimin Europian.

318. Ne duam që të rinjtë tanë të luajnë një rol aktiv në formësimin e integritetit europian. Kjo kërkon arsim intensiv për politikën dhe historinë e Europës. Ne duam një Europë të fortë dhe efikas. Në përputhje me parimin e ndihmës së shtetit, Bashkimi Europian duhet, për këtë arsye, të përqendrohet në ato detyra që ai mund të përmbushë më mirë në nivelin europian se sa kombet shtete me rajonet e tyre të ndryshme dhe qeveritë vendore. Kështu, është e domosdoshme të shqyrtohet struktura e detyrave gjatë amendamenteve të ardhshme të marrëveshjes të Bashkimit Europian. Do të jetë e mundur që të rishpërndahen disa nga detyrat tek shtetet kombe. Bashkimi Europian duhet të jetë demokratik, transparent, efikas, më pak burokratik dhe i arritshëm nga qytetarët.

319. Shpërndarja e fondeve në Bashkimin European duhet të kryhet në mënyrë më të synuar, efikase dhe të qëndrueshme; sistemi i financimit duhet të reformohet me themel për t'ju përshtatur pikave të forta ekonomike të shteteve të ndryshme anëtare pa e pasur Bashkimi European kompetencën për të vendosur taksa apo për të mbledhur kredi publike. Gjithashtu, në këtë drejtim, ne do tu shpjegojmë njerëzve se çfarë avantazhesh ka Europa për ta dhe çfarë perspektivash të ardhshme hapen për ta.

320. Si bashkim i qytetarëve dhe shteteve anëtare, Bashkimi European qëndron mbi një themel të ri me Traktatin e Lisbonës i cili bazohet në vlerat e përbashkëta dhe në konceptin european të njerëzimit, i cili është i rrënjësor në thelb tek kristianizmi, judaizmi, tek epoka klasike greko – romake dhe epoka e iluminizmit. Karta mbi të drejtat bazë të njeriut është një shprehje e këtyre vlerave. Ne përkrahim drejtimin tonë tek Zoti. Ne jemi të përkushtuar ndaj qëllimit afatgjatë të krijimit të një kushtetute për Bashkimin European.

321. Shteti komb do të transformohet, por më vonë ai do të ketë një status. Brenda kuadrit të kompetencave të deleguara atij nga shtetet anëtare të Bashkimit European ai vepron në përputhje me parimet dhe metodat e sistemit të shtetit federal.

322. Ne duam të forcojmë më tej demokracinë në Bashkimin European dhe të drejtat e Parlamentit European. Parlamenti European dhe Këshilli i Bashkimit European duhet të kenë të drejta të barabarta në pjesëmarrjen në procesin e legjislacionit european të sistemit me dy dhoma. Parlamentet kombëtare të shteteve anëtare duhet të legjitimojnë në të ardhmen kalimin e kompetencave sovrane të shteteve anëtare tek Bashkimi European. Ato duhet të luajnë edhe një rol të rëndësishëm në kontrollin e parimeve të ndihmës së shtetit dhe proporcionalitetit. Vota e qytetarit duhet të reflektohet në zgjedhjen e presidentit të Komisionit European nëpërmjet Parlamentit European gjatë zgjedhjes së Parlamentit European. Përveç kësaj, ne parapëlqejmë një të drejtë individuale europiane për të votuar.

323. Partitë politike në Europë kontribuojnë për krijimin e një ndërgjegjeje politike europiane dhe një shprehje të vullnetit të qytetarëve të Bashkimit European. Ne, Kristian Demokratët, e



përmbushim këtë detyrë si anëtarë të Partisë Popullore Europiane (EVP). Partitë europiane duhet më seriozisht se kurrë, të paguajnë kuotat e tyre, në mënyrë që të krijohet një forum publik europian, p.sh., nëpërmjet një personalizimi më të fortë të politikave europiane.

324. Si një vend që ndodhet në qendër të Europës, Gjermania varet nga marrëdhëniet e përzemërta me fqinjët e saj. Në cilësinë tonë si ekonomia më e populluar dhe më e madhe e Bashkimit Europian, duhet të paguajmë kuotat tona për aktivitetet e unifikimit si një vend me vetëbesim, me mendje të hapur dhe që mbyll hendeqe. Ne jemi të bindur se “Europa mund të ketë sukses nëpërmjet përpjekjes sonë të përbashkët të harmonizuar – për të mbajtur bashkë shtetet qofshin të vogla apo të mëdha, të vjetër apo të rinj, dhe duke pasur përsëri të drejta të barabarta. Franca është partneri më i rëndësishëm në Europë i Gjermanisë. Ne duam ta rrisim këtë marrëdhënie në mënyrë që Franca dhe Gjermania të mbeten në ballë të procesit të formësimit të Bashkimit Europian.

325. Për ne, Europë do të thotë në radhë të parë gjithashtu një Europë e rajoneve. Diversiteti dhe të qenit unik i rajoneve dhe komuniteteve në Europë duhet të ruhet përgjithmonë. Rajonet kufitare në fakt janë zonat ku realiteti i integritetit europian përjetohet dhe jetohet në një masë të madhe. Natyra e shumëllojshme e njohurive dhe kuptimit të veçantive politike, kulturore, gjuhësore, historike dhe shoqërore e rajoneve fqinje është baza e bashkëpunimit ndërkuftar. Kjo është arsyeja për se ne duam të inkurajojmë mësimin e gjuhëve të fqinjëve tanë. Zonat kufitare dhe mbi rajonale përbëjnë kështu blloqet e ndërtimit të procesit të integritetit europian dhe duhet të përfshijnë në vetvete në mënyrë të ndërgjegjshme këtë funksion të rëndësishëm me avantazh.

326. Rrënjët e atdheut, identiteti kombëtar dhe komuniteti europian plotësojnë dhe kërkojnë njëra tjetrën. Ne mbështetim të drejtat ndërkombëtare dhe europiane për grupet etnike dhe minoritetin, të drejtën e atdheut, të gjuhës dhe kulturës së personit.

327. Edhe në Europën e bashkuar me kufij gjithnjë e më të hapur njerëzit që janë përjashtuar nga vendi ku kanë lindur dhe grupet etnike luajnë një rol të rëndësishëm mes kombeve. Edhe gjermanët, të cilët



kanë jetuar në atdheun e tyre jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, mund ta marrin përsipër këtë funksion të rëndësishëm midis Gjermanisë dhe fqinjëve të saj në lidhje me bashkimin e mëtejshëm të Europës. Përjashtimi i çdo lloji duhet të refuzohet në të gjithë botën dhe duhet të njihen të drejtat e shkelura.

328. Raundet e zgjerimit të Bashkimit Europian kanë zgjeruar zonën e stabilitetit dhe kanë sjellë disa përfitime ekonomike dhe politike për Gjermaninë. Për shumë njerëz, duke përfshirë njerëzit nga vendet e Baltikut Perëndimor dhe të Europës Lindore, Bashkimi Europian është modeli i një shoqërie të hapur, i bashkekzistencës paqësore të popujve të ndryshme dhe në këtë mënyrë, një rreze shprese për të ardhmen e tyre politike dhe ekonomike. Bashkimi Europian duhet të justifikojë përgjegjësinë e tij ndaj këtyre njerëzve në këto vende europiane.

Anëtarësia e plotë në Bashkimin Europian nuk mund të jetë e vetmja përgjigje në çdo rast. Nuk janë vetëm kërkesat e anëtarësisë që përbëjnë shkopin matës për pranimin e anëtarëve të rinj, por edhe kapaciteti i anëtarësisë së vetë Bashkimit Europian. Ne e konsiderojmë si zgjidhjen më të përshtatshme një anëtarësi të privilegjuar në Bashkimin Europian të Turqisë.

329. Thellimi i mëtejshëm i Bashkimit Europian përcakton para së gjithash procesin e ardhshëm të zgjerimit. Kohezioni dhe efikasiteti duhet të rriten dhe procesi i integritetit duhet të vazhdojë. Procesi i zgjerimit europian duhet të kontribuojë në forcimin e identitetit europian. Marrëveshjet e Asociimit dhe partneritetet e veçanta si dhe modelet e bashkëpunimit shumë palësh, të tilla si zona ekonomike europiane, mund të shënohen si masa të ndërmjetme ose edhe si zgjidhje të përhershme. Vetëm shtetet europiane mund të bashkohen me Bashkimin Europian.

330. Stabiliteti dhe begatia e shteteve në fqinjësinë e tyre imediate është me rëndësi jetësore për sigurinë dhe begatinë e Bashkimit Europian. Për këtë arsye, Bashkimi Europian ka nevojë për marrëveshje të përshtatura dhe për fqinjësi të mirë.

331. Monedha e përbashkët europiane e shtyn më tej kohezionin dhe fuqinë ekonomike të vendeve anëtare. Nëpërmjet saj, bashkimi



politik bëhet faktikisht i pakthyeshem. Bashkimi i doganave, tregu i brendshëm dhe euro kanë kontribuar mjaft për stabilitetin, begatinë dhe konkurrueshmërinë globale të Europës. Europa është një pjesë jetësore e reagimit tonë ndaj globalizimit. Sepse ajo na bën të fortë në konkurrencën ndërkombëtare.

Plotësimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregut të brendshëm të përbashkët mbetet detyra jonë e përhershme. Përfitimi i tregut të përbashkët nuk duhet të ngushtohet nëpërmjet rregullimeve të tepërta. Bashkimit European i duhet të kalojë nëpër strese të rënda për të krijuar rritje më të madhe ekonomike, për të pohuar veten në tregun botëror dhe për të rritur konkurrueshmërinë e tij, për shembull, pavarësia e pakufizuar e Bankës Qendrore Europiane dhe aderimi strikt në paktin european të stabilitetit dhe rritjes. Në këtë frymë, kërkimi, zhvillimi dhe trajnimi duhet të mbështeten pasivisht.

332. Zhvillimi teknologjik është faktori më i rëndësishëm për rendimentin e lartë dhe rritjen ekonomike. Edhe Bashkimi European ka nevojë që të zhvillojë një strategji të teknologjisë së lartë në mënyrë që të ruhet hapja e vendeve të punës të paguara mirë dhe konkurruese në një afat të gjatë.

333. Ne duam që Europa të mbetet një shoqëri e pasur. Ne e konsiderojmë ekonominë sociale të tregut si një model european ekonomik dhe social. Në fushat e rëndësishme të politikave sociale dhe mjedisore duhet të krijohen standarde minimale të përbashkëta në mbarë Europën. Këto standarde duhet të lehtësojnë konkurrencën e ndershme, të ngushtojnë hendekun e konkurrencës midis Bashkimit European dhe të mos stresojnë asnjë shtet anëtar. Vetëm kur punojmë së bashku, edhe Bashkimi European mundet të kryejë standardet tona globale që janë ndikuar nga vlerat tona. Në këtë drejtim, i japim përparësi partneritetit tonë ekonomik transatlantik.

334. Një qëllim i rëndësishëm është që tu jepet qytetarëve dhe shoqërive liri e mjaftueshme nëpërmjet reduktimit të rregullimeve dhe kostove administrative në mënyrë që ata të jenë në gjendje të zgjerojnë dhe të zhvillojnë veten. Një Këshill European i pavarur për rishikimin gjyqësor të kushtetutshmërisë mund të japë një kontribut të

rëndësishëm në këtë proces. Gjithashtu, kur përkthehet ligji evropian në ligjin gjerman duhet të shmangen rregullimet e tepërta.

335. Ligji i komunitetit duhet të thjeshtohet dhe cilësia e vlerësimit të rezultateve të proceseve legjislativë evropiane duhet të ngrihen lart. Edhe në Bashkimin Evropian duhet një shqyrtim i rregullt i proceseve legjislativë suplementare dhe ashtu si do të arrihet kjo në Gjermani nëpërmjet parimit të mos-vazhdimësisë. Qëllimi ynë është të formësojmë një Europë me kushte vendore të përshtatshme.

336. Garancia e sigurisë së brendshme është një nga detyrat thelbësore të politikave kombëtare dhe evropiane. Me implementimin gradual të fushës sonë të përbashkët të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, Bashkimi Evropian jep një kontribut të madh për një liri më të madhe dhe mirësi për qytetarët. Në të njëjtën kohë ai bën të mundur luftën kundër terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar në mënyrë më efektive.

337. Mbi bazën e përkrahjes sonë aktive dhe të vendosur për vlerat e përbashkëta, na nevojitet në mënyrë të veçantë një shkëmbim i përmirësuar i informacionit ndërkufitar nga agjencitë policore dhe të sigurimit të shteteve anëtare. Sistemet ekzistuese të informacionit do të zhvillohen dhe në saj të teknikës më moderne duhet t'i përshtatet sfidave të reja të luftës kundër krimit dhe terrorizmit. Prandaj, kemi nevojë që të forcojmë institucionet tona të përbashkëta si EUROPOL-i dhe EUROJUST-i dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë më të ngushtë midis shërbimeve policore kombëtare. Detyrat e mëtejshme që kemi dhe që duhet t'i sjellim në nivelin evropian janë lufta efektive e migrimit të paligjshëm, zhvillimi gradual i një politike të përbashkët evropiane për refugjatët dhe një shkëmbim më intensiv evropian të përvojave të çështjeve të integritetit.

338. Ne duam që politikat e jashtme dhe të sigurisë që janë të përfshira në një strategji të integruar të sigurisë që përfshijnë sigurinë e energjisë dhe të lëndëve të para. Këto politika janë në interes të vendit tonë. Bashkimi Evropian duhet të marrë pjesë në procesin e globalizimit në përputhje me interesat dhe vlerat e tij dhe në harmoni me madhësinë e popullatës së tij dhe fuqisë ekonomike. Prandaj, do të jetë e nevojshme të krijohen kushtet mundësuese politike dhe



institucionale për Bashkimin Europian që të flasë me një zë dhe të jetë ndikues dhe efikas. Vetëm atëherë do të jetë në gjendje të ofrojë në mënyrë bindëse përvojat e tij të pasura në ndërtimin e rendit të paqes rajonale mbi bazën e komunitetit dhe një tregu të brendshëm si një partner tërheqës për zonat e tjera të botës.

339. Një pjesë e konceptit tonë të sigurisë të zgjeruar pa të cilin ne nuk mund të bëjmë është bashkëpunimi i zhvillimit. Bashkimi Europian është komuniteti më i madh donator. Për të marrë pranimin e nevojshëm të njerëzve, megjithatë është e domosdoshme që ndarja dhe shpagimi i fondeve të jetë transparent dhe i koordinuar me politikat kombëtare. Ato duhet të jenë në përputhje me parimin ‘ndihmo për të ndihmuar veten’, prej së cilës përfitojnë njerëzit, lokaliteti. Kjo duhet të promovojë gjithashtu në mënyrë të veçantë qeverisjen e mirë dhe administrimin efikas duket përfshirë luftën kundër korrupsionit.

340. Politika europiane e sigurisë dhe e mbrojtjes (ESVP) duhet të zhvillohet si një komponent i politikës së mbrojtjes së Bashkimit Europian. Ne përkrahim një mbrojtje europiane duke përfshirë një detyrim për asistencë politike dhe ushtarake që është plotësuese për NATO-n. Bashkimi Europian për këtë arsye, duhet të posedojë opsionet e tij ushtarakë. Republika Federale e Gjermanisë kontribuon mjaft në politikën europiane të sigurisë dhe mbrojtjes me Forcat e Armatosura Federale Gjermane. Ne mbështetim integrimin e njërive kombëtare brenda strukturave europiane dhe sigurisë me një ushtri europiane si qëllim përfundimtar.

341. Marrëdhëniet transatlantike gjithmonë kanë qenë një bazë e rëndësishme për paqen, lirinë dhe begatinë në Gjermani dhe Europë. Ato akoma janë me rëndësi të madhe. Kjo është arsyeja përse CDU gjithmonë insiston në kërkimin e rrugëve të përbashkëta të mendimit në partneritetin tonë me SHBA. Në këtë drejtim, bashkëpunimi ynë ekonomik gjithmonë është më i rëndësishëm. Së bashku, ne do të pëlqenim të forconim peshën e shoqërisë së vlerave perëndimore me partnerët transatlantik, SHBA dhe Kanada mbi bazën e sistemit tonë të vlerave.

342. Bashkimi Europian dhe SHBA janë partnerët ekonomikë me të cilët jemi më të lidhur fort në botë. Duke pasur parasysh krijimin e rrjeteve

në vazhdim në marrëdhëniet ekonomike transatlantike, ne mbështetim shmangien e kufizimeve tregtare dhe krijimin e tregut transatlantik. Ne përkrahim gjithashtu një Europë në vetëbesim që nuk e konsideron veten si mbërritje por si një partner i SHBA-së.

## 2. Përkrahja e Lirisë dhe Paqes – Roli i Gjermanisë në Botë

343. Liria, solidariteti dhe drejtësia janë udhërrëfyese për politikën tona të jashtme, të sigurisë dhe të zhvillimit. Këto udhëzime janë në përputhje me detyrën e garantimit të lirisë dhe sigurisë për njerëzit në Gjermani. Misioni ynë është të shmangim risqet nga vendi ynë dhe në të njëjtën kohë të përqijemi për paqen dhe lirinë si dhe të promovojmë respektin për sundimin e ligjit dhe për të drejtat njerëzore universale. Kështu, na duhet të krijojmë dhe të ruajmë parakushtet për shkëmbimin paqësor të përvojave të shoqërisë, kulturore dhe ekonomike në vendin tonë dhe gjithashtu t'i mundësojmë atij që të rritë begatinë e tij dhe të zhvillojë shoqërinë e tij.

344. Që prej fundit të Luftës së Ftohtë, kushtet e politikave tona të jashtme dhe të sigurisë kanë ndryshuar në mënyrë drastike. Rendi botëror bipolar tani i përket të kaluarës. Që prej 11 Shtatorit 2001, bota e lirë mësoi se sot ne jemi të cenueshëm ndaj kërcënimeve asimetrike, të cilët shkojnë përtej kufijve tanë. Ne duam të intensifikojmë marrëdhëniet tona ndërkombëtare në mënyrë që konfliktet e interesave mund të zgjidhen me sa më shumë bashkëpunim dhe sa më pak dhunë që të jetë e mundur.

345. Në këtë botë të globalizimit, çdo vend është fqinj. Shtetet që rrënohen shpesh janë vendstrehimi për terrorizmin ndërkombëtar dhe krimet ndërkombëtare. Krijimi dhe zbatimi i sundimit të ligjit dhe të demokracisë në rajonet e largëta u shërbejnë interesave tona dhe kjo është një masë paraprake sigurimi pro-aktive. Demokracia dhe sundimi i ligjit krijojnë stabilitet mbi të cilën varem ne si ekonomi e orientuar nga eksporti. Ne nuk duhet të jemi të përgatitur vetëm në mënyrë rajonale por edhe globale që të marrim përsipër së bashku me demokracitë e tjera brenda kuadrit të organizatave ndërkombëtare ndonjë përgjegjësi. Në këtë rast, ne ndjekim konceptin e rritjes së sigurisë: “Pa siguri, nuk ka zhvillim, pa zhvillim, nuk ka siguri”.

346. Për të qenë në gjendje që të përmbushim përgjegjësinë tonë duhet të garantohen mjetet dhe instrumentet për politikat tona të jashtme, të sigurisë dhe të zhvillimit në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë. Një politikë e jashtme e suksesshme duhet të kërkojë interesat e vendit tonë. Një prej tyre është njohja që: “Në qoftë se praktikojmë solidaritetin ndërkombëtar, ne do të përjetojmë edhe solidaritetin nga kombe të tjera”. Prandaj është në interesin tonë të mos i kufizojmë politikat tona vetëm me kombin tonë por të kërkojmë barazi interesash.

347. Politika e jashtme e suksesshme kërkon efikasitet intelektual dhe ekonomik si dhe tërheqje të rendit tonë shoqëror dhe kulturës. Ajo duhet të jetë e besueshme në mënyrë që të fitojë besimin e partnerëve dhe aleatëve tanë dhe në këtë mënyrë të refuzojë mënyrat e tjera divergjente kombëtare. Ajo duhet të mbështetet gjithashtu nga vullneti, vendosmëria dhe aftësia për të përkrahur vlerat, bindjet dhe interesat tona në dialogun me kultura të tjera. Ne duam të intensivikojmë ligjërimin e politikës së jashtme në vendin tonë dhe në Bashkimin Europian.

348. Për t’ju përgjigjur sfidave të ardhshme të politikës sonë të jashtme ne duam të zhvillojmë më tej Bashkimin Europian, të ruajmë partneritetin tonë transatlantik dhe të forcojmë rendin global. Ne duam të thellojmë integrimin ekonomik transatlantik në mënyrë që të forcojmë konkureshmërinë e vendit tonë.

349. NATO mbetet ende e domosdoshme për sigurinë e Gjermanisë dhe të Europës dhe është një instrument qendror i politikës sonë për sigurinë dhe mbrojtjen. Për këtë arsye, NATO duhet të jetë vendi i përhershëm për dialogun e politikës transatlantike të sigurisë.

350. Komuniteti transatlantik bazohet në një themel unik në mbarë botën të vlerave të përbashkëta. Ne jemi të lidhur me SHBA-në dhe Kanadanë me partneritet dhe miqësi afatgjatë dhe të testuar dhe duam ta zhvillojmë më tej. Të dy vendet u themeluan nga europianët. Parimet e Deklaratës Amerikane të Pavarësisë ishin një model për vendet europiane, fillimisht në Francë në vitin 1979 dhe më vonë edhe në Gjermani.

Në saj të SHBA-së veçanërisht Gjermania dhe Europa u çliruan nga nacional socializmi dhe komunizmi. Pa mbështetjen e SHBA-së ribashkimi gjerman dhe uniteti evropian nuk do të kishin qenë të mundur. Po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme që të kërkohen dhe të mbrohen pikat e përbashkëta të referencës me partnerët tanë transatlantik, SHBA-në dhe Kanadanë. Ne duam të forcojmë sjelljen e sistemit të vlerave perëndimore mbi bazën e vlerave tona të përbashkëta themelore.

351. Ne pranojmë përgjegjësinë e veçantë historike që Gjermania ka ndaj Izraelit. Ne mbështetim të drejtën e Izraelit për të ekzistuar si shteti hebre me kufij të sigurt. Gjermania dhe Europa duhet të kontribuojnë për zgjidhjen e krizës në lindjen e afërme dhe fqinjëve të tyre në frymën e partneritetit dhe bashkëpunimit me vendet në rajonin në fjalë. Ato duhet të ndihmojnë për zgjidhjen e konfliktit të Lindjes së Mesme. Për të arritur këtë është e domosdoshme pasja e një shteti të pavarur palestinez.

352. Ne mbështetim bashkekzistencës paqësore midis demokracive perëndimore dhe shteteve islamike. Ne respektojmë dhe çmojmë traditat e pasura kulturore të botës islamike. Është në interesin tonë të mbështetim fuqitë e moderuara në komunitetet islamike që përqafojnë sundimin e ligjit dhe demokracinë. Fundamentalizmi islamik dhe terrorizmi të motivuara nga islami janë në radhë të parë një kërcënim për vetë komunitetet islamike dhe për ne gjithashtu. Ne duhet të përgatitemi dhe të jemi në gjendje të luftojmë terrorizmin dhe fundamentalizmin islamik dhe të shkatërrojmë, së bashku me shumicën më të madhe të myslimanëve, terrenin që e pjell atë.

353. Gjermania, Europa dhe Perëndimi së bashku kanë interes të madh në marrëdhëniet e përzemërta me Rusinë. Ne përpiqemi për një partneritet strategjik të Bashkimit Evropian me Rusinë i cili është i themeluar mbi vlerat universale të Këshillit të Europës. Ne duam të intensifikojmë bashkëpunimin tonë ekonomik, politik dhe social me Rusinë. Ne duam të forcojmë zhvillimin demokratik, sundimin e ligjit, sistemin multimedial dhe shoqërinë civile në Rusi nëpërmjet një dialogu të hapur dhe gjithëpërfshirës.

354. Ne duam të mbështetim kontinentin tonë fqinj, Afrikën, në

përpjekjen e saj për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin dhe qeverisjen e mirë në mënyrë që njerëzit atje të kenë perspektiva më të mira të jetës. Ne përpiqemi për një bashkëpunim të afërt me Bashkimin Afrikan. Një problem i veçantë paraqitet nga varfëria, uria e përhapur, arsimi jo i përshtatshëm dhe përhapja e epidemive dhe sëmundjeve. Ne nuk mund të jemi indiferentë në Europë ndaj konflikteve të dhunshme, mungesës të stabilitetit dhe të ligjit në Afrikë. Ne ndikohemi drejtpërdrejtë nga reperkusionet e tyre, veçanërisht në formën e migracionit masiv në rritje.

355. Ne i vendosim një vlerë të lartë partneritetit me Amerikën Latine me të cilën Europa ka qenë e lidhur ngushtë nëpërmjet historisë sonë dhe vlerave tona. Ne forcojmë gjithashtu vendet në lulëzim si Brazili dhe Meksika që të marrin më tepër përgjegjësi në përpjekjen e tyre për të gjetur zgjidhje të problemeve globale. Nëpërmjet bashkëpunimit tonë me partnerët tanë ne kontribuojmë në shumë vende për të forcuar demokracinë.

356. Për të kapërcyer më mirë sfidat e shumëfishta gjatë proceseve të vazhdueshme transformuese në Azi dhe për të ruajtur interesat tona ne duhet të intensifikojmë bashkëpunimin midis Europës dhe vendeve aziatike dhe ta formësojmë atë nëpërmjet bashkëpunimit dhe partneriteteve të angazhuara. Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre në rritje ne duam të inkurajojmë Kinën dhe Indinë që të bëhen aktorë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë dhe formues të rendit ndërkombëtar.

357. Ne përkrahim vazhdimin e çarmatimit në mbarë botën, duke forcuar kontrollin e armatimit dhe menaxhimin e eksportimit të armëve të koordinuar nga Europa. Parandalimi i armëve të dëmtimit në masë dhe teknologjive të tyre mbështetëse promovon paqen botërore dhe kontribuon në sigurinë tonë. Ne do të imponojmë komunitetin ndërkombëtar që të bëjë presion mbi ata që shkelin rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

358. Ne mbështetim qasjen gjithëpërfshirëse dhe në rrjet që merr parasysh të gjithë gamën e instrumenteve të politikës të sigurisë dhe i shkrin ato në një koncept të vetëm. Kemi nevojë për një bashkëpunim të afërt gjithëpërfshirës dhe duam që instrumentet civile dhe ushtarake



të Kombeve të Bashkuara, të NATO-s dhe të BE-së të koordinohen më efektivisht me njëra tjetrën në qasjet e tyre të ndryshme për zgjidhjen e krizave.

359. Detyra e Forcave të Armatosura Federale Gjermane nuk është më e kufizuar me mbrojtjen klasike të Aleancës dhe vendin vetëm në territorin tonë. Në konceptin e rrjetit të sigurisë, Forcat e Armatosura Federale Gjermane janë një instrument që mund të dislokohen si për mbrojtjen e Aleancës dhe vendit edhe për menaxhimin e krizës ndërkombëtare dhe zgjidhjen e krizës. Përveç kësaj, Forcat e Armatosura Federale Gjermane duhet gjithashtu të jenë të dislokueshme për mbrojtjen e atdheut dhe për mbrojtjen kundër katastrofave brenda vendit.

360. Forcat e Armatosura Federale Gjermane gjithashtu duhet të jenë në gjendje që të shkojnë në misione të tjera ose operacione të tjera në të ardhmen dhe të përmbushin detyrat e tjera të caktuara Gjermanisë. Kjo është arsyeja përse transformimi i Forcave tona të Armatosura duhet të implementohet në mënyrë konsistente dhe Forcat e Armatosura Federale Gjermane të financohen sipas nevojave të tyre. Kjo është e vetmja mënyrë në të cilën Forcat e Armatosura Federale Gjermane mund t'i kryejnë detyrat e tyre rigoroz edhe Gjermania mund të mbetet efikase dhe ndikuese në çështjet e politikës së sigurisë në një aleancë dhe të jetë aktive në formësimin e të ardhmes në këtë botë të së nesërmes.

361. Forcat e Armatosura Federale Gjermane kanë një performancë mjaft të mirë dhe nëpërmjet misioneve të tyre jashtë shtetit ato e kanë rritur imazhin e Gjermanisë. Ne e mbrojmë shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Ai e ka vërtetuar veten në kushtet e ndryshme të kuadrit të politikës të sigurimit dhe ai ka qenë në përputhje me sfidat e politikës të sigurimit dhe është zhvilluar më tej përkatësisht. Gatishmëria për veprim dhe qëndrueshmëria e Forcat e Armatosura Federale do të garantohet vetëm nëpërmjet numrit të përshtatshëm të rezervistëve të kualifikuar. Themeli këtu hidhet nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Ne duam ta ruajmë shërbimin civil si një shërbim alternativ. Ai ka rëndësi të madhe për politikën sociale dhe të rinisë.

362. Kombet e Bashkuara kanë legjitimitetin më të madh për të trajtuar çështjet globale. Kombet e Bashkuara duhet të bëhen më efikase dhe

më detyruese në mënyrë që të ndihmojnë zbatimin e të drejtave të njeriut, lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit në mbarë botën në mënyrë që të kontribuojë në ruajtjen e krijimit të Zotit dhe të zhvillimit të vazhduar të ligjit publik të brendshëm.

363. Në lidhje me reformën e Këshillit të Sigurimit, ne rekomandojmë një vend të përhershëm në Bashkimin Europian. Me marrjen përsipër të vendit në Këshillin e Përhershëm të Sigurimit, Gjermania është gjithmonë gati të marrë më tepër përgjegjësi për arritjen e këtij qëllimi.

364. Ne përkrahim një ekonomi botërore të integruar gjithnjë në rritje me një transformim të lirë dhe të barabartë botëror dhe dëshirojmë, për këtë arsye të forcojmë institucionet si Organizata Botërore e Tregtisë (OBT). Siguria e kanaleve tregtare ndërkombëtare është me interes të madh për Gjermaninë. Me të, vendi ynë do të jetë në një pozicion më të mirë për të kontribuar në rritjen e begatisë në mbarë botën. Në të njëjtën kohë, tregtia e lirë dhe e ndershme ushqen çrrënjosjen e varfërisë dhe kontribuon për pasojë në stabilitetin ekonomik dhe politik të kombeve, gjë që në të kundërt do të riskun e rrënimit.

365. Është në interesin e Gjermanisë që të jetë pro-aktive në luftën kundër problemeve të zhvillimit të shumë vendeve, p.sh., varfërisë, nën-zhvillimit, abuzimit me të drejtat e njeriut, epidemitë, shkatërrimet mjedisore, luftërat, terrorizmi dhe shkatërrimi i kombeve. Politika jonë e zhvillimit për bashkëpunimin e bazuar tek partneriteti qëndron mbi tri shtylla: së pari, përgjegjësia për ata që vuajnë nën varfëri dhe për krijimin e Zotit në konceptin kristian të njerëzimit; së dyti, parandalimi i risqeve dhe së treti forcimi i partneriteteve tona politike, ekonomike dhe shkencore. Partneriteti i zhvillimit do të thotë për ne kthimi në forcimin e iniciativave tona të reformës dhe tek përgjegjësia e përbashkët e vendeve në zhvillim.

366. Politika e zhvillimit shoqërohet me vlerën. Është pjesë e politikës sonë të rendit publik. Ne shikojmë demokracinë liberale, sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë dhe rendin ekonomik të tregut të detyruar nga ana sociale, i cili mbron në të njëjtën kohë burimet natyrore, rrugën më të mirë të promovimit të zhvillimit në vendet e varfra. Këto synime janë elemente thelbësore të politikës sonë të zhvillimit. Bashkëpunimi në

zhvillim, i cili duhet të jetë një çështje afatgjatë, presupozon përpjekjet personale konsistente, veçanërisht nga vendimmarrësit politikë dhe elita në vendet në zhvillim. Ne ofrojmë ndihmë për vetë-ndihmë.

367. Ne pranojmë arritjet e atyre që angazhohen në bashkëpunim në aktivitetet e zhvillimit. Kishat dhe organizatat jo qeveritare (OJQ) ndihmojnë njerëzit në vendet në zhvillim drejtpërdrejtë. Fondacionet politike luajnë një rol jetësor të jashtëzakonshëm në promovimin e ndërtimit të kombeve, sundimit të ligjit, këshillimit dhe konsulencës për Parlamentet dhe partitë politike, duke ushqyer respektimin e parimeve demokratike si dhe zbatimin e të drejtave të njeriut në vendet në zhvillim. Gjithashtu, nëpërmjet përmirësimit të kushteve kuadër për përfshirjen ekonomike të sektorit privat të ekonomive të ndryshme mund të fitohet mbi shtysën e arritjes të qëllimeve të politikës së ndihmës e zhvillimit. Bashkëpunimi me ndërmarrjet private të biznesit ka një rëndësi të madhe që është e ngjashme me bashkëpunimin civil – ushtarak.

368. Numri i madh i donacioneve private demonstroi përgatitjen e njerëzve për të ndarë me qeniet e tjera njerëzore. Është detyra e shtetit që të promovojë iniciativën private. Ne përkrahim detyrën ndërkombëtare të rritjes të mbështetjes financiare për bashkëpunimin e zhvillimit publik deri në 0.7% të të ardhurave të brendshme bruto.

369. Siguria, zhvillimi dhe të drejtat e njeriut qëndrojnë së bashku. Të drejtat e njeriut janë të pandashme. CDU në të ardhmen do të ngrejë zërin gjithashtu kur të kërcënohen demokracia, liria, dhe sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në mbarë botën duhet të kenë precedencë mbi parimet e sovranitetit. Ne po kontribuojmë për formësimin e një bote të lirë, paqësore dhe të drejtë.